


DITURIA ISLAME



REVISTË MUJORE FETARE, SHKENCORE E KULTURORE • Nr. 395 TETOR 2023

MUHAMEDI A.S., FRYMA E
VËRTETË E KURANIT

NJË DITË E ZAKONSHME
E NJË NJERIU TË JASHTËZAKONSHËM

DORACAKËT MË TË NJOHUR
TË FIKHUT HANEFI

FJALIMI I MYFTIUT TË KOSOVËS, NAIM EF. TËRNAVA, ME RASTIN E VARRIMIT TË POLICIT AFRIM BUNJAKU, I CILI U VRA MË 24 SHTATOR 2023 NGA TERRORISTËT SERBË

Me emrin e Zotit, Mëshiruesit, Mëshirbërësit, Mëshirëplotit!

E nderuara familje Bunjaku,

Të nderuar përfaqësues të institucioneve të Kosovës,

Të nderuar të pranishëm!

Më lejoni që në emër të Bashkësisë Islame të Republikës së Kosovës, të përcjell ngushëllimet tona për familjen Bunjaku, për qytetarët e Kosovës dhe për të gjithë shqiptarët brenda dhe jashtë Kosovës, kudo që ata jetojnë dhe veprojnë.

I Madhi Zot, në Librin e fundit hyjnor, në Kuranin fisnik na thotë: “Kurrësi të mos mendoni se janë të vdekur ata që ranë dëshmorë në rrugën e Allahut. Përkundrazi, ata janë të gjallë duke u ushqyer te Zoti i tyre.” (Ali Imran, 169). Ata janë të gjallë, përherë janë të gjallë brenda shoqërisë sonë. Ata në vazhdimësi furnizohen me begatitë e Zotit xh.sh. dhe ata janë të gëzuar me aktin heroik që kanë bërë në mbrojtje të atdheut karshi terroristëve.

Flijimi i heroit të Kosovës, Afrim Bunjakut, është një dëshmi e gjallë, e cila do të jetojë sado që të jetojë njerëzimi mbi sipërfaqen e tokës. Flijimi i tij do të jetë një shembull për të gjithë ne, për të na treguar se kur është në pyetje atdheu, atëherë nuk vije në pyetje as jeta.

Tashmë para nesh e kemi trupin e heroit, të cilin pas pak do ta varrosim. Në pamundësi që ne ta kuptojmë jetën në të cilën tashmë ai po jeton, dhe sikur tashmë t’ia bënim një pyetje dhe t’i themi se a dëshiron të kthehet edhe një herë në këtë botë, kur ai veçse ka shijuar begatitë e të Madhit Zot, kur shpirti i tij po përjeton të mirat e pakufishme të Zotit, kur tashmë ai po përjeton çdo gjë që ka ëndërruar, e kush është ai i cili dëshiron ta lë Xhenetin dhe të dalë edhe një herë në këtë jetë?! Askush. Por, ky, tashmë edhe kur unë po flas, na përgjigjet duke thënë: “Po”, unë pranoj që edhe një herë të kthehem në këtë jetë, ama me një kusht, që edhe një herë të më mundësohet të bie dëshmor duke mbrojtur vatanin. Prandaj, të vetmit njeri që i Madhi Zot ia ka garantuar Xhenetin, është dëshmori – shehidi.

E lusim Zotin e Madhëruar që ta mëshirojë shpirtin e tij, ta begatojë me të mirat e Tij dhe ta bëjë bashkë me shpirtrat e të gjithë dëshmorëve tanë që kanë shkuar para tij, atyre që janë flijuar që ne ta gëzojmë këtë liri që e paguam me gjak në vazhdimësi.

Ne krenohemi me Ushtrinë tonë, krenohemi me Policinë tonë, ashtu siç u krenuam edhe para pak vjetësh me Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës!

Zoti e mëshiroftë shpirtin e tij, ndërsa familjes e të gjithë neve që jemi këtu u dhëntë gajret, ngase dhembja nuk është vetëm e familjes, por është edhe jona, por edhe krenaria është jona për këtë akt trimëror e heroik që ka bërë vëllai ynë në mbrojtje të vatanit.

Ju faleminderit!

Samadrexhë – Vushtrri, më 25 shtator 2023



EDITORIAL

- 4 I dërguari i paqes, jeta e të cilit filloi si një dramë

FETARE

- 5 Muhamedi, a.s., fryma e vërtetë e Kuranit
Dr. Azmir Jusufi
- 9 Mirësjellja e Muhamedit, a.s., në jetën e tij bashkëshortore
Dr. Florentina Tërmkollli
- 13 Një prind si Muhamedi, a.s.
Dr. Violetë Smajlaj
- 16 Një ditë e zakonshme e një njeriu të jashtëzakonshëm
Blerim Musliu
- 18 Sjellja e Muhamedit, a.s., me kundërshtarët e tij
Mr. Vedat Shabani
- 21 I Dërguari i Allahut në sytë e vrojtuesëve të huaj
Dr. Rijad Imeri
- 24 Mevludi - dashnia për Pejgamberin, alejhi selam
Phd. dr. Besnik Jaha
- 27 Komentimi i sures El-Fet'h (9)
Sabri Bajgora
- 31 Kaptina Fatiha - ndërtimi i personalitetit
Dr. Valmire Batatina-Krasniqi
- 35 Mrekullitë historike të Kuranit (2)
Pushtimi i Mekës
Mimoza Sinani



- 38 Mëkati, shkak i çdo problemi
Dr. Bali Sadiku

- 41 Agnosticizmi, qasje mohuese apo injoruese?
Mr. Adnan Shala

- 44 Doracakët më të njohur të fikhut hanefi
Hazir D. Selmani

- 47 Përballja e ideologjive të reja me Islamin
Imer Topanica

FAMILJE & EDUKIM

- 50 OBSH-ja dhe KB-ja duan që të shfaqet haptas aspekti epshor të fëmijët e vegjël anembanë botës

KULTURË

- 53 Jeta dhe veprimtaria e një malësori e përjetësuar në mes dy kopertinave
Dr. Nuridin Ahmeti

HISTORI & CIVILIZIM

- 55 Guri i sadakasë (sadaka taşi), fenomen dinjitoz islam i bamirësisë
Mr. Sc. Bahri Curri

AKTIVITETE

- 61 Myftiu Tërnavë mori pjesë në varrimin e policit Afrim Bunjaku



DITURIA ISLAME

Revistë mujore fetare, shkencore e kulturore
Nr. 394 • viti 37 • tetor 2023
• Rebiul-Evvel / Rebiul-Ahir 1445
• çmimi 1 €

Boton

Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, Prishtinë

Redaksia

Kryeredaktor: Mr. Driton Arifi
Anëtarë:
Dr. Ejup Haziri, Merita Boroci,
mr. Muharrem Tërnavë,
mr. Vedat Shabani.

Lektor & korrektor: Bajram Zeqiri
Redaktor artistik & teknik:
Bashkim Mehani

Adresa

"Dituria Islame",
rr. "Bajram Kelmendi" nr. 182,
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +384 38 224 024
E-mail: redaksia@dituriaislame.net
www.dituriaislame.net
Shtypi:
"Europrint", Prishtinë

I dërguari i paqes, jeta e të cilit filloi si një dramë



*“Unë jam i dërguar
me (fenë) e dëlirë e
tolerante”.*

(Hadith)

Rëndom, lindjet e lavdishme në histori kanë filluar si dramë. Dramë ishte edhe vetë lindja e Muhamedit a.s.. Ai lindi jetim, pa e parë dhe pa e shijuar fare aromën e këndshme të babait të tij, mu aty ku ekzistenca e babait ishte gati kusht i mbijetesës së secilit njeri.

Pastaj, edhe epoka në të cilën lindi dhe koha kur ai jetoi nuk “premtonte” shumë që ai, me ndikimin, namin dhe autoritetin, do të eklipsonte gjithë ngjarjet dhe rrjedhat tejshekullore në histori. Një vështrim i shkurtër në rrethanat dhe vorbullën e ngjarjeve historike të asaj kohe, do të vërente se qielli i kthjellët i Mekës së ndritur kishte shekuj që ishte vrenjtur e ngulfatur nga idhujtaria, padrejtësia, egoizmi i egër e luftërat e pandalshme që çmendurisht çdo ditë merrnin jetë të të pafajshmëve.

Por, mu në këtë kohë, lindi Muhamedi, vula e gjithë pejgamberisë. Lindja e tij, nëse jo në momentin e vështirë kur ai lindi, më vonë, doemos u kuptua se përbënte një kremtë të triumfit, të humanizmit e të dëlirësisë. Ishte një ditë feste për gjithë ata që për shekuj me radhë u përmalluan për harmoninë njerëzore, paqen e mirësinë. 12 rebiul evveli, ajo ditë prilli e vitit 571, nuk ishte thjesht një ditëlindje e një njeriu të rëndomtë, përtej kësaj, ajo shënonte edhe rilindjen e diellit të venitur të besimit të drejtë e të drejtësisë, virtytit e ndershmërisë.

Muhamedi, paqja dhe shpëtimi i Zotit qofshin mbi të, që në vitet e para të pjekurisë, atëherë kur drita hyjnore e shpalljes ende nuk kishte përndritur shpirtin e tij, shfaqti gatishmëri e urtësi për të mbjellë paqe në vendlindjen e tij.

Një luftë shpërtheu midis fiseve arabe të Mekës, Benu Kinaneh dhe Kais el Ejlan. Kjo luftë e përgjakshme vazhdoi për më shumë se dhjetë vjet. Si pasojë e saj shkuan shumë viktime e u mbytën një numër i madh i njerëzve të pafajshëm. Ajo luftë përbënte edhe një kapitull të çmendurisë së arabëve beduinë të kohës së injorancës-para islame, të cilët ishin të kalitur për të krijuar e ndezur konflikte ndërmjet vete. Një “pakt i fisnikërisë - Half el fudul” dhe një lloj komiteti i paqes u organizua, dhe konflikti fatmirësisht mori fund. Aty u bë betimi për paqe dhe për dhënie fund të konfliktit ndërmjet fiseve të konfliktuara. Ky pakt e gjeti Muhamedin a.s. si njëzet vjeçar (20 vjet para se ai të shpallej pejgamber). Mbase, si njeri ishte aq fisnik dhe i dëlirë, u ftua në këtë pakt - marrëveshje paqeje, si dhe u bë disi garanti më besnik i saj. Ai mori pjesë në një pakt të tillë, duke qenë në një moshë që rrallëkush mund të joshë për të marrë pjesë në një tubim të tillë. Muhamedi, paqja dhe mëshira e Zotit qofshin mbi të, kur e përshkruante këtë pakt, fliste me ngazëllim e thoshte: “Unë kam marrë pjesë në shtëpinë e Abdullah ibën Xhedanit në një pakt paqeje, e sikur të ftohesha për një të ngjashëm edhe në Islam (pas profetësisë sime) do të merrja pjesë përsëri në të.”

Vrojtuesit objektivë të historiografisë së tij vërejnë se i Dërguari i Zotit, ishte ai që preokupohej gjithnjë për të përvijuar strategjitë, për të zgjidhur konfliktet e mosmarrëveshjet, dhe të tillat mbesin edhe sot efektive që mund të përdoren për të ruajtur paqen në mbarë botën.

E tillë ishte edhe ngjarja e ngritjes dhe rikthimit të Haxhu al Asvedit (Gurit të Zi) ku ai mori pjesë si një arbitër i mirë që me urtësinë e tij pengoi gjakderdhjen dhe përplasjen e mundshme. Ai vendosi që përfaqësuesit e të gjitha fiseve të bëheshin pjesëmarrës në rivendosjen e Gurit të Zi, në murin e Qabesë, pas rindërtimit të saj, që u bë i domosdoshëm për shkak të përmbytjeve që ndodhën asokohe.

Këto janë vetëm pak nga ato shumë virtyte dhe lavde që i Dërguari a.s. i kishte fituar edhe para shpalljes së tij si Pejgamber, për të vazhduar gjithsesi me të njëjtin mision të paqedashësit e unifikuesit mbarëshoqëror edhe pas zbritjes së shpalljes tek ai. Ai shprehej me krenari dhe thoshte qartazi: “Unë jam i dërguar me (fenë) e dëlirë e tolerante.” Toleranca me kundërshtarët e fesë së tij, me gjithë varfërinë kuptimore të kësaj fjale për të cilësuar misionin e tij, si dhe zemërgjerësia e vetëmohimi në të gjithë hapat e jetës, rrëfejnë për kalitjen dhe parapërgatitjen e atij njeriu të bekuar për të qenë paqedashësi më me nam i të gjitha kohërave në histori.

Ai kishte marrë nga Zoti i tij detyrën e orientimit të potencialit njerëzor kah paqja e mirëqenia njerëzore, dhe rolin e inspirimit të njerëzimit kah vlerat fisnike e humane gjer në kataklizëm. Allahu i tha së pari atij, e pastaj edhe ne, pasueseve që atë e kanë shëmbëlltyrë në jetë “Nëse ata tregojnë prirje për paqe, trego edhe ti prirje për të dhe mbështetu tek Allahu! Se Ai, me të vërtetë, i dëgjon të gjitha dhe di çdo gjë.” (El Enfāl, 61). Ai anoi vetë dhe e mbolli animin kah paqja te të gjithë pasuesit besnikë të rrugës së tij. Për më tepër, edhe na mësoi që ne mund dhe duhet të bëhemi pishtarë të paqes pa hequr dorë fare nga virtytet tona dhe pa i nëpërkëmbur aspak parimet e fesë së tij.

I bekuar lindi dhe i fisnikëruar doli nga kjo botë, që bijtë e saj padrejtësisht vonohen për ta kuptuar madhësitë e mesazhit të tij.

Mr. Driton Arifi

Muhamedi a.s., fryma e vërtetë e Kuranit

Dr. Azmir Jusufi

“Është e vërtetë se Allahu dhe engjëjt e Tij me madhërim e mëshirojnë Pejgamberin. O ju që keni besuar, madhërojeni pra atë (duke rënë salavatë) dhe përshëndeteni me selam.” (El-Ahzab, 56)

Nëse dëshirojmë që ta përshkruajmë Muhamedin a.s., në një fjali të vetme, sigurisht që nuk do të ishte e paktë. Një fjali kaq të fortë, të vërtetë dhe koncize e tha gruaja e tij e dashur Aisheja r.a.. Ajo tha se Pejgamberi a.s., është *“Kurani që ecë”*. Në të vërtetë, vetëm disa fjalë të shkurtra e shpalosin plotësisht dhe fuqishëm karakterin e vërtetë të Pejgamberit të fundit të Zotit, Muhamedit a.s..

Muhamedi a.s., është fryma e vërtetë e Kuranit, në të cilën realizohen të gjitha kuptimet e mundshme kuranore dhe urtësia hyjnore. Kurani thjesht është pikturuar në shpirtin e Pejgamberit a.s. Ai është i pandashëm prej tij. E gjithë drita dhe i gjithë kuptimi i mundshëm dhe urtësia hyjnore të çdo shkronje kuranore, nga shkronja e parë *elif* deri te shkronja e fundit *ja*, zhyten dhe plotësojnë shpirtin e Pejgamberit a.s., i cili bëhet i përsosur aq sa mund të jetë i përsosur shpirti i njeriut. Natyra dhe morali i Pejgamberit a.s., nuk janë aspak të idealizuar, por përmbahen vetëm në nivelin e burimit të tij më sublim shpirtëror, në nivelin e primordialitetit të tij, në të cilin njeriu mund të ngrihet fare, kurse natyra e tij është ashtu siç ka buruar nga akti hyjnor i krijimit, që gjatë rrjedhës së ngjarjeve historike botërore do të rafinohej gradualisht me dhuntitë më të larta shpirtërore të Urtësisë hyjnore dhe do të rrezatohej shpirtërisht me dritën e emrave dhe attributeve hyjnore.¹

Shpirti i tij është një shpirt tipik njerëzor, por nga ana tjetër, ai shpirt është edukuar në atë mënyrë që nuk është edukuar asnjë shpirt tjetër dhe ky është thelbi shembullor i Pejgamberit a.s. në Islam.

MANIFESTIMI I FRYMËS SË KURANIT TË MUHAMEDIT A.S.

Muhamedi a.s., është gjithashtu realizimi i parë i vërtetë i çdo ajeti të Zotit, kështu që ai është i përshtatshëm jo vetëm si shpirti i Kuranit, por edhe si manifestimi i parë real dhe i vërtetë i tij. Ai përfaqëson plotësinë paraekzistuese të Shpalljes hyjnore. Thelbi i zgjedhjes së tij pasqyrohet në aktin e vendosjes së pakthyeshme të të gjitha fjalëve të Zotit mbi frymën e tij, e cila i parapriu çdo formë fizike të ekzistencës, dhe në ato fjalë është vetë drita e urtësisë hyjnore dhe fuqia e pashtershme e Vullnetit hyjnor. Kështu, shpirti pejgamberik është premtuar nga natyra e përjetshme e fjalëve hyjnore dhe ato fjalë që burojnë nga thellësitë e paarritshme të Jetës hyjnore janë premtuar nga drita e gjallë e Fytyrës së Zotit, e cila, si një lloj pasqyre, zgjedh Pejgamberin a.s..²

Shumë kohë përpara materializimit dhe konkretizimit të parë të ajeteve kuranore në Mus'haf, pasi u derdhën në mendjen e Pejgamberit dhe zemrën e tij të pastër, ata përjetuan të gjithë realizimin e mundshëm në praktikën dhe jetën e tij. Ai është i pari që i vuri në praktikë të gjitha ajetet e Zotit, nga i pari tek i fundit, dhe pas tij askush nuk do të mund ta arrijë plotësisht këtë. Ai është pra fryma e Kuranit, pranues dhe bartës i vazhdueshëm i dritës së fuqishme kuranore,

Muhamedi a.s., është fryma e vërtetë e Kuranit, në të cilën realizohen të gjitha kuptimet e mundshme kuranore dhe urtësia hyjnore.

por është edhe *Mus'hafi i parë i gjallë*, sepse është konkretizimi i parë dhe aktualizimi real i mesazheve hyjnore. Vetëm në jetën e tij u realizua çdo fjalë kuranore. Pas tij, familja e tij, sahabët e tij dhe më vonë besimtarët e tjerë do të përpiqen t'i ngjajnë sa më shumë që të jetë e mundur dhe vazhdimisht do të përpiqen të lustrojnë shpirtin e tyre në mënyrë që ai të pasqyrojë Pejgamberin a.s., dhe atë duke u përpjekur që të mësohen dhe zbatohen në praktikë të gjitha ajetet e Zotit. Kështu, *Mus'hafi* realizohet si një formë më e ulët e materializimit të Fjalëve të Zotit sepse Fjalët e Zotit shkruhen me shkronja në letër, kurse Pejgamberi a.s., si forma më e lartë e konkretizimit dhe ringjalljes së fjalëve të Zotit, sepse ai është pranues i vërtetë e i përsosur dhe reflektues i dritës kuranore të Zotit.³

MUHAMEDI A.S., SI KURANI I GJALLË

Muhamedi a.s., ishte *Kurani i gjallë*, sepse në të gjithë plotësinë e tij, përmes përthithjes së Kuranit në shpirtin e tij dhe më pas manifestimit të tij në kuptimin e të mësuarit dhe realizimit të plotë të të gjitha ajeteve hyjnore, arriti shkallën më të madhe të mundshme shpirtërore të afërsisë me Zotin. Kështu, ai arrin të realizojë nivelin më të lartë të mundshëm të dashurisë ndaj Zotit duke mësuar dhe bartur Kurantin, por edhe duke vepruar sipas dispozitave të tij.

Është jashtëzakonisht interesante se vetë *koncepti kuranor*, në të njëjtën kohë sa është i ndarë nga Pejgamberi a.s., është dhe aq fort i thurur në shpirtin e tij. Është i ndarë në kuptimin që Muhamedi a.s. nuk është autori i Kuranit dhe se në Kuran nuk mund të gjendet asgjë që do të tregonte nocionin

personal të Pejgamberit a.s., që ka origjinë nga njohuria e tij njerëzore.

Dhe me të vërtetë ekziston një vijë kaq e pastër midis këtyre dy koncepteve, *konceptit kuranor* të pastër, i cili është plotësisht i pavarur nga Pejgamberi a.s., dhe konceptit të pastër njerëzor të Muhamedit a.s., i cili përsëri është plotësisht i nënshtruar dhe i varur nga *koncepti kuranor*.⁴ Manifestimi i konceptit të parë, konceptit njerëzor të Muhamedi a.s., ishte dominues para Shpalljes dhe në raste të natyrës laike gjatë kohës së Shpalljes. Në këtë kuptim, duhet të përmendim rastin e kopshtarit të perimeve, të cilit Pejgamberi a.s., i dha këshilla për kultivimin e palmave, megjithatë; kur pa se ky i fundit hoqi dorë nga kjo metodë për shkak se ajo nuk dha rezultate, Pejgamberi a.s., pranoi se metoda e kopshtarit të perimeve ishte më e mirë se e tij. Nga ana tjetër, kur ishte fjala për Shpalljen, Pejgamberi a.s., nuk debatoi kurrë dhe iu nënshtrua plotësisht dominimit të saj. Ai në asnjë mënyrë dhe kurrë nuk sakrifikoi asnjë urdhër kuranor; kjo vërehet veçanërisht në rastin e haxhit në vitin e shtatë hixhri, të cilin ai e anuloi papritur pasi e kishte përgatitur deri në detaje. Ai hoqi dorë thjesht sepse Shpallja vendosi ndryshe edhe pse gati sa nuk shkaktoi trazira mes myslimanëve.⁵ Përveç kësaj, ka shumë shembuj të tjerë. Kurani gjithashtu në kohë i vendos në mënyrë të përsosur këto dy terma në lidhje me njëri-tjetrin në ajetin vijues: “Po kështu me urdhrin tonë Ne të shpallëm edhe ty shpirtin (Kurantin). Ti nuk ke ditur çka është libri (Kurani) as ç’ është besimi, por Ne atë e bëmë dritë me të cilën e vëmë në rrugë të drejtë atë që dëshirojmë prej robërve tanë. Në të vërtetë, edhe ti udhëzon për në rrugën e drejtë.”⁶





Prandaj, ai është *Kurani i gjallë* sepse drita e ajeteve hyjnore derdhet në mendjen dhe zemrën e tij kur i dërgohet Shpallja, por edhe pse ai e përjeton këtë dritë të fuqishme çdo ditë dhe në vazhdimësi, duke mësuar dhe praktikuar në kontinuitet të gjitha ajetet e Zotit. Kështu, Pejgamberi a.s., realizohet si shpirt i Kuranit në dy mënyra dhe atë në *mënyrë pasive*, duke i pranuar të gjitha ajetet në zemrën e tij dhe duke mos intervenuar në to në asnjë mënyrë, dhe në *mënyrë aktive*, duke i reflektuar ato ajete, duke i praktikuar në jetën e tij.

MORALI I MUHAMEDIT A.S., BURIM NGA KURANI

Se Muhamedi a.s., posedonte moral më të mirë, Allahu xh.sh., e shpalli në Kuran me këto fjalë: “Nun, betohem në pendën dhe në atë çka shkruajnë! Ti, me dhuratën (pejgamber) e Zotit tënd, nuk je i çmendur! Dhe se ti, pa dyshim do të kesh shpërblim të pandërprerë! Vërtet, ti je në një shkallë të lartë të moralit! Më vonë ti do të shohësh, e edhe ata do të shohin. Se cili prej jush është i çmendur? S’ka dyshim se Zoti yt është Ai që e di më së miri se kush është ai që ka humbur prej rrugës së Tij dhe Ai e di më së miri për të udhëzuarit.”⁷

Muhamedi
a.s., paraqet
një hallkë
shumë të
rëndësishme,
në rrugën e
“udhëtarit” të
përsosmërisë
së shpirtit.

Veç kësaj, Allahu xh.sh., në ajetin e lartpërmendur gjithashtu thekson se Muhamedi a.s., do të marrë një shpërblim të vazhdueshëm. Kjo e dhënë tregon se Muhamedi a.s., ka treguar gjithmonë një moral të mirë dhe se ai kurrë nuk ka devijuar nga devotshmëria.

Pas shpalljes së parë, Pejgamberi a.s., vazhdimisht i nënshtrohet ajeteve të saja dhe me gjithë forcën e tij i pranon ato në qenien e tij fizike dhe shpirtërore, e cila përfundimisht e gjen përfundimin e saj te Pejgamberi a.s., si *Kurani që ecë*, si një njeri në shpirtin dhe jetën e të cilit i janë realizuar plotësisht të gjithë urtësinë dhe të gjitha kuptimet e ajeteve hyjnore dhe për njeriun që iu përgjigj atyre në mënyrën më të përsosur të mundshme. “Unë” e Pejgamberit a.s., mund të ndahet nga Kurani vetëm në kuptimin që ai nuk është autori i tij dhe se Pejgamberi a.s. nuk ka futur asgjë të vetën në të, por në çdo kuptim tjetër “Unë” e tij është plotësisht kuranore, plotësisht e kurorëzuar me ajete kuranore.⁸

Për shkak të sa më sipër, Muhamedi a.s., paraqet një hallkë shumë të rëndësishme, në rrugën e “udhëtarit” të përsosmërisë së shpirtit. Kjo rrugë shpirtërore e thellon padyshim praktikën e frymëzuar hyjnore të Pejgamberit a.s., si i vetmi *Imam*, sepse vetëm

në shpirtin e tij, urdhri hyjnor ndihet si në shtëpinë e vetë dhe vetëm shpirti i tij i njeh qëllimet e tij urdhëruese dhe perspektivat e fshehura shpirtërore. Prandaj, kjo rrugë shpirtërore ka praktikën e saj, e cila në fakt është një pikturim i praktikës pejgamberike dhe e ndjenjës së saj të brendshme dhe e realizimit shpirtëror, karakteristikë e çdo udhëtari shpirtëror.

Jashtë kornizës së kësaj praktike, përkatësisht Syneetit të Pejgamberit a.s., është praktikisht e paparamenduar për një mysliman - një udhëtar shpirtëror, të kërkojë një mënyrë për t'u ngritur dhe përsosur shpirtërisht. Ndjenjat e brendshme dhe shndërrimet e udhëtarëve shpirtërorë mund të jenë të ndryshme, por praktika dhe mënyra e ecjes shpirtërore mbeten gjithmonë të njëjta, të Pejgamberit a.s..

Sipas interpretimit islam, Pejgamberi a.s., përfaqëson fillimin shpirtëror dhe plotësinë e të cilit besimtarët janë pjesë të veçanta. Një besimtar, në rastin tonë një udhëtar shpirtëror, duke lexuar Kuranin, në të njëjtën kohë duke imituar sa më shumë Pejgamberin a.s., në të vërtetë shpreh dëshirën e tij për përsosmërinë e tij. Nga pikëpamja fillestare, të marrim si shëmbëlltyrë Pejgamberin a.s., dhe sjellja e bekimeve mbi të, do t'i referojë *bërjes intermediale*, përkatësisht në *zgjerimin* që pason pastrimin dhe që i paraprin *bashkimin*.⁹

MUHAMEDI A.S., SI SHËMBËLLTYRË PËR TË RINJTË

Për një mysliman, shembulli më i mirë është padyshim ai i të Dërguarit të Zotit a.s., për çka Allahu i Lartësuar e thekson shprehimisht në Kuran: *"Ju e kishit shembullin më të lartë në të dërguarin e Allahut, kuptohet, ai që shpreson në shpërblimin e Allahut në botën tjetër, ai që atë shpresë e shoqëron duke e përmendur shumë shpesh Allahun."*¹⁰

Duke besuar në pejgamberllëkun e Pejgamberit dhe duke e dashur atë, ne arrijmë dhe realizojmë pjesën e dytë të shehadeetit. Paraardhësit tanë të mirë, si dhe ata që i pasuan ata, mbrojtën dhe u përpoqën të zhvillojnë në zemrat e fëmijëve të tyre dashurinë për Pejgamberin tonë a.s.. Ata e dinin se kjo dashuri në zemrat e tyre do të rrisë sentimentalitetin dhe ndjenjat e fëmijëve, do t'ua rrisë ndjenjën e përkatësisë ndaj Islamit, do t'i inkurajojë ata të bëjnë çdo të mirë, do t'i zgjidhë të gjitha problemet dhe do t'ua lehtësojë vështirësitë.

Përgjithësisht dihet se fëmijët në fazën e formimit dhe formësimit të personalitetit të tyre përpiqen të imitojnë personalitetin më të fortë me të cilin bien në kontakt, në mënyrë që ta ndjekin atë në sjelljen dhe lëvizjet e tij. Për këto arsye, pedagogjia islame kërkon që si fëmijët, ashtu edhe të rriturit, në përgjithësi të gjithë myslimanët, ta marrin Pejgamberin a.s., si model dhe shembull, sepse ai është një model i qëndrueshëm dhe i pandryshueshëm, "njeriu më i

përsosur" absolut që është shfaqur ndonjëherë dhe Pejgamberi më i zgjedhur nga të gjithë pejgamberët.¹¹

Prandaj, modeli është një nga mjetet më të dobishme në edukim që ndikon në zhvillimin moral, psikologjik dhe social të fëmijës. Kjo sepse edukatori është fillimisht modeli më i madh në sytë e fëmijës dhe fëmija me vetëdije, e shpesh edhe pa vetëdije, e ndjek atë në atë që thotë dhe vepron. Prandaj, modeli është një nga faktorët kryesorë nëse një fëmijë do të jetë i edukuar mirë apo jo. Nëse edukatori është i virtytshëm, i moralshëm, i ndershëm, i singertë..., edhe fëmija do të përpiqet të jetë i tillë. Megjithatë, nëse edukatori është i prirë të gënjejë, është i paqëndrueshëm, i pavendosur, dorështrënguar, nuk do të jetë për t'u habitur nëse edhe fëmija bëhet i tillë.¹²

Veçoritë më të spikatura të qasjes së Pejgamberit të bekuar a.s., ndaj të rinjve janë përkujdesja dhe dashuria e tij për ta, aq qartë e pasqyruar jo vetëm në hadithe, por edhe në veprimet e tij të përditshme, të dëshmuara nga shumë prej sahabëve të tij. Pejgamberi a.s., i donte fëmijët, madje edhe kur ishte i dërguar dhe sundimtar i një pjese të konsiderueshme të Arabisë e më gjerë, ai kishte shprehur të luante me nipërit e tij, Hasanin dhe Hysejnin, dhe ai madje i la t'i ngjiteshin në shpinë atij. Ai gjithmonë tregonte respekt për vajzën e tij, Fatimen, aq sa që u ngrinte në këmbë para saj dhe e përshëndeste sa herë që ajo e vizitonte atë.¹³

Muhamedi a.s. është shëmbëlltyra më e mirë sepse ishte në nivelin më të lartë të moralit, ai është zgjedhur nga Zoti i tij në mesin e krijesave të tjera, është rritur dhe i është dhënë edukata më e bukur. Ai ishte prindi më i kujdesshëm, bashkëshort ideal, kunat korrekt dhe dhëndër i virtytshëm. Ai ishte i vëmendshëm dhe i kujdesshëm ndaj të gjithëve.

1 Rešid Hafizović, (Poslanik islama i njegova vječna poruka), paštënie në: Seyyed Hossein Nasr, *Muhammed, čovjek Božiji*, (Sarajevë, Inštituti i Kërkimeve Shkencore "Ibn Sina", 2007), 293.

2 Po aty, f. 313.

3 Berin Bajrić, (Muhammed, alejhisselam, čisti duh Kur'ana), Novi Muallim, Viti XII, numër 48, (Sarajevë, 2011), 40-45,

4 Malik ibën Nebi, *Kur'anski fenomen*, botimi II, (Sarajevë, Pleqësia e Bashkësisë Islame të Bosnjës dhe Hercegovinës, Kroacisë dhe Sllovenisë, 1989), 108.

5 Po aty, f. 107.

6 Esh-Shura, 52. Përkthimi i ajeteve nga Haxhi Sherif Ahmeti.

7 El-Kalem, 1-7.

8 Berin Bajrić, (Muhammed, alejhisselam...), f. 44.

9 Po aty, f. 45.

10 El-Ahzab, 21.

11 Sulejman Topoljak, (Poslanikove odgojne metode), Novi Muallim, Viti II, numër 5, (Sarajevë, 2001), 31.

12 Zuhdija Hasanović, (Sredstva odgoja kojima se korišćio Božiji poslanik, alejhi-s-selam), Novi Muallim, Viti III, numër 8, (Sarajevë, 2002), 9.

13 Seyyed Hossein Nasr, *Muhammed, čovjek Božiji*, (Sarajevë, Inštituti i Kërkimeve Shkencore "Ibn Sina", 2007), 98-99.

Mirësjellja e Muhamedit, alejhi selam, në jetën e tij bashkëshortore

Dr. Florentina Tërmkolli

Njeriu i cili bëri ndryshimin rrënjësor në këtë rruzull tokësor, ndryshoi për të mirë sjelljet e prindërve me fëmijët e tyre dhe anasjelltas, rregulloi raportet ndërmjet vëllezërve, ndërmjet bashkëshortëve, eliminoi të gjitha dallimet të cilat ishin shkak për prishjen e raporteve familjare, shoqërore, fafësnore, pa dyshim se ishte i Dërguari ynë i fundit (paqja dhe shpëtimi i Zotit qofshin mbi të!).

Muhamedi alejhi selam ishte ai i cili ngushëllonte të tjerët, fshinte lotët e të përvuajturve, vlerësonte ndjenjat, nuk bënte shaka me fjalët e tjetrit, dëgjonte ankesat dhe rënkimet, lehtësonte dhimbjen dhe pikëllimin, bashkëngjitej në udhëtime, garonte me shokët e tij, dialogonte, vlerësonte karakteret njerëzore dhe i çmonte ato, dhuronte dashuri, dhe iu ofronte lumturi atyre që atë e rrethonin. Vetë jeta e tij, sjellja e tij me të gjithë ata që e rrethonin, e veçanërisht me familjen e tij dhe me bashkëshortet e tija, të japin të kuptosh se nëse mbizotëron respekti, mëshira, dashuria, toleranca, butësia, zemërgjerësia në mes bashkëshortëve, ajo familje do të jetë prej familjeve të bekuara dhe të veçuara. Respekti dhe dashuria janë sekret i vazhdimësisë dhe qëndrueshmërisë bashkëshortore.

Marrëdhëniet mes burrit dhe gruas, ai i tregoi duke e sjellë veten e tij si shembull në fjalë dhe në vepra, pra ishte personaliteti i tij që hartonte shembuj të ndryshëm pozitivë që do të trashëgoreshin pas shumë shekujve.¹ Kështu bëri ndryshimet më të mëdha të mundshme që njerëzimi të ketë rregullsi dhe

mbarësi në jetë. Zoti në Kuranin fisnik thotë: “Me të vërtetë keni pasur shembull më të mirë tek i Dërguari i Allahut për atë që shpreson në Allahun dhe Ditën e Fundit dhe që e përmend shumë Allahun.” (El Ahzab, 21).

Mirësjellja, dhembshuria, mëshira dhe respekti janë tipare të pandashme te natyrës së tij të pastër, dhe kjo e bëri të Dërguarin e Zotit shembull të përkryer në shumë sfera të jetës. Në një hadith, Profeti a.s. thotë: “Besimtari me besimin më të përkryer është ai që e ka moralin më të mirë. Më i miri prej jush është ai që sillet më së miri me familjen e tij.”²

Ishte më i suksesshmi dhe më i miri bashkëshort gjatë gjithë këtyre shekujve, sepse asnjë libër, asnjë histori dhe asnjë ngjarje, nuk tregon njeri me të përsosur se sa ai. Ai nuk theu asnjëherë ndjenjat e grave të tij, nuk i hidhëroi zemrat e tyre, nuk i përuli dhe asnjëherë nuk përdori dhunë kundër tyre. Profeti a.s. kurrë nuk ka vënë dorë mbi një grua. Patjetër që ishte i tillë, sepse morali i tij ishte Kurani, punonte me të dhe e besonte atë që gjendet në të.

Pejgamberi alejhi selam ishte me ndjenja të buta dhe i ndejshëm. Ai iu fliste grave të veta fjalë dashurie dhe butësie, dhe secila prej grave të tija ka menduar se mu atë e dashuron më tepër se tjetrën. Ai e thërriste secilën prej tyre me emra të cilët ato i pëlqenin. Ai e thërriste Aishen: “Oj Humejra!” dhe ndonjëherë i shkurtonte emrat e tyre që t’ua qartësojë atyre atë çka e ka në zemrën e tij prej dashurisë dhe thoshte “Oj Aish...”³

Mirësjellja, dhembshuria, mëshira dhe respekti janë tipare të pandashme te natyrës së tij të pastër, dhe kjo e bëri të Dërguarin e Zotit shembull të përkryer në shumë sfera të jetës.

Durimi i tij me gratë e tij. Aisheja r.a. thotë: “Hyrën habeshijtë (etiopiasit) për të lozur në xhami dhe ai tha: “Oj Humerja (oj fytyrëbardhë me pika të imta të kuqe në fytyrë), a ke dëshirë që të shikosh?” Unë thash: “Po.” Ai qëndroi te dera dhe unë hipa dhe vendova mjekrën time në shpatullën e tij dhe e mbështeta fytyrën time për faqen e tij. Ajo (Aisheja) thotë: “Prej fjalëve të tyre në atë ishte Eba el Kasim i mirë.” I Dërguari i Allahut tha: “A shikove mjaft?” Unë thashë: “Mos u ngut o i Dërguar i Allahut!” Më pas tha: “A shikove mjaft?” Unë thashë: “Mos u ngut o i Dërguar i Allahut!” Unë nuk kisha dëshirë që t’i shikoja ata, por pata dëshirë që gratë ta merrnin pozitën e tij tek unë dhe pozitën time tek ai.”⁴

Ai praktikoi në jetën e tij ajetin kuranor, ku Zoti Fuqiplotë thotë: “*Jetoni e silluni mirë me to!*” (Nisa, 19).

Dashuria e tij për gratë e tij. Turpi s’vjen vetëm se me hair, ashtu siç na ka njoftuar Pejgamberi a.s., përveç nëse kjo bëhet shkak që myslimani të humb diç prej çështjeve të dynjasë apo të dinit të tij. Pejgamberi a.s. e ka shprehur haptazi, me qëllim që t’i mësojë pasuesit e tij që ta shfaqin dashurinë ndaj

*Pejgamberi
alejhi selam
ishte me
ndjenja të buta
dhe i
ndejshtëm. Ai
iu fliste grave
të veta fjalë
dashurie dhe
butësie, dhe
secila prej
grave të tija ka
menduar se
mu atë e
dashuron më
tepër se tjetrën.*

grave dhe familjeve të tyre. Kjo ka qenë me qëllim që të vazhdojë dashuria dhe të vazhdojë bashkëjetesa. Amr ibën el Asi ka thënë: “Shkova tek i Dërguari i Allahut dhe i thashë: “Kush prej njerëzve është më i dashur tek ti?” Ai tha: “Aishja”. Thashë: “Ndërsa prej burrave?” Tha: “Babai i saj.” Thashë: “E më pastaj kush?” Tha: “Omeri.” Më pastaj numëroi burra dhe unë heshta nga frika se do të më numëronte të fundit.”⁵

Modestia e tij me gratë e tij. Enesi r.a. thotë se kur arritën në Medine prej Hajberit, së bashku me Pejgamberin a.s. ishte edhe Safija r.a.. Ai thotë se, e pashë Pejgamberin alejhi selam teksa ia mbante rrobën prej mbrapa, e më pastaj ulej afër devesë dhe e vendonte këmbën e tij dhe Safija vendonte këmbën e saj në gjurin e tij derisa hipte në deve.⁶

Njohja e gjendjes psikike të grave të tij. Ndjeshmëria e tij e bëri atë që të jetë vigjilent për ndjenjat e grave të tij, ku ai e ndjente atë që e ndjenin ato dhe përballej me gjërat negative të këtyre ndjenjave me amnisti dhe falje. Aisheja r.a. thotë se Pejgamberi a.s. i ka thënë asaj: “Unë e di kur je e kënaqur me mua dhe kur je e hidhëruar ndaj meje.” Ajo i tha: “Prej nga e di këtë?” Ai tha: “Kur je e kënaqur me mua, ti thua “*Jo, pasha Zotin e Muhamedit*”, ndërsa kur je e hidhëruar thua “*Jo, pasha Zotin e Ibrahimit*”. Ajo i tha: “Po, o i Dërguar i Allahut, nuk e bojkotoj vetëm se emrin tënd.”⁷

Ai e kuptonte gruan se a është në një gjendje emocionale jo të mirë, dhe vepronte një veprim të cilin nuk do ta vepronte vetëm një njeri si Profeti ynë a.s.. Aisheja r.a. ka thënë: “Kur isha me të përmuajshmet dhe pija ujë, Profeti a.s. e merrte gotën e ujit dhe pinte nga vendi ku kisha pirë unë.”

Rehatia e familjes së tij. Pejgamberi alejhi selam ishte ai që kërkonte rehatinë e familjes së tij dhe që mundohej në realizimin e saj, e në veçanti në udhëtim kur ka vështirësi, probleme dhe lodhje dhe kur frikësohej për ata që mos t’ju ndodh diçka e keqe. Enes ibën Maliku ka thënë: “Ishte Pejgamberi në udhëtim dhe ishte një djalosh që u printe deveve me shpejtësi. Pejgamberi a.s. i tha atij: “*Më ngadalë (më butë) me gotat e xhamit!*” (v.p. epitete ky që ua dha grave).⁸

Lutja e tij për gratë e tij. Aisheja r.a. kur e ka parë të Dërguarin e Allahut në qejf të mirë i ka thënë: “Lute Allahun për mua!” Ai i tha: “O Allahu im, falja Aishes gjynahet që i ka bërë dhe që do t’i bëj, gjynahet që i ka bërë fshehtas dhe gjynahet që i ka bërë haptas!”, sa që Aisheja qeshi derisa koka e saj ra në prehrin e saj nga të qeshurit. Pejgamberi i tha: “A të gëzoi duaja ime?” Ajo i tha: “Po, përse të mos më gëzojë duaja



jote?”. Ai i tha: “Pasha Allahun, kjo është dua ime për ymetin tim në çdo namaz.”⁹

Mbrojtja dhe mëshira e tij për gratë e tij. Shih sjelljen e tij kur Aisheja r.a. e ngriti zërin ndaj tij në shtëpinë e tyre. Këtë e dëgjoi Ebu Bekri r.a. dhe kur hyri e hapi këtë bisedë që ta godas me shuplakë, duke thënë se ai nuk e sheh të arsyeshme që ajo ta ngre zërin e saj mbi Pejgamberin a.s.. Në ato çaste Pejgamberi a.s. i doli përpara për ta mbrojtur Aishen. Ebu Bekri doli i hidhëruar dhe Pejgamberi a.s. tha: “Si të duket që unë të shpëtova nga ky burri?” Ebu Bekri qëndroi disa ditë e më pastaj mori leje që të hyj te Pejgamberi, dhe kur hyri i gjeti ata të dy të pajtuar dhe ju tha: “Më futni në paqen tuaj ashtu siç më futët në luftën tuaj.” Pejgamberi i tha: “E kemi bërë këtë, e kemi bërë këtë.”¹⁰

Mirëpritja e mendimeve dhe sugjerimeve të grave të tij. Profeti a.s. kur vendosi të marrë rrugën për në Mekë për të kryer umren, pasi ishte penguar disa herë nga idhujtarët, nuk gjeti përkrahje e as gatishmëri në fillim nga shokët e tij për të udhëtuar. Ai i zemëruar hyri në shtëpi, e i tha Umu Selemes: “U shkatërruan njerëzit! Unë i urdhërova, por asnjë nuk e çoi në vend urdhrin tim.” Mirëpo, gruaja e tij e sugjeroi që ai vetë të dalë e ta rruante kokën para tyre, duke qenë e është e bindur se atëherë asnjë nuk do të hezitojë ta çojë në vend urdhrin e tij, ngase do ta kuptojnë se ky është urdhër përfundimtar dhe nuk ka kthim prej tij.

Kështu edhe ndodhi. Posa doli i Dërguari i Allahut a.s. dhe e urdhëroi qethësin që t’ia rruante kokën, të gjithë vrapuan ta zbatojnë urdhrin e të Dërguarit të Allahut a.s.. I rruan kokat e tyre dhe u liruan nga ihrami i umres.¹¹ Pra, ky veprim që me sugjerimin e nënës së besimtarëve, Umu Selemes, Allahu qoftë i kënaqur me të!

Nderi dhe respekti ndaj familjarëve të grave të tij. Kur i vinte ndonjë dhuratë, Profeti a.s. ia dërgonte së pari të afërmeve të Hatixhes. Ai i nderonte dhe tregonte shumë respekt për ta, duke ua dhënë madje edhe jastëkun në të cilin ulej. Kur dikush e pyeti për këtë sjellje, ai tha: “Unë i dua ata të cilët i ka dashur edhe ajo.”¹²

Aishja r.a. tregon se i Dërguari i Allahut e përmendte aq shpesh dhe fliste për të kaherë me dashuri dhe admirim. “Megjithëse nuk e kam takuar kurrë, nuk kam qenë asnjëherë aq xhelozë për ndjenjat e Profetit a.s. kundrejt një gruaje tjetër, siç jam ndjerë për Hatixhen. Ai e përmend shpesh atë dhe e mban në konsideratë aq të lartë, sa që sa herë që therë ndonjë bagëti dhe e ndan, i dërgon të afërmeve të Hatixhes pjesën e tyre.”¹³

Andaj me të drejtë mund të themi se një model e shëmbëlltyrë për jetën bashkëshortore sikur ishte i Dërguari ynë i fundit, Muhamedi a.s., do të mbetej i pakrahasueshëm me cilindo bashkëshort, jo vetëm për epokën në të cilën jetoi, por i tillë e i pakrahasueshëm do mbetet ai gjërë në amshim.

- 1 Hatixhe Ahmedi, Pejgamberi a.s., sjelljet dhe raportet e tij me gratë dhe familjen e tij.
- 2 Hadithin e shënojnë Tirmidhiu dhe Ibën Maxheh në Sunenet e tyre, ndërsa Albani në Sahih et-Tergib, 1925, e konsideron *sahih li-gajrihi*.
- 3 Muhamed bin Ismail el Buhari, *El Edeb el Mufred*, (el Mearif, Rijad 1998), nr. 287.
- 4 Muhamed bin Ismail el Buhari, *Sahih el Buhari*, (Tuk en Nexha 1422h), nr. 5190.
- 5 Ahmed bin Hanbel, *Musned Ahmed*, (mueseset er risale, 1983), nr. 1637.
- 6 Muhamed bin Ismail el Buhari, *Sahih el Buhari*, (Tuk en Nexha 1422h), nr. 2235.
- 7 Muhamed bin Ismail el Buhari, *Sahih el Buhari*, (Tuk en Nexha 1422h), nr. 5228.
- 8 Muhamed bin Ismail el Buhari, *Sahih el Buhari*, (Tuk en Nexha 1422h).
- 9 Ibën Hibban, *Sahih ibën Hiban*, (mueseset er risale 1993), nr. 7111.
- 10 Ebu Davud, *Sunen Ebi Davud*, (er risale el alemije 2009), nr. 4999.
- 11 Ibën Haxher el Askalani, *Fet’h el Bari*, (El marife, Bejrut 1379h), nr. 2731.
- 12 sawtalhoda.com
- 13 Sire Nebevije, Muhamed ebu Shehbe, (el kalem 1427h, 2/644.

Një prind si Muhamedi, alejhi selam

Dr. Violetë Smajlaj

Njeriu kërkon shembull suksesi në jetë. Fillimisht e përvetëson ndonjë model lokal siç është prindi, derisa ta ndiejë nevojën për të marrë një shembull më universal, më të mirin e mundshëm në lëmin përkatës. Të shumta janë figurat e shquara që e kanë futur njerëzinë në borxh me kontributin e tyre të madh në fusha të ndryshme, por personaliteti më ideal për t'u ndjekur si shembull në fuqizimin e besimit dhe virtutit njerëzor mbetet Muhamedi, alejhi selam, për të cilin është shpallur në Kuran: *“Me të vërtetë shembullin më të mirë keni të dërguarin e Zotit, për ata që shpresojnë te Zoti dhe Dita e fundit, dhe që shumë e kujtojnë Allahun.”* (El Ahzab, 21).

Nevoja për model prindëror sa vjen e shtohet në këto kohë, kur shumica e fëmijëve ndonëse gëzojnë shumëçka, por shpesh jo atë që është thelbësore për ta, e që është përkushtimi adekuat prindëror. Kjo kohë na ka prezantuar një fenomen të transformimit të rolit prindëror, nga ai autoritativ, që kryesisht njihet vetëm gjuhen e urdhrat dhe rregullit, tek ai hipervigilent i nënshtruar ndaj frikës nga gjithçka dhe një paranoje prindërore e cila shkakton varësi ose te roli tjetër, e që është mosinvolvimi, d.m.th. heqja dorë nga edukimi familjar, duke menduar se edukimi është një proces i lirë, spontan dhe i natyrshëm, i cili mund të realizohet vetvetiu në kohë. Këtu kujtojmë thënien e të Dërguarit a.s.: *“Njerëzit janë si metalet, të mirët e tyre në injorancë mbeten të mirë edhe në Islam, nëse e kuptojnë mire fenë...”*¹, sepse *“më i miri njeri është ai më karakterin më të mirë.”*²

Kjo do të thotë se ndërtimi i një karakteri me virtyte fisnike fillon që në fëmijërinë e hershme, nga trangu familjar, ndërkaq besimi i shëndoshë i jep njeriut botëkuptimin e drejtë për jetën duke i shtuar atij urtësinë dhe udhëzimin hyjnor.³

Muhamedi a.s. pati fëmijë vetëm me Hatixhen, ndërsa pas vdekjes së saj, lindi edhe Ibrahimin nga gruaja e tij, Maria. Me Hatixhen pati Kasimin, Abdullahun, Zejneben, Rukijen, Umu Kulthumin dhe Fatimen. Që të gjithë djemtë i vdiqën sa ishin fëmijë, kurse vajzat ndërruan jetë pasi krijuan familjet e tyre, me përjashtim të Fatimes, e cila vdiq gjashtë muaj pas kalimit në amshim të Pejgamberit a.s.⁴

Zoti i Madhëruar deshi që jeta e të Dërguarit a.s. të karakterizohej nga shumë histori dhe situata të mrekullueshme edukative, të cilat kontribuojnë në futjen e vlerave të larta arsimore, përfshirë edhe raportin me fëmijët. Meqenëse të gjithë e njihnin si të butë, fisnik, bujar e zemërgjerë, edhe ndaj familjes së tij s'ka si të ishte ndryshe prej asaj që e deklaronte kur thoshte: *“Më i miri prej jush është ai që është më i miri për familjen e tij, e unë jam më i miri prej jush për familjen time.”*⁵

Prandaj, me të drejtë thuhet se *“nëse do të njohësh dikë, pyet familjarët për karakterin e tij”*. Në këtë kontekst, kur është pyetur Aisheja r.a. si për moralin e Profetit a.s., ajo ka thënë: *“Moralin e tij ishte Kurani”*⁶, që nënkupton se ai kishte mishëruar në vete moralin me të cilin ishte urdhëruar në Kuran.⁷ Këtë realitet e kanë shprehur edhe dëshmitarë të tjerë të jetës së tij familjare. Për

Të gjithë e njihnin si të butë, fisnik, bujar e zemërgjerë, edhe ndaj familjes së tij s'ka si të ishte ndryshe prej asaj që e deklaronte kur thoshte: “Më i miri prej jush është ai që është më i miri për familjen e tij, e unë jam më i miri prej jush për familjen time.”

shembull, Enes bin Maliku, pas një dekade shërbimi në shtëpinë e Pejgamberit a.s., ka deklaruar: “Nuk kam parë askënd më të mëshirshëm për fëmijët se i Dërguari i Allahut.”⁸

Fëmijët, nipërit dhe mbesat e tij i trajtonte me shumë butësi, i mbante në gjoks, iu buzëqeshte, luante me ta dhe i përkëdhelte.⁹ Në të njëjtën kohë ai nuk i mbyllte sytë përpara asnjë neglizhence të fëmijëve në detyrat e tyre, sidomos në lidhje me çështjet e botës së përtejme, sepse e kishte parasysh se secili do të japë përgjegjësi individuale para Zotit për të bëmat dhe të pabërat e tij. Një ditë, derisa ai këshillonte njerëzit, iu drejtua të bijës me porosi: “Oj Fatime, bija e Muhamedit... të mos ndodhë që njerëzit të dalin para Zotit me veprat e tyre të mira, e ju të dilni me dynjanë e mbajtur barrë mbi supë.”¹⁰

Siç vërehet, nga njëra anë, ai u jepte fëmijëve lirinë e përzgjedhjes së veprimit pasi i udhëzonte kah punët më të mirat, e në anën tjetër, ai kujdesej që fëmijët të mos ishin indiferent për gjërat me rëndësi. Pra, tek ai gjejmë modelin e baraspeshuar në raport me fëmijët. Me gjithë barrën e realizimit të misionit të tij si i dërguar i Zotit, e gjejmë atë se ka përmbushur edhe rolin e tij prindëror. Ky punim synon të vë theksin vetëm në disa pika me rëndësi në një raport të mirëfilltë prind-fëmijë, siç janë realizimi emocional, argëtimi, respektimi, motivimi, drejtësia dhe mbështetja.

REALIZIMI EMOCIONAL

T’i duash fëmijët tuaj është prirje e lindur njerëzore, por t’ua shprehësh atyre dashurinë shpeshherë varet prej kulturës vendore. Prijësi i njohur i fisit Temim, El Akre bin Habis, në një ndejë me Profetin a.s. u habit kur e pa se ai e përqaftonte nipin e tij Hasanin, dhe i çuditur nga ky model i ri prindërimi, ai nuk u përmbajt dot pa i thënë: “Kam dhjetë fëmijë dhe asnjëherë nuk e kam puthur asnjërin prej tyre!”¹¹

I Dërguari i Zotit e shikoi dhe me pak fjalë e përmirësoi këtë lloj këndvështrimi: “Kush nuk mëshiron, nuk mëshirohet”, në një version tjetër qëndron: “Çfarë mund të bëj unë nëse Zoti heq mëshirën prej zemrës sate?”¹¹

Kjo nënkupton se shfaqja e dashurisë për fëmijët nuk është dobësi burrnore, por mëshirë njerëzore që Zoti e do. I Dërguari i Zotit a.s., përkundër modelit të prindit autoritar që ishte zakoni fisnor i asaj kohe, përqaftonte djalin e tij, Ibrahimin, e puthte, e përkëdhelte, e mbante pranë gjoksit

I Dërguari i
Zotit a.s.,
përkundër
modelit të
prindit autoritar
që ishte zakoni
fisnor i asaj
kohe, përqaftonte
djalin e tij,
Ibrahimin, e
puthte, e
përkëdhelte, e
mbante pranë
gjoksit dhe i
nuhaste aromën
e këndshme prej
evladi

dhe i nuhaste aromën e këndshme prej evladi. Ndërkaq, kur Ibrahim i vdiq i vogël, ai e përqaftoi fort dhe me sy të mbushur me lot tha: “Sytë derdhin lot dhe zemra pikëllohet, por nuk themi tjetër veç fjalëve që e kënaqin Zotin, e ne për ndarjen tënde o Ibrahim jemi të pikëlluar.”¹²

Po ashtu, në një moment mjaft emocionues e të rëndë, kur i vdiq e bija e tij e parë, Rukija, megjithëse zemra e tij rënkonte nga mërzia, ia fshinte lotët Fatimes me cepin e rrobës së tij,¹³ në shenjë mëshire për të. Pejgamberi a.s. kujdesej për fëmijët dhe interesimet e tyre. Ai asnjëherë nuk ka neglizhuar fëmijët se janë të vegjël, se nuk dinë dhe s’kanë përvojë, por u bënte komplimente, i vizitonte kur sëmureshin, madje interesohej edhe për kafshët e tyre, si rasti kur e ngushëlloi Ebu Umejrin e vogël, kur pa sa mërztëz për dallëndyshen e tij që e quante Nugajr,¹⁴ duke dashur t’i thotë se ajo që është e rëndësishme për ty, është edhe për mua.


ARGËTIMI ME FËMIJË

Fëmija mëson duke luajtur dhe luan duke mësuar. Krijimi i mundësive për lojë është përgjegjësi prindërore për të argëtuar fëmijët. Nëpërmjet lojës fëmijët bashkë me ndjenjën e kënaqësisë fitojnë respektin për veten, sigurinë, bashkëpunimin me të tjerët,

si dhe mësojnë në të gjitha fushat e zhvillimit, në aspektin emocional, fizik, shoqëror, intelektual dhe krijues.

I Dërguari i Zotit, përkundër përgjegjësisë së mëdha që kishte, jo vetëm që gjente kohë për të lozur me fëmijët, por ndonjëherë bëhej edhe mjet loje për ta. Nipat e tij, Hasani dhe Hyseni, nganjëherë kalëronin mbi shpinën e tij derisa kënaqeshin dhe ai nuk ndërronte pozitë pa përmbushur dëshirën e tyre për lojë.

Shpesh është parë që mbante mbi supë mbesën e tij, Umamen. Nganjëherë edhe duke u falur, kur ulej në sexhde e lëshonte në tokë, e kur ngrihej prej sexhdes e kthente me kujdes në krahët e tij. Kjo ndodhte në një shoqëri e cila pak kohë më parë ndodhte të varrosej vajza për së gjalli, vetëm për shkak të përkatësisë gjinore, dhe askush të mos ndërmernte diçka për ta ndaluar. Ai jo vetëm që predikoi me Kuran ndalimin e një veprimi kaq makabër, por edhe publikisht shfaqte dashurinë atërore për vajzat dhe mbesat e tij në forma që nuk ishin parë kurrë më parë, duke lëkundur kështu kufizimet e pakuptimita të kohës.



Herë-herë i gëzonte fëmijët duke i marrë në kafshën e tij. Ky zakon u pëlqente aq shumë, sa ata e prisnin krahëhapur kthimin e tij nga udhëtimi dhe garonin kush të arrinte i pari tek ai.¹⁵ Ua përkëdhelte faqet, në shenjë dashurie, e kjo për ta kishte një vlerë të veçantë, ndiheshin fatlum dhe ishte arsye për t'u mburrur. Një kujtim të tillë të paharruar e rrëfen Xhabir bin Semure: “Bashkë me të Dërguarin e Allahut fala namazin e parë (të drekës). Pastaj ai doli nga xhamia drejt shtëpisë së tij dhe bashkë me të dola edhe unë. Në rrugë e prisnin fëmijët. Filloi t'ua përkëdhelte faqet të gjithëve një nga një. Edhe mua më përkëdheli faqen. Nga dora e tij ndjeva një freski dhe aromë të këndshme thujse e kishte nxjerrë dorën nga shporta e parfumeve.”¹⁶

MOTIVIMI I FËMIJËVE

Ai i frymëzonte fëmijët për ambicie dobiprurëse dhe iu hapte horizontet e së ardhmes. Një ditë, derisa Pejgamberi a.s. po ligjëronte, hynë në xhami dy nipërit e tij, të veshur me këmisha të kuqe, që rrezoheshin e çoheshin gjatë ecjes, kur i pa ata ashtu ai nuk u përmbajt dot, e ndaloi fjalimin, zbriti dhe i mori në prehrin e tij e pastaj vazhdoi ligjërimin.”¹⁷ Në një rast, derisa e mbante Hasanin në dorë dhe ligjëronte në minber, herë shihte njerëzit e herë shihte nipin, pastaj tha: “Ky djali im është zotëri, mbase një ditë nëpërmjet tij Zoti do të pajtojë dy grupe të mëdha myslimane”¹⁸ dhe ashtu ka ndodhur.

Të rinjve pa përvojë, por me dituri dhe aspirata të larta, Pejgamberi a.s. u jepte kurajë dhe guxim. Kur e ngarkoi Aliun r.a. me detyrën e gjykatësit në Jemen, ai fillimisht duke iu referuar moshës së re dhe mungesës së përvojës, u tregua i ndrojtur. I Dërguari i Allahut, i vuri dorën e tij të bekuar në gjoks dhe e inkurajoi duke u lutur: “Zoti im, jepi udhëzim në zemër dhe vendosmëri në gjuhë.”¹⁹

Më pas e mësoi si duhet gjykuar një çështje. Aliu r.a. tregon se “që atëherë, kurrë nuk jam luhatur në gjykimin mes palëve.”

RESPEKTI PËR FËMIJËT

Respekti fitohet e nuk imponohet. Fëmijët mësojnë praktikisht respektimin kur ata respektohen prej prindit. Në një formë, janë pasqyrë që reflekton veprimet e prindit. Kur Fatimja e vizitonte Profetin a.s., ai çohëj prej vendit, i dilte përpara për ta pritur, e mirëpriste me fjalë përkëdhelëse si “mirëserdhe bija ime”, e puthte në ballë, e merrte për dore dhe e ulte në vendin e tij. Me të njëjtin respekt vepronte e bija, sa herë që ai e vizitonte, ajo ngrihej ta priste, e përqafonte me përmallim, e merrte për dore dhe e ulte në vendin e saj me plot nderim.²⁰

DREJTËSIA MES FËMIJËVE

Mbrojtja nga padrejtësia dhe mbajtja e drejtësisë është përgjegjësi e njeriut për aq sa ka kompetencë dhe mundësi. Një ditë, kur erdhi një njeri të kërkonte nga Pejgamberi a.s. të ishte dëshmitar për një tokë që po ia dhuronte njërit prej djemve të tij, ai e pyeti: “A ua ke dhënë të njëjtën dhuratë edhe fëmijëve tjerë?” Tha “Jo”, i tha: “Kthehu, unë nuk dëshmoj për padrejtësi.”

Ai i konsultonte vajzat për t'iu marrë pëlqimin para martese, në mënyrë që ajo të merrte vendim për vete dhe të ndiente rëndësinë e saj, në mënyrë që kjo të krijojë para rrethanë që shton harmoni të qëndrueshme bashkëshortore.

Mbështetja e fëmijëve

Të jesh prind do të thotë të jesh i vetëdijshëm se rolin prindëror nuk e vjetëron mosha, as nuk e dobëson koha. Mjafton të ushtrohet me maturi. Në një rast, hidhërimin që i kishte shkaktuar dhëndri të bijës, transmetohet se i Dërguari a.s. e kishte mbrojtur me fjalët: “Fatimja është pjesë e imja, kush e hidhëron atë, më ka hidhëruar mua.”²¹

Kur informohej për ndonjë mospajtim ose hatërmbetje, riparonte raportin mes të bijës dhe dhëndrit. Një ditë, ai e vizitoi Fatimen dhe meqë nuk e gjeti Aliun në shtëpi, pyeti për të. Fatimja i tha se ai ishte hidhëruar me të dhe kishte dalë. I Dërguari a.s. doli vet dhe angazhoi dikë ta kërkonte. Kur e gjeten në xhami ndërsa flinte, iu afrua duke i shkundur pluhurin nga rrobat e tij, e kur ai mori të çohëj, me shaka dhe zë të butë i tha: “Ulu o i pluhurosur (Ebu turab), ulu!” Kjo nofkë më pas u bë thirrja më e dashur për Aliun.²²

Enes bin Maliku tregon se: “I Dërguari i Allahut a.s. më tha: “Biri im, nëse mund ta presësh mëngjesin dhe mbrëmjen pa ushqyer urrejtje dhe armiqësi ndaj askujt, bëje!

PËRFUNDIM

Kujtojmë këtu faktin se të dërguarit e Zotit me shprehjen “Biri im” i drejtohen botës fëmijërore, jo vetëm fëmijëve të gjakut. Kështu ai ndillte vëmendjen e një fëmije duke bërë që fjalët e tij t’i nguliteshin në kujtesë. Enes bin Maliku tregon se: “I Dërguari i Allahut a.s. më tha: “Biri im, nëse mund ta presësh mëngjesin dhe mbrëmjen pa ushqyer urrejtje dhe armiqësi ndaj askujt, bëje! Pastaj tha: Biri im, ky është suneti im, ai i cili zbaton në jetë sunetin tim, do të thotë se vërtet më do. Dhe ai që më do, do të jetë bashkë me mua në Xhenet.”²³

Zoti i Madhëruar deshi që jeta e të Dërguarit të Tij të karakterizohej me shumë situata të mrekullueshme edukative, të cilat kontribuojnë nëpër shekuj për shtimin e njohurive dhe fuqizimin e vlerave morale, përfshirë edhe raportin e prindit me fëmijët. Në këtë artikull kam sjellë vetëm disa fragmente të shkëputura nga jetëshkrimi i tij dritëdhënës, përndryshe tema e prindërimit në Islam është një kapitull i rëndësishëm, vlera e të cilit kuptohet nga numri shumë i madh i ajeteve dhe haditheve që flasin për këtë temë.

- 1 Transmetoi Muhamed bin Ismail el Buhari, Es Sahih, red. dr. Muhamed Zuhejr Ennasir, Bejrut: Daru Tavkunnexhati, bot. 1, 4/149 dhe 178 nr. 3383 dhe 3493, si dhe Muslim bin Haxhxhaxh el Kushejri, Es Sahih, red. Dr. Muhamed Zuhejr Ennasir, Bejrut: Daru Tavkunnexhati, bot. 1, 7/181 dhe 8/41 nr. 2526 dhe 2638.
- 2 Husejn bin Mesud el Begavi, Sherhussunneh, red. Shuajb Arnauti dhe të tjerë, Bejrut: El Mektebul Islami, b. 2, 1983, 13/236.
- 3 Shih, Hisham et-Talib, Abdul Hamid Ebu Sulejman dhe Umer et-Talib, Et-Terbijetul-validijeh: ru’je menhexhijeh tatbikijeh fit-terbijijetil userijeh, Virxhinia: El-ma’hed el-Ilmi lil fikr el-Islami, 2019, f. 105.
- 4 Ahmed ibnul husejn el Bejheki, Delail En Nubuvveh, red. dr. Abdulmu’ti Kalaxhi, Bejrut: Darul kutub El Ilmijeh, bot. 1, 1988, 7/282.
- 5 Muhamed bin ed-Dahhak et-Tirmidhi, El Xhamiul Kebir, red. Ibrahim Ivad, Kajro: Mustafa el Halebi, ed. 2, 5/709, nr. 3895.
- 6 Transmetoi Ahmed bin Hanbel el Handhali, El Musned, red. Shuajb Arnauti dhe të tjerë, Bejrut: Muessetu Err Risaleh, bot. 1, 2001, 41/148 dhe 42/183, si dhe 43/15.
- 7 Husejn bin Mesud el Begavi, Mealim Et Tenzil (Tefsiri i Begaviut), red. Abdurrezak El Mehdi, Bejrut: Daru Ihjautturath el Arabi, ed. 1, 1420h, 5/130.
- 8 Muslimi, Es Sahih, 7/76 nr. 2316.
- 9 Muslimi, Es Sahih, 4/1807.
- 10 Muhamed bin Is’hak, Kitabussijer uel megazi, red. Suhejl Zekkar, Bejrut: Darul Fikr, bot. 1, f. 147. Shih, gjithashtu, Buhari, Es Sahih, 4/185 nr. 3527 dhe Muslimi, Es Sahih, 1/133 nr. 206.
- 11 Transmetoi El Buhari, Es Sahih, 8/7 dhe 10 nr. 5997 dhe 6013, si dhe Muslimi, Es Sahih, 7/77 nr. 2318.
- 12 Transmetoi El Buhari, Es Sahih, 2/83 nr. 1303 dhe Muslimi, Es Sahih, 7/76 nr. 2315.
- 13 Muhamed bin Sa’d ez Zuhri, Et Tabakatul Kebir, red. Dr. Ali Umer, Kajro: Mektebetul Khanxhi, bot. 1, 2001, 10/37.
- 14 Transmetoi El Buhari, Es Sahih, 03/8 dhe 45 nr. 9216 dhe 6203, si dhe Muslimi, Es Sahih, 6/176 nr. 2150.
- 15 Shih, Kryesia e Çështjeve Fetare të Turqisë, Islam nëpërmjet haditheve, përkth. Nasir Rexhepi, Shkup: Logos-A, 2017, 6/396.
- 16 Transmetoi Muslimi, Es Sahih, 7/80 nr. 2329.
- 17 Transmetoi Ahmed, El Musned, 38/100 nr. 22996, si dhe autorët e katër Suneneve.
- 18 Transmetoi Buhari, Es Sahih, 3/186, nr. 2704 dhe në tri vende të tjera.
- 19 Transmetoi Muhamed Ibnu Maxheh el Kazvini, Es Sunen, red. Shuajb Arnauti dhe të tjerë, Bejrut: Dar Err Rrisaletul Alemijeh, bot. 1, 2009, 3/409 nr. 2309. Shejh Shuajbi shënon se hadithi është i saktë.
- 20 Shih, Ebu Davud Es Sixhištani, Es Sunen, red. Shuajb Arnauti me të tjerë, Bejrut: Dar Err Rrisaletul Alemijeh, bot. 1, 2009, 7/506 nr. 5217.
- 21 Transmetoi El Buhari, Es Sahih, 5/12 dhe 29 nr.4173 dhe 376. Shih, Muslimi, Es Sahih, 7/140 nr. 2449.
- 22 Transmetoi El Buhari, Es Sahih, 5/18 nr. 3703 dhe 8/45 nr. 6204.
- 23 Transmetoi Muhamed bin Isa Et Tirmidhi, El Xhamiul Kebir, red. Beshshar Avvad Maruf, Bejrut: Darul garb el Islami, bot. 1, 1996, 4/410 nr. 2678 dhe e cilësoi si hadith hasen garib.



Një ditë e zakonshme e një njeriu të jashtëzakonshëm

Blerim Musliu

Pejgamberi a.s. ishte modeli i pa krahasuar i njeriut familjar, i thjeshtë e i butë, ai i cili rregullonte nallanet e tij, i qepte rrobat e tij, i afërt e i ngrohtë me familjen e tij, e i dashur sa më s'ka. Ai na mësoi duke na thënë: "Më i miri prej jush është ai që është më i miri për familjen e vet. E unë jam më i miri, sepse jam më i miri për familjen time."

Është shumë e vështirë të shkruash për njerëzit e veçantë, e akoma më vështirë bëhet kur thuren fjalë për njeriun më të veçantë që shkeli mbi sipërfaqen e tokës. Vetëm atëherë e kuptojmë se sa të vegjël jemi ne, e sa vështirë e kemi ta bëjmë përshkrimin e një dite nga jeta e tij. Imagjinojeni ta jetojmë ne një ditë të tillë, e më pas sikur çdo ditë nga jeta jonë të jetë e tillë!

Megjithatë, ne përpiqemi ta bëjmë një përmbledhje e të kënaqemi edhe vetëm duke e përshkruar atë, duke qenë thellë të bindur se, modeli ynë i vetëm i suksesit në të gjitha sferat e jetës është pikërisht ai, paqja dhe bekimet e Zotit qofshin mbi të, e kjo madje edhe me udhëzimin më të lartë hyjnor: "Ju e kishit shembullin më të lartë në të Dërguarin e Allahut, kuptohet, ai që shpreson në shpërblimin e Allahut në botën tjetër, ai që atë shpresë e

shoqëron duke e përmendur shpesh Allahun." (El Ahzab, 21).

Në këtë ajet, Zoti qartë na thotë se për të gjithë ata që dëshirojnë shembullin e përkryer dhe modelin e veçantë, e keni tek i Dërguari i Zotit.

Ejani pra së bashku t'ia hedhim një shikim një dite të zakonshme, të mbledhim pak nektar nga çdo moment që kalonte i Dërguari i Zotit, në mënyrë që në fund ta nxjerrim "mjaltin" me të cilin do t'i rregullojmë jetët tona dhe ta vërtetojmë se jeta që ne e kalojmë, shpeshherë e zbrazur dhe pa angazhime, është shkak i çorientimeve të mëdha, madje deri në dëshpërim dhe ankth.

Nuk ka dyshim se i Dërguari i Zotit e fillonte ditën në mëngjesin e hershëm, duke e falur namazin e sabahut. Këtë e bënte në xhami, madje në shumë hadithe ka nxitur për këtë.



Transmetohet se Pejgamberi a.s. ka thënë: “Ata të cilët shkojnë në xhami nëpër errësirë, i përgëzoj me një ndriçim të plotë në Ditën e Gjykimit.”¹ Errësira është namazi i sabahut dhe i jacisë.

Sigurisht se kjo nuk është për t’u çuditur e për t’u habitur për një njeri, i cili një pjesë të madhe të natës e kalonte në namaz, e kur pyetej se përse rrinte kaq gjatë në namaz, ai thoshte a mos të jem rob falënderues.² Kjo pa dyshim na tregon dritaren nga e cila nxjerrim pamjen se misionet e mëdha nuk plotësohen ndryshe përveçse duke qenë lidhja tepër e fuqishme me Zotin e gjithësisë, dhe se sigurisht se këtë mësim e kishte marrë edhe vetë Muhamedi a.s. nga Zoti në fillimin e shpalljes: “O ti i mbuluar! Ngrihu dhe falu, përveç një pjese të vogël të natës!” (El Muzemil, 1-2).

Pas namazit dhe dhikrit të gjatë, ai ulej, e afër tij uleshin edhe shokët e tij, me të cilët ndante biseda të ndryshme të fesë e të dynjasë, e ndonjëherë ndante edhe momente nga e kaluara, ku nuk mungonin as ngritja e problematikave të ndryshme dhe ofrimi i zgjidhjeve për to. Më pas falte namazin e duhasë, për të cilin thoshte se është namazi i vigjilentëve. Ai a.s., në hadithin, të cilin e transmeton Ebu Dherri r.a. ka thënë: “Për çdo mëngjes, çdonjëra nyje e trupit tuaj ka të drejtë për lëmoshë. Çdo tesbih (të thënet Subhanallah – i pa të meta është Allahu) është lëmoshë, çdo tehmid (të thënet Elhamdulilah – falënderimi dhe lavdërimi i takon Allahut) është lëmoshë, çdo tehlik (të thënet Allahu Ekber – Allahu është më i Madhi) është lëmoshë, të urdhëruarit për të mirë është lëmoshë, ndalimi nga e keqja është lëmoshë, dhe si kompensim për të gjitha këto, mjaftojnë dy rekate të duhasë (paradites).”³

Dita vazhdonte me kthimin te familja, ku për dallim nga personalitetet e tjera në histori për të cilat dihet shumë pak nga jeta e tyre, Pejgamberi a.s. kishte ngarkuar përcjellës të veçantë që ta bartnin çdo imtësi nga jeta e tij në familje, për të na mësuar se sa madhështore është feja e Zotit. Pejgamberi a.s. ishte modeli i pa krahasuar i njeriut familjar, i thjeshtë e i butë, ai i cili rregullonte nallanet e tij, i qepte rrobat e tij, i afërt e i ngrohtë me familjen e tij, e i dashur sa më s’ka. Ai na mësoi duke na thënë: “Më i miri prej jush është ai që është më i miri për familjen e vet. E unë jam më i miri, sepse jam më i miri për familjen time.”⁴

Ai ishte shembull i jashtëzakonshëm edhe me shërbëtorët e tij. Enes ibën Maliku r.a., i ka shërbyer Pejgamberit a.s.

“Ju e kishit shembullin më të lartë në të Dërguarin e Allahut, kuptohet, ai që shpreson në shpërblimin e Allahut në botën tjetër, ai që atë shpresë e shoqëron duke e përmendur shpesh Allahun.” (El Ahzab, 21).

dhjetë vjet. E për këto vite, ai thotë: “E kam shërbyer Pejgamberin a.s. dhjetë vjet, e asnjëherë nuk më ka thënë “uf”, e as të më thotë diçka që e kam bërë: “Pse e ke bërë?” apo diçka që nuk e kam bërë: “Pse nuk e ke bërë?” Pejgamberi a.s. ishte me moral të mirë.”⁵

Përditshmëria familjare ishte pjesë shumë e rëndësishme. Ai kur nuk kishte për të ngrënë, agjëronte, për të nxjerrë në pah madhështinë e njeriut asket dhe për të na treguar se ankesa nuk ishte pjesë në familjen e tij.

Obligimi që Allahu ia kishte ngarkuar mbi supet e tij për ta përcjellë shpalljen te njerëzit, ishte padyshim boshti i jetës së tij. “O ti i Dërguar! Komunikojë atë që t’u zbrit prej Zotit tënd, e nëse nuk e bën (kumtimin në tërësi), atëherë nuk e ke kryer detyrën (revelatën – risalen)” (El Maide, 67). Ai me të zgjohej e me të ngrysej.

Nuk linte momente e mundësi përveçse t’ua përcillte njerëzve mësimet e fesë, Kuranin që i transmetohej, zbritjet e reja, përgjigjet në pyetjet që ia parashtronin delegacionet e shumta që vinin ta takonin, gjykimin për çështjet e drejtësisë, mbajtjen e korrespondencave me shtetet aleate, përgatitjen e ushtrisë për betejat e reja mbrojtëse apo çliruese. Këto ishin vetëm disa nga angazhimet e tij ditore, pa harruar asnjëherë xhaminë, imamllekun e deri tek ato

që mund të llogariten detaje për ne, siç është rasti i fëmijës, i cili e pyeti për zogun e tij, apo edhe rasti i ndihmesës që ia ofroi plakës për bartjen e gjësendeve të saj.

Mbyllja e ditës bëhej ashtu siç edhe e fillonte, duke madhëruar Zotin, duke marrë pushim për trupin e tij në pjesën e parë të natës, e duke i lënë hapësirë pjesës së tretë për vetmimin me Zotin, si një mbushje me energji për ditën e re.

Ky ishte një përshkrim shumë i përgjithshëm për ta kuptuar se sa barte ai në veten e tij obligime dhe detyra, e mund ta shohim se sot, punën që ai e bënte vet, sot, një ymet i tërë me afër dy miliardë njerëz, nuk e përmbushin as për së afërmi siç e përmbushi ai.

Paqja qoftë mbi të, mbi shëmbëlltyrën e njerëzimit, mbi modelin e papërsëritshëm!

1 Transmeton Ebu Davudi, 561.

2 Transmetojnë Buhariu dhe Muslimi.

3 Shënon Muslimi.

4 Suneni i Tirmidhiut dhe Suneni i Ibën Maxhes.

5 Transmeton Tirmidhiu.

Sjellja e Muhamedit a.s. me kundërshtarët e tij

Mr. Vedat Shabani

“Por Allahu nuk do t’i ndëshkonte ata, përderisa ti ishe në mesin e tyre dhe, Allahu nuk do t’i ndëshkojë ata përderisa ata i kërkojnë falje Atij.” (El Enfal, 33).

Allahu xh.sh. në Kuran ka thënë: “*Se ti je me virtyte madhore*”. (El Kalem, 4); “*Në të Dërguarin e Allahut ka një shembull të mrekullueshëm ...*”. (El Ahzab, 21).

Pejgamberi ynë, Muhamedi a.s., ishte një qenie njerëzore e krijuar dhe edukuar në mënyrë të veçantë nga “dora” hyjnore. Me edukimin e tij, në mënyrë të drejtpërdrejtë u mor Allahu xh.sh.. Ai te Pejgamberi a.s. vendosi cilësi dhe veçori të lavdërueshme, të cilat e dallojnë atë nga të gjithë njerëzit e tjerë.

Allahu xh.sh. e dërgoi Muhamedin a.s. mëshirë për botët, jo si mëshirë për një racë apo popull të veçantë, ose për një lloj të caktuar të krijesave, por e bëri atë mëshirë të përgjithshme për të gjitha krijesat. Allahu xh.sh. në Kuran thotë: “*Por Allahu nuk do t’i ndëshkonte ata, përderisa ti ishe në mesin e tyre dhe, Allahu nuk do t’i ndëshkojë ata përderisa ata i kërkojnë falje Atij.*” (El Enfal, 33). Prandaj është veprim jo mirënjohës nga ana e njerëzimit që ky Pejgamber dhe kjo dhuratë e çmuar nga ana e Allahut xh.sh., të kritikohet, përçmohet dhe satirizohet!

Në vazhdim të këtyre rreshtave do të jetojmë me një aspekt të madhështisë së tij për të parë nëse një Pejgamber i tillë meriton të kritikohet apo të fyhet ose përçmohet.

Fokusi i kësaj teme do të jetë shtjellimi dhe potencimi i raporteve të Pejgamberit a.s. me armiqët e tij, të cilët në vazhdimësi u munduan që ta dëmtojnë atë. Sepse sikur të fokusoheshim në tolerancën e tij me besimtarët ose me myslimanët, do të thuhej: Kjo është një gjë e natyrshme, që ai të jetë tolerant me ata që besojnë në të, por kemi të bëjmë me një aspekt për të cilin mund të themi se është gati e pamundur të gesh një njeri i cili gëzon të njëjtat virtyte siç i gëzonte i Dërguari i Zoti

xh.sh., Muhamedi a.s., edhe pse kishte lindur jetim, prapë se prapë ai nuk ishte ziliqar dhe zemërngushtë, sepse ai jetën e filloi duke iu hapur gjoksi atij për t’u pastruar ajo hiseja njerëzore që shejtani e cytë njeriun nëpërmes saj. Pra, zemra e tij mbeti pa hisen e djallit, dhe si rezultat i kësaj ai nuk e njohu urrejtjen, inatin dhe xhelozinë.

Nëse i japin një vështrim biografisë së tij, do të vërejmë se ai ishte abuzuar dhe dëbuar nga banorët e Mekës. Më pas ai shkoi në Taif, ku edhe atje u abuzua, dhe mbi të vërsulën mendjelehtit dhe fëmijët, duke e gjuajtur me gurë derisa nga këmbët e tij rrodhi gjaku. Në këtë gjendje ai u ul nën hijen e një muri (kopshti) dhe ngriti duart drejt Zotit të botëve, jo për të kërkuar shkatërrimin e atij popullit, as për t’u hakmarrë ndaj zullumqarëve, përkundrazi, ai ngriti duart për t’u ankuar dhe për të kërkuar falje prej Zotit xh.sh., duke thënë: “O Zot, unë të ankoem për dobësinë e forcës sime, mungesën e shkathtësisë dhe përulësinë time ndaj njerëzve, Ti je më i Mëshirshmi i atyre që tregojnë mëshirë, Ti je Zoti i të shtypurve dhe Ti je Zoti im, në dorën e kujt e lë çështjen time? Në dorën e një të largëti i cili sillet ndaj meje me vrazhdësi apo në dorën e të afërmit i cili më ka nën kontroll? Nëse Ti nuk je zemëruar ndaj meje, atëherë mua nuk më intereson asgjë!”. Në këtë moment, zbriti melaqja e kodrave së bashku me Xhibrilin a.s. e cila i tha Muhamedit a.s.: “O Muhamed, Zoti më ka dërguar te

ti, prandaj më urdhëro të bëj çfarë të duash, nëse dëshiron, mund t'i përplas dy kodrat (ku si rezultat të gjithë do të vdesin në shenjë hakmarrje për ty)". Këtu shohim se fati i armiqve të tij përcaktohet me një fjalë e cila del nga goja e tij, në një kohë kur zemra e tij ankohej për dobësi dhe poshtërim nga ana e tyre, mirëpo ai tha: "Jo, përkundrazi e lus Zotin që të nxjerrë nga bijtë e tyre ata që do ta adhurojnë Zotin dhe nuk do t'i bëjnë shok Atij".

Edhe pas shpërnguljes në Medine, ai iu ekspozua llojeve të panumërta të keqtrajttimeve dhe abuzimeve. Hebrejtë, disa herë kanë tentuar që ta vrasin, por përkundër kësaj, zemra e tij nuk ndryshoi. Edhe gjatë betejës së Uhudit, mushrikët e goditën atë derisa ia qan fytyrën dhe ia thyen dhëmbët, më pastaj i hapën një gropë dhe ai ra në të, dhe përkundër gjithë këtyre llojeve të maltretimeve, ai fshiu gjakun nga fytyra dhe tha: "O Zot, udhëzoje popullin tim, se ata nuk e dinë".

Në Medine, kreu i hipokritëve, Abdullah ibën Ubej ibën Seluli, vepronte kundër Pejgamberit a.s.. Një ditë Pejgamberi a.s. hyri në një tubim të medinasve, aty ishte edhe Abdullah ibën Ubej ibën Seluli, para se të pranonte Islamin. Ai iu drejtua Pejgamberit a.s., duke i thënë që të largohej, sepse era e gomarit të tij i ka lodhur! Ai gjithashtu kishte shpifur kundër bashkëshortes së Pejgamberit a.s., Aishes r.a. për tradhti bashkëshortore. Gjithashtu një herë duke u kthyer nga një betejë, ai shokëve të tij hipokritë ju kishte thënë: "Nëse kthehemi në Medine, më i nderuari do ta dëbojë prej saj më të përulurin, dhe ai pretendon se do ta dëbojë të Dërguarin e Zotit a.s.!" Me këtë rast u njoftua biri i tij Abdullahu, i cili ishte mysliman i vërtetë. Ai shkoi te Pejgamberi a.s. dhe i tha: "O i Dërguari i Zotit! Nëse do ta urdhëroje dikë që ta vrasë babanë tim, atëherë më urdhëro ta vras unë." Ai tha: "Jo o Abdullah, përkundrazi, do të përkujdesemi deri sa të jetë mes nesh." Me këtë rast Abdullahu shkon te babai dhe i tha: "Pasha Allahun! Nuk do të hyn në Medine derisa të thuash: Unë jam më i përuluri dhe i Dërguari i Zotit është më i nderuari."

Abdullah ibën Seluli gjatë gjithë jetës së tij vazhdoi të komplotonte kundër të Dërguarit të Zotit, derisa i erdhi vdekja. Kur i erdhi vdekja, ai i tha djalit të tij Abdullahut: "O

biri im! Nëse unë vdes, lute të Dërguarin e Zotit të më mbështjellë me rrobat e tij dhe lute që të ma fal namazin e xhenazes." Pasi vdiq, biri i tij Abdullahu,

shkoi te Pejgamberi a.s. dhe i tha: "O i Dërguari i Zotit! Babai im më ka porositur (lënë amanet) që kur të vdes të mbështjellët (qefinoset) me rrobat e tua dhe t'ia falesh namazin e xhenazes!"

Ky është ai që udhëhoqi fushatën e gënjeshtres dhe thashethemeve kundër të Dërguarit të Allahut a.s., ky është ai për të cilin në Kuran është thënë se do të ketë një ndëshkim të madh. Tani ai kërkon që të mbështillet me rrobat e të Dërguarit të Zotit a.s.. Me këtë rast Pejgamberi a.s. hoqi rrobat e tij dhe i thotë Abdullahut: "*Mbështillenit atë me to, nëse ato i sjellin ndonjë dobi.*" Pastaj doli për t'ia falur namazin e xhenazes, ndërsa Omeri r.a. e kapi për rroba të Dërguarin e Zotit dhe tha: "O i Dërguari i Zotit, a edhe këtë hipokrit do t'ia falësh namazin e xhenazes, kur të gjithë e dimë se ai ka bërë lloj-lloj veprimesh kundër teje dhe kundër nesh." Me këtë rast, Pejgamberi a.s. tha: "Më lër o Omer, sepse Zoti i Madhëruar më ka dhënë zgjedhje duke thënë: "*U lute për ta apo nuk u lute (o Muhamed), Allahu nuk do t'i falë, edhe sikur ti të kërkojë falje për ta shtatëdhjetë herë! Kjo sepse ata e mohuan Allahun dhe të Dërguarin e Tij. Allahu nuk udhëzon në rrugë të mbarë njerëzit e pabindur.*" (Et Tevbe, 80). Pasha Zotin, sikur ta dija se po t'i kisha kaluar të shtatëdhjetat do të ishin falur, unë do të kisha kërkuar falje për ta! A nuk është ky një qëndrim i mahnitshim i Pejgamberit a.s.? Edhe pse ai nuk kishte lënë mënyrë dhe metodë pa e përdorur vetëm e vetëm që ta dëmtonte dhe ta pengonte Pejgamberin a.s. në misionin e tij, ai Pejgamberi a.s., megjithëkëtë prapë shpreh gatishmërinë dhe dëshirën e tij që të lutej për të. Me të vërtetë qëndrime të tilla nuk dalin nga njerëz të thjeshtë.

Ky i dërguar, derisa ishte në kulmin e fuqisë së tij, një ditë një beduin iu afrua dhe i tha: "O Muhamed, më kthe borxhin tim, sepse ju, familja e Abdul Mutalibit, jeni prej atyre që zvarritni njerëzit (d.m.th. nuk e lani borxhin dhe nuk e ktheni atë me kohë)!" Ai këto fjalë ia tha të Dërguarit të Zotit derisa ai ishte në mesin e shokëve të tij më të afërt dhe më të dashur! Me këtë rast, ata ju vërsulën dhe në mesin e tyre ishte edhe Omeri r.a., i cili ju vërsul atij. Kurse Pejgamberi a.s. tha: "Jo, o Omer, unë dhe ai kishim nevojë që të vepronit ndryshe nga ajo që vepruat. Unë kisha nevojë që të këshillohesha dhe të jem më i përpiktë në kthimin e borxhit, ndërsa ai që të jetë më i kujdesshëm dhe më i sjellshëm kur kërkon." Pastaj tha: "Jepjani devenë e tij dhe jepjani një deve tjetër për atë që e keni frikësuar" - d.m.th. atë që meriton dhe jepi të njëjtën shumë, sepse e kishit frikësuar.

Kur Zoti i Madhëruar ia mundësoi çlirimin e Mekës, mund ta imagjinoni njëzet e një vjet luftë, nga dita që Zoti e dërgoi atë (trembëdhjetë vjet në Mekë dhe tetë vjet në Medine) ndërsa ata mbanin armë kundër tij, ata ia morën shtëpinë që ishte në Mekë, i persekutuan shokët e tij, e përzunë nga vendi që e do, e dëbuan, mblodhën turmat kundër tij, i kthyen arabët kundër tij dhe përkundër kësaj, kur Zoti i Madhëruar

i dha fitoren dhe triumfoi kundër tyre, dhe fati i tyre varej nga fjalët që dilnin nga goja e tij, dhe nëse ai urdhëronte t'i ekzekutonin ata, askush nuk do ta fajësonte e as nuk do ta qortonte, mirëpo ai me zemër të madhe ju drejtohet duke ju thënë: “Çka mendon se do të bëj me ju?”, ata thanë: “Ti je vëlla bujar dhe djali i vëllait bujar, atëherë Pejgamberi a.s. ju tha: “Shkoni, sepse që të gjithë jeni të lirë”! Këtë qëndrim dhe këtë vendim ka mundur ta bënte vetëm Pejgamberi ynë, Muhamedi a.s., sepse ardhja e tij ishte mëshirë për të gjithë e jo ndëshkim dhe dënim. E kjo mëshirë sigurisht që përfshinë edhe ata të cilët janë armiqësuar me të dhe e kanë luftuar me të gjitha metodat.

Kemi rastin e Safvan ibën Umejjes r.a., babai i të cilit ishte vrarë në betejën e Bedrit dhe për këtë arsye zemra e tij (derisa ai ende ishte jobesimtar) ishte mbushur me urrejtje kundër të Dërguarit të Zotit. Një ditë ai bisedoi me njërin prej politeistëve i cili quhej Umejri ibën Vehbi dhe i cili e kishte djalin të zënë rob te myslimanët. Sufvani u pajtua me Umejrin që ai të shkonte te Pejgamberi a.s., duke pretenduar se ai donte të lironte djalin e tij dhe të qëndronte vetëm me të Dërguarin e Zotit a.s. dhe më pas ta vriste atë, dhe vërtet, Umejri e mori shtizën e tij dhe e helmoi majën e saj që të mos kishte mundësi shpëtimi dhe shkoi tek i Dërguari i Zotit a.s. i cili i tha: “Çfarë të solli o Umejri?” Ai tha: “Erdha për ta liruar këtë të burgosur që e keni në duart tuaja”. Pejgamberi a.s. i tha: “Më thuaj të vërtetën”! Ai tha: “Është ajo që them unë o Muhamed.” Ai tha: “O Umejri, a nuk u ulët ti dhe Safvani te guri i Qabesë, e ai të tha filanin, e ti i the atij filanin?” Ai tha: “Pasha Zotin, askush nuk ishte me ne!” Dhe nuk ta ka treguar këtë dikush tjetër përveç Zotit, prandaj dëshmoj se nuk ka Zot tjetër përveç Allahut dhe se Muhamedi është i Dërguari i Zotit.

Qëllimi i përmendjes së kësaj ngjarje është se Safvan ibën Umeje vazhdoi me urrejtjen dhe zemërimin e tij, duke mbledhur turma dhe duke luftuar kundër Pejgamberit a.s., derisa Zoti ia mundësoi Pejgamberit a.s. çlirimin e Mekës, ndërsa paria e Mekës erdhën para të Dërguarit të Zotit a.s., për t'i kërkuar falje. Urrejtja e cila ishte në zemrën e Safvanit nuk e lejonte që t'i kërkonte falje të Dërguarit të Zotit a.s., kështu që ai u largua nga Meka duke mos dashur të takohet me të Dërguarin e Zotit a.s., pra deri në këtë masë iu mbush zemra me urrejtje kundër të Dërguarit a.s.. Gruaja e Safvanit erdhi tek i Dërguari i Zotit dhe e pranoi fenë islame dhe me

Ardhja e tij ishte mëshirë për të gjithë e jo ndëshkim dhe dënim. E kjo mëshirë sigurisht që përfshinë edhe ata të cilët janë armiqësuar me të dhe e kanë luftuar me të gjitha metodat.

këtë rast i tha Pejgamberit a.s.: “O i Dërguari i Allahut, të kërkoj besë për Safvanin.” Ai tha: “Ai është i sigurt.” Më pastaj Safvani u kthye në Mekë përkundër mosbesimit të tij.

Pejgamberi a.s. një ditë doli në betejën e Hunejnit dhe atij i duheshin armë (shpata, mburoja dhe shigjetat). Safvani kishte shumë prej tyre, kështu që Pejgamberi a.s. i tha: “O Safvan, më jep hua disa nga armët e tua.” Ai tha: “A do t'i kthesh ato hua apo dëshiron t'i uzurposh?” Pejgamberi a.s. tha: “Përkundrazi, është huazim dhe ato do të kthehet.” - Kjo për shkak se i Dërguari i Allahut a.s. i dha siguri.

Pas betejës, Pejgamberi a.s. u kthye fitimtar dhe ia ktheu armët Safvanit. Safvani shikoi dhe pa delet në mes dy maleve, pra një luginë plot me dele. Pejgamberi a.s. e shkoi Safvanin dhe vërejti në sytë e tij se ai donte ta kishte këtë pasuri, kështu që ai tha: “O Safvan, a dëshiron që kjo të jetë e jotja?” Ai tha: “Po”, Pejgamberi a.s. i tha: “Ajo është e jotja”, pastaj filloi t'i jepte e t'i jepte, derisa ajo zemër, e cila ishte ngulfatur nga urrejtja, ndryshoi dhe u mbush dashuri për të Dërguarin e Zotit a.s.. Safvani ka thënë: “Ai vazhdoi të më jepte deri në atë pikë sa u bë më i dashur për mua se sa vetja ime.

Nëse do të vazhdonim në zbulim të rasteve të tilla të qëndrimit të Pejgamberit a.s. ndaj armiqve të tij, me siguri rastet nuk do të ndaleshin, por qëllimi ishte që të zbulonim dhe t'i përmendnim disa sekuenca për lexuesin shqipfolës për qëndrimet korrekte të Pejgamberit a.s. edhe ndaj armiqve të tij, të cilat nuk do të përsëriten më në histori.

Përkundër kësaj që u tha, Pejgamberi a.s. ndonjëherë do të inatosej siç është natyra njerëzore, ndonjëherë kur kishte momente të vështira për të, ai zemërohej, e ndoshta ndonjëherë disa njerëz e provokojnë atë deri në atë pikë ku duhet të zemërohet, por ia megjithatë e menaxhonte zemërimin e tij! Paqja dhe mëshira e Zotit qofshin mbi të dhe familjen e tij!

Literatura e shfrytëzuar:

Kurani me përkthim, Hasan Nahi.
Fet'hul Bari, Sherh Sahih wl-Buhari.
Sher Sahihu Muslim.
Siretu Ibën Hisham.
Nektari i vulosur i Xhenetit.
Fik'hu Sire, dr. Ramadan wl-Buti.
Es-Sire wn-Nebevije, dr. Ali Sallabi

I Dërguari i Allahut në sytë e vrojtuesëve të huaj

Dr. Rijad Imeri

Zoti i Madhërishëm përzgjodhi njerëz të ndryshëm, në kohë dhe vende të ndryshme, që të jenë kumtues të mesazheve të Tij hyjnore dhe udhëzues në rrugën e vërtetë, e cila do t'i siguronte njerëzimit mirëqenie dhe drejtësi në këtë botë, si dhe shpëtim dhe shpërblim në botën tjetër, nëse do të pasoheshin ajo me përpikëri. Por, njëkohësisht ata ishin edhe paralajmërues për konsekuencat me të cilat do të ballafaqoheshin popujt nëse refuzonin dhe përgënjeshtrojnë. Këtë fakt e konfirmon fjala e Zotit në Kuranin famëlartë: “... Çdo popull pati udhëzues.” (Er Rad, 7); “Ne dërguam në çdo popull të dërguar që t’u thonë: “Adhuroni vetëm Allahun, e largojuni djajve (adhurimit të tyre)!” Por, pati nga ata që Allahu e udhëzoi dhe pati nga ata që ishte i gjykuar me humbje, pra udhëtoni nëpër botë dhe shihni se si ishte fundi i gënjeshtarëve?” (El Nahl, 36).

Në terminologji këta njerëz të përzgjedhur njihen si: *pejgamberë, profetë, të dërguar*, etj.

Edhe pse pejgamberët ishin të ndarë nga njëri-tjetri në vija kohore dhe vendore, misioni, thirrja dhe udhëzimi i tyre ishte i njësuar: “Adhuroni vetëm Allahun, e largojuni djajve (adhurimit të tyre)!”

Në lidhje me këtë, Muhamedi a.s. thoshte: “Profetët janë vëllezër, nënat i kanë të ndryshme, por fenë e kanë një, të vetme.”¹

Të dërguarit e Zotit (*paqja qoftë mbi ta*) nuk i unifikonte vetëm shpallja hyjnore, por gjithsesi edhe vlerat morale, të cilat ishin petku dhe stolia e tyre dhe me të cilat dalloheshin në mesin në të cilin jetonin. Kjo ishte një lehtësim i madh për ta në fushën e thirrjes dhe predikimit, pasi që edhe vetë armiqët e tyre, thellë në zemrat e tyre i admironin virtytet e tyre, edhe pse e mohonin thirrjen e tyre dhe i luftonin ata, kështu që kjo e bënte edhe më të vështirë propagandën e tyre përgënjeshtrore kundrejt tyre, sa që detyroheshin të kapeshin për gjëra të cilat logjika e shëndosh nuk mund t'i pranojë.

Me këtë përgënjeshttrim u ballafaqua edhe i Dërguari ynë, Muhamedi a.s. gjë që e dëshpëronte dhe mërziste shumë, pasi

që gëzonte respekt në mesin e popullit të tij dhe njihej si një ndër njerëzit më të sinqertë dhe më besnik ndër ta. Për këtë Zoti e ngushëllonte, i jepte zemër dhe ia zbulonte arsyen e kryeneçësisë së tyre, duke i thënë: “Ne e dimë se ty të zemëron ajo që thonë ata. Në të vërtetë, nuk je ti ai që po mohojnë ata, por keqbërësit po mohojnë shpalljet e Allahut. Edhe para teje (o Muhamed!), shumë të dërguar janë mohuar, por ata e kanë duruar mohimin dhe lëndimin (që kanë pësuar), derisa u ka ardhur ndihma Jonë...” (El Enam, 33-34).

Një ditë, përderisa Pejgamberi a.s. po ecte, e takoi Ebu Xhehlin, ia zgjati dorën dhe e përshëndeti atë dhe vazhdoi rrugën e tij. Njëri nga jobesimtarët i cili tërë kohën i vështronte iu afrua Ebu Xhehlit dhe i tha: “Të pashë që ia zgjate dorën atij heretiku (Muhamedit a.s.), si mund ta bëje një gjë të tillë?” Ebu Xhehli ia ktheu: “Pasha Zotin, unë e di se ai është profet, por që kur qenkemi bërë ne (fisi ynë) pasues të bijve të Abdul Menafit (e kishte për qëllim fisin e Muhamedit



a.s.)?!² E gjithë kjo tregon për përpjekjet e tyre që thirrjen profetike ta largojnë nga epiqendra e saj dhe ta zhvendosin në fusha klanore e fisnore, me shpresë se do të fitojnë në to.

Përhapja e Islamit dhe rritja e përditshme e numrit të myslimanëve, e shtonte kureshtjen e fiseve dhe popujve përreth që ta njihnin më për së afërmi këtë njeri, i cili pretendonte se i vinte shpallja hyjnore, duke e vrojtuar dhe studiuar çdo lëvizje të tij dhe shpeshherë edhe duke i testuar informacionet e tij dhe duke i vlerësuar udhëzimet e tij, gjë që i dërgonte ata para dy zgjedhjeve jetike, ose ta pasojnë atë me gjithë zemër dhe të bëhen myslimanë, ose të mbesin në bindjet e tyre dhe t'i shpallin luftë të pashpjegueshme Muhamedit a.s..

Ky fakt ilustron më së miri përmes këtyre dy shembujve:

Abdullah b. Selam r.a., i cili ishte njëri ndër dijetarët hebre më të mëdhenj në Medinë, ka thënë: “Porsa mbërriti Muhamedi a.s. në Medinë, njerëzit nxituan dhe u tubuan rreth tij, edhe unë isha në mesin e turmës që dëshiroja ta shihja atë. Filllova ta sodis fytyrën e tij dhe t'i konfirmoj tiparet e tij, aty menjëherë e kuptova se fytyra e tij nuk ishte një fytyrë gënjeshitari. Dhe të parën që dëgjova nga fjalët e tij ishte: “O ju njerëz, përhapeni selamin (përshëndeteni njëri-tjetrin), ushqeni të tjerët, mbani lidhjet farefisnore, faluni natën përderisa të tjerët flenë, do të hyni në Parajsë me selam (duke qenë të sigurt dhe të shpëtuar).”³

Safija r.a., e cila ishte e bija e njërit nga prijësit e hebrenjve në Medinë, ka thënë: “Ardhja e Muhamedit a.s. në Medinë, e preokupoi dhe brengosi jashtëzakonisht shumë babanë dhe xhaxhain tim, sa që mezi kishin prituri të errësohej dhe të shkonin ta vështronin Muhamedin a.s.. Nga preokupimi as që e hetuan se unë i ndiqja ata dy pas. Pasi qëndruan një kohë të gjatë duke e vështruar e dëgjuar, e pyeti xhaxhai im babanë tim: “A është ai (A është ai Pejgamberi, të cilin e gjejmë në librat tona?)” Babai im u përgjigj: “Po, pasha Allahun, ai është ai.” Xhaxhai vazhdoi: “A je i sigurt dhe i bindur në atë që thua?” “Po”

-ia ktheu ai. “Po çfarë ke në mendje për të?” – e pyeti me kureshtje?

*Ngadhënjimet e
fitoret e tij
vetëm se ia
forconin bindjet
e tij, bindje e
cila kishte
arritur pikën
më të lartë të
besimit... ai
asnjëherë nuk
joshej nga
bukuritë e kësaj
bote, e as nuk
ishte lakmitar
apo koprrac.
Pikërisht ishte
siç u përshkrua:
“I milte vet delet
e tij, ulej mbi
dhe, i qepte
rrobat e tij, i
rregullonte
nallanet e tij
dhe i veshte
rrobat e
harrnuara”*

“Armiqësi, pasha Zotin, sa të jemi gjallë” – tha babai im përplot mllëf.⁴


Nami i Muhamedit a.s. i kishte pushtuar edhe pallatet e perandorëve të asaj kohe. Disa prej tyre, siç ishte Nexhashiu, e pranuan thirrjen e tij dhe u bënë mysliman, e të tjerët tregonin respekt dhe admirim të lartë për të, siç ishte Herakliu, i cili tha: “E dija se ishte koha e paraqitjes së tij, por nuk e dija se do të ishte nga ju. Sikur ta dija se do të arrija deri tek ai, do të bëja çmos që ta takoja atë, dhe sikur të isha pranë tij, do t'ia laja edhe këmbët e tij.”⁵ Por kishte edhe nga ata që, të joshur nga pushteti i tyre i shpallnin luftë dhe armiqësi të drejtpërdrejtë thirrjes profetike, siç ishte perandori persian. Personaliteti dhe figura e Muhamedit a.s. zgjoi interesin e vazhdueshëm të studiuesve të lëmenjve të ndryshme brez pas brezi gjerë në ditët tona.

Michael Hart, astrofizikant i njohur amerikan, autor i librit “Radhitja e 100 personave më me influencë në histori” pasi që e vendos Muhamedin a.s. të parin në listë shkruan: “Përzgjedhja ime që Muhamedi ta kryesoi listën e personave më me influencë në botë ndoshta do t'i surprizoi disa lexues, e të tjerët ndoshta do ta vënë në pikëpyetje, por ai ishte i vetmi njeri në histori, i cili korri sukses superior në nivelin fetar dhe atë sekular. Ai e themeloi dhe e përhap një ndër fetë më të mëdha në botë dhe u bë një ndër liderët politik më të jashtëzakonshëm. Sot, trembëdhjetë shekuj pas vdekjes së tij, ende vazhdon influenca dhe ndikimi i tij të përhapet

fuqishëm.”⁶

Kurse orientalisti i njohur britanik, Tomas Arnold, në librin e tij “Thirrja në Islam” rreth virtyteve të Muhamedit a.s. thotë: “Mirësjelljen brilante të Muhamedit, të cilën e përjetonin delegacionet e fiseve të ndryshme dhe kujdesin e tij të jashtëzakonshëm për ankesat dhe nevojat e tyre, urtësinë e tij me të cilën i pajtonte dhe bashkonte në mes tyre, dhe politikën të cilën e ndiqte në ndarjen e tokave dhe pasurisë, e gjithë kjo bëri që emri i tij të bëhet i zakonshëm në zemrat e tyre, e fama e tij të përhapet në gjitha anët e gadishullit arabik, zotëri madhështor dhe burrë fisnik.”⁷

I impresionuar nga bukuria e Islamit, profesori universitar zviceran, Marsel Boisard në librin e tij “Humanizmi i Islamit” shkruan: “Muhamedi a.s. ishte profet e jo reformator i thjeshtë. Mesazhi i tij hyjnor shkaktoi një ndryshim rrënjësorë në shoqërinë arabe të asaj kohe, gjurmët e të cilit personifikohen edhe sot në shoqërinë moderne islame.”⁸ Dhe



vazhdon: “Padyshim se Muhamedi llogaritet, ashtu edhe ishte në realitet, revolucionar me përmasa të cilat do të duhej të ishte çdo profet, në përpjekjet e tij për ta ndryshuar rrethin dhe shoqërinë në të cilën jetonte.”⁹ “Më e bukura e gjithë kësaj është se Islami për nga thelbi i tij, dhe për nga logjika e sistemit të tij, që nga paraqitja e tij ishte fe e barazisë përmes botëkuptimit të cilin e paraqiti rreth Zotit, universit dhe njeriut.”¹⁰

Ndërsa orientalisti francez, Henri de Castries, në librin e tij “Islami mendime dhe mundësi” pasi i cek të pavërtetat dhe shpifjet që iu ishin mvësh figurës së Muhamedit a.s. në mesjetë, ai mundohet të hedh dritë mbi personalitetin e Muhamedit a.s. duke thënë: “Ne nuk mund t’ia mohojmë Muhamedit, në periudhën e parë të jetës së tij, besimin e tij të plotë, sinjeritetin e tij dhe besnikërinë e tij. Kurse në periudhën e dytë (në Medinë), asnjëherë nuk iu lëkundën as edhe një grimcë bindjet e tij në zemrën e tij. Ngadhënjimet e fitoret e tij vetëm se ia forconin bindjet e tij, bindje e cila kishte arritur pikën më të lartë të besimit... ai asnjëherë nuk joshej nga bukuritë e kësaj bote, e as nuk ishte lakmitar apo koprrac. Pikërisht ishte siç u përshkrua: “I milte vet delet e tij, ulej mbi dhe, i qepte rrobat e tij, i rregullonte nallanet e tij dhe i veshte rrobat e harrnuara”... i zhveshur nga lakmia, arriti ta zë pozitën më të lartë në tokat arabe, por kjo nuk e bëri totalitar, nuk kishte roje, e as ministra. Arriti të fitoi pasuri e famë, e pushtetin e tij ta zgjeroi në të gjitha skajet, megjithëkëtë nuk kishte shenja të pushtetit e pasurisë, përveç një unaze të argjendit mbi të cilën shkruhej “Muhamed Resulu Allah”.¹¹

Jeta e Muhamedit a.s. vazhdon të studiohet nëpër universitetet më të famshme të botës, e në shumë prej tyre janë hapur edhe katedra të veçanta për studimin e Islamit në tërësi dhe personalitetin e Muhamedit a.s. në veçanti, ngase në çdo hap të jetës së tij fshihen urtësi. E njeriut do t’i mjaftonte si dëshmi për Muhamedit a.s. fjala e Krijuesit të gjithësisë: “Vërtet, ti (o Muhamed) je në një shkallë të lartë të moralit!” (El Kalem, 4).

1 Muhamed Ismail el Buhari, *Sahih el Buhari* (3, Damask, Dar Ibën Kethir, 1993), 1270.

2 Abdurrahman b. Muhamed ebu Hatim, *Tefsir el Kuran el Adhim*, (4, Arabi Saudite, Biblioteka Nezar Mustafa el Baz, 1998), 1283.

3 Muhamed b. Jezid, *Sunen ibën Maxheh*, (4, Dar Er-Risale el Alemije, 2009), 397.

4 Abdulmelik b. Hisham, *Siretu ibni Hisham*, (2, Kairo, Et Tibaa el Fenije el Mutehide, 2010), 119.

5 El Buhari, *Sahih el Buhari*, (1), 7.

6 Michael Hart, *The 100 a ranking of the most influential persons in history*, (Nju Jork, 1993), 40.

7 Thomas Arnold, *Ed Dawa ile el Islam*, (Kairo, Mektebetu En Nahda Al Misrije, 1991), 54.

8 Marcel Boisard, *Insanijetul Islam*, (Bejrut, Dar Al Adab, 1980) 61.

9 Boisard, *Insanijetul Islam*, 66.

10 Boisard, *Insanijetul Islam*, 66.

11 Henri de Castries, *El Islam Havatir ve Sevanih* (Giza, Mektebetu en Nafidha, 2008) 52-53.

TRUNGU LOTOI

Po, po, trunгу lotoi dhe gjëmoi,
atë ditë kur më ai nuk u ul në të.
Nuk do ta ndalonte vajin dhe gjëmën,
sikur të mos i premtuhej se ai do të ishte
njëri nga trupat e palmave të Xhenetit.
Qau një trunг pa shpirt, vetëm pse e provoi
butësinë e tij.
Ani pse asnjëherë nuk e dëgjoi,
asnjëherë nuk e preku dhe asnjëherë nuk e shikoi.
Por zemrat e ngurta, edhe pse të gjalla, e
refuzuan,
e luftuan, e maltretuan, e dëbuan, e shanë dhe e
nënçmuan.
Jo pse ai ishte i keq, por vetëm se ai ishte i
Dërguar.
Xhelozia në zemrat e tyre të errëta,
nuk e pranuan këshillën e tij,
nuk pranuan të dalin në dritë.
Trunгу i vdekur lotoi, por njerëzit e gjallë e
refuzuan.
Më të vdekura janë ato zemra që nuk e pranojnë
të vërtetën,
se ato trunгje që në syrin tonë janë të thara,
e në fakt janë të gjalla sepse iu binden Krijuesit.
Më mirë trunг i vdekur e ta mbash Muhamedin
përmbi,
se mbret i kësaj bote kalimtare, e mohues i fjalës
së Zotit, e refuzues i peygamberisë së tij.
Më i lumtur është ai trunг që qau për
Muhamedin,
se ai mohues që mbeti në errësirën e kufrit
Ne nuk të pamë asnjëherë, nuk të dëgjua
asnjëherë, nuk të përqaftua asnjëherë, e nuk
ndenjëm bashkë asnjëherë.
Nuk erdhëm pas teje në Hixhret,
nuk luftuam me ty në Bedër,
nuk ishim me ty as në Uhud.
Nuk ishim me ty askund kur ti kishe nevojë,
eh sa mall kemi për atë kohë.
Nuk e shijuam ëmbëlsinë e fjalëve tua, as
butësinë e duarve tua, e as buzëqeshjen tënde.
As fytyrën tënde të ndritur si hëna
pesëmbëdhjetëshe nuk e pamë.
Por ne të besuam, të pranua dhe në rrugën
tënde vazhduam.
Ne të duam ty më shumë se familjet tona, më
shumë se pasuritë tona, e më shumë se vetët
tona!
Jemi ymeti yt, jemi pasuesit tu, e jemi me ty ja
Resulullah!

Benjamin Krasniqi

Mevludi - dashnia për Pejgamberin, alejhi selam

Phd. dr. Besnik Jaha

*S'muj e lavdon
kët Resul veç
kush e nis*

*Veç një Allah qi
gjith' na ka
jaratis*

MEVLUDI, POEZI E DASHNISË

Mevludi është një nga format okazionale të lirikës orientale. Si e tillë, kjo formë letrare i kushtohet lindjes së një personi të dashur. Edhe pse gazeli është forma orientale tipike e lirikës së dashurisë, mevludi përfaqëson një linjë më specifike: rastin e lindjes së një personi të dashur.

Sot termi mevlud ka edhe disa kuptime, e që në përgjithësi lidhen me pejgamberin Muhamed, a.s. Mevludi sot është edhe manifestim fetar, edhe manifest letrar. Mevlud sot është muaji kur festohet ditëlindja e Pejgamberit, a.s., data 12 Rebiul Evvel, apo muaji i tretë sipas kalendarit islam. Mevludi sot është poemë e *ashkut* për Pejgamberin, alejhi selam. Mevludi sot është edhe poezi e *dashnisë*. E asaj *dashnie* të lavdëruar për Resulullahun! Për atë që kishte mall e *dashni* edhe për ne, që sot, në muajin e ditëlindjes së tij e kujtojmë me vargje qindraveçare të thurura veçantë për të.

Derisa dihet se kush ishte i pari që e shkroi poezinë arabe të dashurisë, gazelin, Shehid Belhiu, autori i mevludit nuk dihet saktësisht. Megjithatë, mendohet se kjo formë për herë të parë, me përkushtim për Pejgamberin, alejhi selam, ka nisur prej osmanëve, diku në vitin 1405. Sulejman Çelebiu, atëherë imam i xhamisë "Ullu" në Bursa, gjatë përkthimit të vargjeve arabe me metrikën njëmbëdhjetërrokëshe (err rremel), me gjasë pavetëdijshtë kishte përvjedhur metrikën arabe, edhe në mevludin e tij kushtuar Pejgamberit, alejhi selam. Ky edhe mendohet

të ketë qenë arkitekti i gjithë versioneve të mevludit në gjuhën shqipe. Gjatë qeverisjes osmane shumë shqiptarë udhëtuan drejt Stambollit për t'u shkolluar, dhe atje ranë në kontakt me *mevludin*, *poezinë e dashnisë për Pejgamberin*, *alejhi selam*. Dhe nuk mundën mos t'i përkthejnë e përshtatin në shqip, secili sipas versionit të vet. E, prej shqiptarëve që kanë shkruar mevlud për Pejgamberin, alejhi selam, në mesin e rreth 30 autorëve, që nga



shekulli i 18-të (edhe pse së fundmi ka dyshime se vargje mevludi mund të gjenden edhe shekuj më të hershëm), renditen: Hasan Zuko Kamberi, Ismail Foniqi, Muhamed Çami, Hafiz Ali Ulçinaku, Hafiz Ali Korça, Hafiz Ibrahim Dalliu, Tahir efendi Popova etj..

PEJGAMBERI, ALEJHI SELAM, NË MEVLUD

Mevludi i Tahir efendi Popovës (1856-1949) është versioni më i njohur i vargjeve poetike që rrëfejnë për lindjen dhe jetën e Pejgamberit, alejhi selam. Tradicionalisht i *kënduar* si ritual dhe qasje e organizuar e një tubimi me karakter shpirtëror, ky mevlud për shumë vite mes shqiptarëve ishte ndër të paktat forma të njohjes së Pejgamberit, alejhi selam.

Që në fillim të tekstit të vet, Tahir efendi Popova, në një kaside (poezi me diskurs himnizues-elozhe), i fton në *tubim të mevludit* gjithë besimtarët që duan të kenë të mira prej Zotit, që duan të jenë banorë të Xhenetit, që duan të shpëtojnë nga Xhehenemi, që e duan Xhenetin e *Naltë*, që duan të pinë ujë nga kroi i Kevtherit, që të *shkojnë te Mevludi i Pejgamberit, alejhi selam*. Ndërsa, më pas në nëntë distikë thur falënderime për Zotin, dhe selame për Resulullahun, për sahabët e evlijatë etj..

Në 16 distikët e parë të mevludit flitet për Zotin dhe cilësitë e Tij, për t'i përmbyllur me një distik që fton t'i dërgohen *salavete* Pejgamberit, alejhi selam.

Si një *ashik* i Resulullahut dhe një *fakir* ndynja, Tahir efendiu, në pesë distikët e radhës fton të bëhet dua për të e t'i këndohet një *Fatiha*. Ndërsa, në gjashtë distikët e radhës e shpjegon kuptimin e mevludit për shqiptarët, manifestimin-ritualin tradicional dhe *sevapin* nga mevludi, për ta përmbyllur prapë me një distik që fton të thuhet salavate për Pejgamberin, alejhi selam.

Që nga distiku i 30-të i mevludit, e deri në distikun e 40-të, përshkruhet vlera e Pejgamberit, alejhi selam dhe pozita e tij te Zoti i Naltë. Në vargjet e mëposhtme përshkruhet qenia e bekuar e Pejgamberit, alejhi selam, engjëllshmëria e tij, vlera e tij e madhe, bekimi që e fitoi çdo qenie falë tij, *rahmeti* që i erdhi dynjasë me ardhjen e tij dhe dëshira e gjithë pejgamberëve për të qenë pjesë e umetit të Pejgamberit, alejhi selam.

Gjithë sa send qi asht i mir hem a makbul

Shybe s'ka hiç gjendet aj te ky Resul

Ja dha Haki shejtit ja bani tamam

Prej meleqve veç e ndau tuj kan' insan

(...)

Gjithë enbijatë a nqitape qi kan' thanë

Prej ymetit t'Muhamedit, t'ishim kanë

Dhjetë distikët e radhës flasin për ardhjen e Ademit, alejhi selam, dhe hazreti Havasë në këtë botë, bashkë me *nurin*, i cili vinte në këtë botë për hir të pejgamberit Muhamed, alejhi selam. Ndërsa, pas një distiku që fton në shpëtim nga ndëshkimi në botën tjetër për hir të salavateve për Pejgamberin, alejhi selam, pasojnë vargjet që flasin për biografinë e tij, mrekullinë e lindjes, dhe pamundësinë e njeriut për ta lavdëruar meritueshëm; për 26 distikë, e që njëherësh është pjesa ndër më të gjatat nga mevludi, thuren vargje himnizimi sikurse këto:

S'muj e lavdon kët Resul veç kush e nis

Veç nji Allah qi gjith' na ka jaratis

Sigurisht se lindja e Pejgamberit, alejhi selam, ishte lajm gëzimi për shumë krijesa në këtë botë. Madje, sipas autorit të mevludit, edhe çdo



zerre (grimcë atomi) i jepte selame-përshëndetje Resulullahut. Dhe, përshëndetjen ia bënin me epitetet më të bukura, siç dëshmojnë dhjetë distikët e radhës:

*Merhaba ej i madhi sulltan, merhaba
Merhaba gjith' dertit derman, merhaba
Merhaba ma'j madhi i gjithë pejgamberisë
Merhaba ma'j madhi dost i Perëndisë
Merhaba ej dritë e syve t'islamisë
Tan alemi veç për ty janë jaratis*

Edhe dhjetë distikët në vazhdim flasin për vlerën e Pejgamberit, alejhi selam, mrekullitë vërejtur prej nënës së tij, dhe paralajmërimin për bekimin me pejgamberi e umet të madh. Ndërsa ndodhia e rrëzimit të putave, dhe e lumturimit të vendit e Qabesë me lindjen e Pejgamberit, alejhi selam, e deri te marrja e vahjit dhe e publikimit të mrekullive përmes shpalljes së ajeteve të Kuranit jepen në pesëmbëdhjetë distikët e radhës.

Njëmbëdhjetë distikët në vazhdim i përshkruajnë disa nga mrekullitë e dukshme të Pejgamberit, alejhi selam, sikurse: mungesa e hijes së trupit të tij, pasi ishte i gjithi *nur*, një re që e shoqëronte ngado që shkonte, nxjerrja e ujit nga gishtërinjtë e tij sikurse një burim, mbjellja e hurmës, selami që ia dha pema etj.. Ndërsa, në 23 distikët e radhës flitet për mrekullinë e Israsë dhe të Miraxhit, për të vazhduar pas një distiku që fton për salavate, si një cesurë-pushim, edhe për 32 distikë. Në gjithë këto vargje kemi një dialog të Pejgamberit, alejhi selam, me Xhibrilin dhe përshkrimin e pozitës së Resulullahut te Zoti, duke i marrë porositë drejtpërdrejtë prej Tij, sikurse flasin edhe 35 distikët në vazhdim, njëherësh pjesën më të gjatë të mevludit. Në këtë pjesë prezantohet edhe obligimi me namaz pesë herë në ditë, dhe *dashnia* e Zotit për Pejgamberin, alejhi selam. Në këtë pjesë, nga distiku i njëzetetretë, e deri në fund të mevludit, poeti nis lutje drejtuar Zotit për hir të Pejgamberit, alejhi selam:

*Ja Rabi, për hir të pejgamberit tand
Mos na ndaj ne kurrë prej rahmetit tand*

*Tahir efendi
Popova nuk
deshti kurrë ta
mbyllte
mevludin e vet
duke e
përshkruar
edhe vdekjen e
Resulullahut.
Për shkak të
dashnisë që
kishte për
Pejgamberin,
alejhi selam,
nuk mundi t'i
bëjë ballë një
përfundimi me
vdekje, siç
përfundojnë
zakonisht
poemat-
rrëfimet që
flasin për jetën
e Resulullahut.*

*Ja Rrahman për hyrmet t'Esma-i Hynasë
Për dashni t'gjithë enbijasë dhe evlijasë*

Pas këtyre vargjeve poeti e përmbyll mevludin, duke e lënë Pejgamberin, alejhi selam, në një poezitë të lartë, menjëherë pas kryerjes së Israsë dhe Miraxhit, udhëtimit përtej qiejve e të takimit me Zotin.

DASHNIA PËR PEJGAMBERIN, ALEJHI SELAM

Dashnia për Pejgamberin, alejhi selam, për çdo mysliman është parim mbi të cilin ndërtohet besimi i tij. *Dashnia* për Resulullahun duhet të jetë edhe përtej *dashnisë* për veten, familjen dhe çdo gjë të kësaj bote. Sepse *dashina* për të është shërim i shpirtit. Sepse *dashnia* për të është një burim në të cilin sa më shumë që pi, aq më shumë ke etje. Sepse *dashnia* për të e shton përmallimin për të.

Rumi thoshte se “Zemra e ka gjuhën e vet, dhe ajo i di njëqind mijë mënyra për të folur”. Sigurisht se një nga mënyrat e shprehjes së *dashnisë* për Pejgamberin, alejhi selam, prej Tahir efendi Popovës ishte mevludi, 236 distikët e thurur me shumë ndjesi e semantikë. Dhe, ajo që e bën edhe më të veçantë është sidomos shprehja e *dashnisë* për Pejgamberin, alejhi selam, që prezantojnë këto vargje. E një *dashnie* që do të rrijë e gjallë gjithmonë. Sikurse jeta e Resulullahut e prezantuar në vargjet e këtij mevludi.

Tahir efendi Popova nuk deshti kurrë ta mbyllte mevludin e vet duke e përshkruar edhe vdekjen e Resulullahut. Për shkak të *dashnisë* që kishte për Pejgamberin, alejhi selam, nuk mundi t'i bëjë ballë një përfundimi me vdekje, siç përfundojnë zakonisht poemat-rrëfimet që flasin për jetën e Resulullahut. *Dashnia* e tij për Pejgamberin, alejhi selam, ishte shumë e madhe. Për *Resulin thoni me ashk: Es Salat'*, në mevludin e tij ai thirri hiç më pak se në dymbëdhjetë distikë, me funksion cesure, ndërsa ashku-*dashnia* për Resulullahun, është lajtmotivi që mbisundon gjithë vargjet. E, distiku që shpreh motivin e *dashnisë* me lot pa pushim, me mall e kujtim për Resulullahun është:

*N'qofsh ashik i Muhamedit, more vlla
Çoji salet tu e qajt hiç pa ja da*

Komentimi i sures El-Fet'h (9)

URTËSI NGA MARRËVESHJA PAQËSORE E HUDEJBIJES

Sabri Bajgora

هُم الَّذِينَ كَفَرُوا وَصَدُّوكُمْ عَنِ الْمَسْجِدِ الْحَرَامِ وَالْهَدْيِ مَعْكُوفًا
أَنْ يَبْلُغَ حُلَّةً وَلَوْلَا رِجَالُ الْمُؤْمِنُونَ وَنِسَاءُ الْمُؤْمِنَاتِ لَمْ تَعْلَمُوهُمْ أَنْ
تَطُؤُوهُمْ فَتُصِيبَكُمْ مِنْهُمْ مَعَرَّةٌ بِغَيْرِ عِلْمٍ لِيَدْخُلَ اللَّهُ فِي رَحْمَتِهِ مَنْ
يَشَاءُ لَوْ تَزَيَّلُوا لَعَذَّبْنَا الَّذِينَ كَفَرُوا مِنْهُمْ عَذَابًا أَلِيمًا ﴿25﴾
إِذْ جَعَلَ الَّذِينَ كَفَرُوا فِي قُلُوبِهِمُ الْحَمِيَّةَ الْحَمِيَّةَ الْجَاهِلِيَّةَ فَأَنْزَلَ
اللَّهُ سَكِينَتَهُ عَلَى رَسُولِهِ وَعَلَى الْمُؤْمِنِينَ وَأَلْزَمَهُمْ كَلِمَةَ التَّقْوَى
وَكَانُوا أَهَقَّ بِهَا وَأَهْلَهَا وَكَانَ اللَّهُ بِكُلِّ شَيْءٍ عَلِيمًا ﴿26﴾

“Janë jobesimtarët ata që ju penguan t’i afroheni Xhamisë së Shenjtë dhe (penguan) kurbanet të arrinin në vendin e vet. Sikur mos të ishin disa burra besimtarë dhe gra besimtare (në Mekë) që ju nuk i njihnit, e t’i sulmonit duke mos e ditur, e pastaj t’ju godiste turpërimi (do t’ju urdhëronte t’i luftonit jobesimtarët e Mekës), me qëllim që Allahu të merrte në Mëshirën e Vet atë që Ai do. E, po të ishin ata (banorët e Mekës) të ndarë veç e veç, Ne do t’i ndëshkonim jobesimtarët me një dënim të dhembshëm. Kur në zemrat e jobesimtarëve, u ndez fanatizmi i egër pagan, Allahu zbriti qetësinë e Vet mbi të Dërguarin e Tij dhe mbi besimtarët. Për ta zgjodhi Fjalën e Devotshmërisë, sepse ishin më meritoret dhe më të denjët për të. Allahu është i Gjithëdijsëm për çdo gjë.” – (El-Fet’h, 26-25)

SHKAKU I ZBRITJES SË AJETIT 25

- Transmetojnë Taberaniu, Ebu Ja’la, Ibn Mundhiri, Ibn Ebi Hatimi, Ibn Merduvejhi dhe të tjerë nga Ebu Xha’fer Habib bin Sibaë të ketë thënë: “Luftova kundër të Dërguarit të Allahut në fillim të ditës, duke qenë unë jobesimtar, dhe luftova në fund të ditës përkrah tij si besimtar. Ishim tre burra dhe shtatë gra, e në transmetimin e Ibn Ebi Hatimit, nëntë gra.¹ Për ne ka zbritur ajeti: “Sikur mos të ishin disa burra besimtarë dhe gra besimtare (në Mekë) që ju nuk i njihnit...”²

LIDHJA E KËTYRE AJETEVE ME ATO PARAPRAKE

Në ajetet paraprake, Allahu xh.sh. shpreh haptazi kënaqësinë e Tij ndaj besimtarëve të cilët iu besatuan të Dërguarit a.s. në Hudejbije se do të vdisnin për kauzën e besimit, e në të njëjtën kohë, i Madhërishmi i pengoi duart e idhujtarëve dhe të hebrenjve, që t’i dëmtonin myslimanët dhe

familjet e tyre, ashtu siç i ruajti edhe myslimanët nga gjakderdhja, duke e inspiruar të Dërguarin a.s. që të bënte marrëveshje paqësore me kurejshët, e cila do të rezultonte me efekte pozitive për myslimanët, për një kohë shumë të shkurtër.

Mbase, urtësia e kësaj marrëveshjeje paqësore që del në pah edhe në këto ajete që tash po i komentojmë, është prania e një numri të konsiderueshëm të besimtarëve brenda në Mekë, të cilët po e mbanin të fshehtë besimin e tyre, në mënyrë që në rast të mësymjes së myslimanëve për të luftuar e hyrë në Mekë, mund të ndodhte që pa qëllim, dikush prej tyre edhe të vritej nga duart e myslimanëve. Për këtë arsye, Allahu zbriti qetësi në zemrat e besimtarëve, duke i lënë idhujtarët të pëlcisnin nga mllef i dhe fanatizmi i tyre i egër i injorancës.

KOMENT:

25. Janë jobesimtarët ata që ju penguan t'i afroheni Xhamisë së Shenjtë dhe (penguan) kurbanet të arrinin në vendin e vet. Sikur mos të ishin disa burra besimtarë dhe gra besimtare (në Mekë) që ju nuk i njihnit, e t'i sulmonit duke mos e ditur, e pastaj t'ju godiste turpërimi (do t'ju urdhëronte t'i luftonit jobesimtarët e Mekës), me qëllim që Allahu të merrte në Mëshirën e Vet atë që Ai do. E, po të ishin ata (banorët e Mekës) të ndarë veç e veç, Ne do t'i ndëshkonim jobesimtarët me një dënim të dhembshëm.

Ky ajet fillon me një qortim të ashpër ndaj idhujtarëve mekas, duke i përshkruar ata me termin *jobesimtarë*,³ sepse pa kurrfarë të drejte kishin privuar besimtarët myslimanë që ta kryenin paqësisht umren, të cilëve po u printe vetë i Dërguari i Allahut. Ata jo vetëm që i penguan besimtarët ta kryenin tavafin e umres, por nuk i lejuan as kurbanet e tyre që ishin dedikuar për t'u flijuar, të arrinin në vendin e caktuar, në Mina. Një gjë e tillë nuk kishte ndodhur asnjëherë më parë në traditën arabe, sepse edhe nga vetë kjo traditë e idhujtarëve të Mekës, ndalohej pengimi i pelegrinëve dhe i kurbaneve të tyre të thereshin brenda hapësirës së asaj që quhet Harem, apo në Mina. Por, kësaj radhe, idhujtarët të mllefosur deri në palcë, që nuk kishin arritur dot t'i mposhtnin e t'i thyenin myslimanët, dhe të shtyrë më tepër edhe nga

*Të pajisur me
këtë moral kaq
të lartë e me
këtë disiplinë të
pashoqe,
myslimanët
nuk u
rrëmbyen dot
nga fanatizmi
dhe inati, siç
bënë idhujtarët
kurejshë,*

fanatizmi i tyre i verbër, ishin përgatitur që të mos lëshonin pe, dhe mos ta lejonin të Dërguarin a.s. që së bashku me sahabët e tij ta kryenin umren.⁴

Idhujtarët kurejshë, të cilët Allahu i Madhërishëm me plot të drejtë i quajti jobesimtarë, e kanë merituar dënimin e Allahut për shkak të tri gjërave: Për shkak të kufrit të tyre, për shkak të pengimit të Dërguarit a.s. dhe të besimtarëve ta kryenin umren, dhe për shkak se penguan kurbanet e myslimanëve të thereshin brenda hapësirës së Haremit, dedikuar për therje.⁵

Megjithatë, pas negociatave që u zhvilluan në mes dy palëve, u arrit Marrëveshja paqësore e Hudejbijes, në të cilën ndër të tjera parashihej që myslimanët të ktheheshin në Medinë pa e kryer umren, e këtë ta bënë vitin e ardhshëm, me ç'rast mekasit do ta lëshonin Mekën për tri ditë rresht. Pas arritjes së kësaj marrëveshjeje, e cila i hutoi një pjesë të madhe të sahabëve, i Dërguari a.s. urdhëroi, që kurbanet mos të ktheheshin në Medinë, por të thereshin aty ku ishin, pra në Hudejbije, ndonëse ky vend ishte jashtë perimetrit të Haremit. Ky veprim erdhi me porosi nga Allahu i Madhërishëm, të cilin e vuri në zbatim i Dërguari a.s..

Në vazhdim të ajetit të 25: "*Sikur mos të ishin disa burra besimtarë dhe gra besimtare (në Mekë) që ju*



nuk i njihnit, e t'i sulmonit duke mos e ditur, e pastaj t'ju godiste turpërimi (do t'ju urdhëronte t'i luftonit jobesimtarët e Mekës), me qëllim që Allahu të merrte në Mëshirën e Vet atë që Ai do...”, ashtu si pamë edhe nga shkaku i zbritjes së tij, shpërfaqet urtësia e madhe hyjnore, për të cilën dinin vetëm Allahu dhe i Dërguari i Tij, se brenda në Mekë, kishte një numër të konsiderueshëm të besimtarëve myslimanë, të cilët nga frika e represalieve të idhujtarëve, e mbanin të fshehtë Islamin e tyre. Pikërisht, për këta besimtarë dhe besimtare flet kjo pjesë e ajetit. Myslimanëve iu bëhet me dije se po mos të ishin brenda në Mekë, disa besimtarë, burra dhe gra, të cilët ju nuk i njihnit e as nuk dinit për ta, gjatë luftimeve brenda Mekës, ju edhe do të mund ta vrisnit dikë prej tyre, nga mosdija. Kjo do t'i turpëronte myslimanët, dhe do t'i bënte të ndiheshin keq e të ndjenin dhimbje për ata të pafajshëm, e përveç kësaj, idhujtarët do të thoshin me tallje e ironi: “ja këta po i mbytin të vetët”. Megjithatë, Allahu i pengoi duart e myslimanëve që të përlyheshin me gjakun e atyre të pafajshëmve që gjendeshin brenda në Mekë, sepse në një të ardhme shumë të afërt, Allahu do t'i fuste të gjithë ata besimtarë të mbetur në Mekë, nën hijen e mëshirës së Tij, kur do të çlirohej Meka nga kthetrat e idhujtarisë. Madje, edhe shumica dërmuese e idhujtarëve kurejshë, do të hynin nën hijen e kësaj mëshire hyjnore, sepse pas çlirimit të Mekës, të gjitha do të hynin në fenë e Allahut dhe do të rreshtoheshin në radhët e myslimanëve, për të qenë pjesë e ymetit, që do të shkruante fletët më të lavdishme e më të ndritshme të historisë islame.⁶

Ajeti i 25 i kësaj sureje përfundon me konstatimin: “E, po të ishin ata (banorët e Mekës) të ndarë veç e veç, Ne do t'i ndëshkonim jobesimtarët me një dënim të dhembshëm.” Kjo nënkupton se po të ishin të ndarë besimtarët e fshehtë në Mekë, në një pjesë të caktuar të qytetit, kurse idhujtarët mekas në një pjesë tjetër, ose po që se besimtarët do ta lëshonin Mekën, para se të fillonte lufta, atëherë Ne, padyshim që do t'i ndëshkonim jobesimtarët me dënim të dhembshëm nëpërmjet duarve të myslimanëve, që ishin të gatshëm të vdisnin nën komandën e Resulullahut s.a.v.s..

*Myslimanët
thjesht,
respektuan
shenjtërinë e
Qabesë, dhe
nuk u lëshuan
në nivelet e
ulëta të
fanatizmit,
sepse Allahu i
kishte gatuar
zemrat e tyre
me brumin e
Fjalës së
Njëshmërisë e
të devotsh-
mërisë, me
dëshminë e
lartë islame se
Allahu është i
Vetmi që
meriton të
adhurohet: “La
ilahe il-la
Allah”*

26. Kur në zemrat e jobesimtarëve, u ndez fanatizmi i egër pagan, Allahu zbriti qetësinë e Vet mbi të Dërguarin e Tij dhe mbi besimtarët. Për ta zgjodhi Fjalën e Devotshmërisë, sepse ishin më meritoret dhe më të denjët për të. Allahu është i Gjithëdijshëm për çdo gjë.

Pikërisht në kohën kur në zemrat e idhujtarëve u ndez fanatizmi i egër pagan, duke u betuar në dy idhujt e tyre, Latin dhe Uzanë, se nuk do t'i lejonin myslimanët në asnjë mënyrë të hynin në Mekë, dhe nuk pranuan të shkruanin në marrëveshje fjalën: “Bismil-lahi-r-Rrahmani-r-Rrahim”, e as ta shkruanin: “Muhamedi i Dërguari i Allahut”, por insistuan të shkruhej “Bismike Allahumme” dhe “Muhamedi i biri i Abdullahut”, atëherë Allahu i Plotfuqishëm me urtësinë e Tij, zbriti qetësinë “es-sekinetu” në zemrën e të Dërguarit a.s. dhe në zemrat e besimtarëve.⁷ Fjala “zbriti” nënkupton nderimin e besimtarëve me zbritjen e prehjes dhe qetësisë shpirtërore nga një vend “i lartë”, nga ana e Allahut të Madhërisë, sepse pas kësaj qetësie shpirtërore, i Madhërismi përzgjedhi për ta “Fjalën e Devotshmërisë”, sepse vërtet ishin më meritoret dhe më të denjët për të. Ata merituan mëshirën e Allahut, sepse iu bindën të Dërguarit a.s., që të pajtoheshin me Marrëveshjen e Hudejbijes, e cila marrëveshje me plot të drejtë u cilësua nga Allahu si “Fitore e madhe-Fet'hun mubin”.

Të pajisur me këtë moral kaq të lartë e me këtë disiplinë të pashoqe, myslimanët nuk u rrëmbyen dot nga fanatizmi dhe inati, siç bënë idhujtarët kurejshë, duke thyer traditat e vizitës së Shtëpisë së Shenjtë, të cilat parashihnin si rregull të prerë, se askush nuk mund të privohet nga vizita e saj, traditë kjo që respektohej gjithandej nga fiset arabe të Gadishullit Arabik. Myslimanët thjesht, respektuan shenjtërinë e Qabesë, dhe nuk u lëshuan në nivelet e ulëta të fanatizmit, sepse Allahu i kishte gatuar zemrat e tyre me brumin e Fjalës së Njëshmërisë e të devotshmërisë, me dëshminë e lartë islame se Allahu është i Vetmi që meriton të adhurohet: “La ilahe il-la Allah”.⁸

Nuk ka dyshim se Allahu është i Gjithëdijsëm për çdo gjë që ndodh e që do të ndodh në proceset e kësaj ekzistence, sepse Atij nuk mund t'i fshihet asnjë veprim, qoftë ai edhe mendim i pashprehur me gojë.

Porosia e këtyre ajeteve

- Idhujtarët kurejshë, të shtyrë nga urrejtja dhe fanatizmi i tyre i egër, ishin këmbëngulës që të pengonin myslimanët të hynin në Mekë. Përveç kësaj ata penguan edhe kurbanet e dedikuara për flijim, që të arrinin në Mina, gjë që nuk kishte ndodhur asnjëherë më parë. Kurejshët, me këtë veprim të paprecedent, kishin thyer traditën e hershme arabe dhe kishin cenuar shenjtërinë e Shtëpisë së bekuar – Qabesë.

- Jeta e një besimtarë është e shenjtë tek i Lartmadhërishmi, sepse Marrëveshja e Hudejbijes u bë vetëm e vetëm që të ruheshin jetët e pafajshme të tre burrave besimtarë dhe shtatë apo nëntë grave besimtare që gjendeshin brenda në Mekë, por që e mbanin të fshehur besimin e tyre.

- Jeta e një besimtarë është e shenjtë tek i Lartmadhërishmi, sepse Marrëveshja e Hudejbijes u bë vetëm e vetëm që të ruheshin jetët e pafajshme të tre burrave besimtarë dhe shtatë apo nëntë grave besimtare që gjendeshin brenda në Mekë, por që e mbanin të fshehur besimin e tyre.

- Allahu në çastet më kritike e të vështira për besimtarët, kishte zbritur qetësinë në zemrat e tyre duke i pajisur njëkohësisht me madhështinë e durimit, sepse ata ishin prijës në devotshmëri dhe më të denjit për mëshirën e Allahut Fuqiplotë.

- vijon -

1 Në lidhje me emrin e saktë të këtij transmetuesi kthehu te *Tefsiri i Ibn Kethirit*, Giza-Egjipt, 2000, vëll. 13, f. 112.

2 *Lubabu-n-nukul fi esbabi-n-nuzul*, f. 237; Isam bin Abdulmuhsin el Humejdan, *Es-Sahihu min esbabi-n-nuzuli*, Bejrut, 1999, f. 293.

3 Grup autorësh, *Et-Tefsir el mevdui li suveri-l Kuran*, vëll. VII, f. 319.

4 Muhamed Ali es-Sabuni, *Et-Tefsiru-l vadih el mujesser*, Bejrut, 2007, f. 1294.

5 Ismail Haki, *Ruhul Bejan*, Istanbul, 1926, vëll. IX, (xhuzi 26), f. 48.

6 *Tefsir sureti-l Fet'h*, f. 127.

7 Mahmud Hixhazi, *Et-Tefsiru-l vadih*, Kajro 1975, vëll. III, f. 492.

8 *El-Bahru-l medid fi tefsiri-l Kitabi-l Mexhid*, f. 404.



Kaptina Fatiha

- ndërtimi i personalitetit

Dr. Valmire Batatina-Krasniqi

Ndjekja e parimeve në të cilat thërret Kurani i madhërishëm ndihmon në zhvillimin, lidhjen dhe mirëkuptimin e individëve në mes vete, si dhe në formimin e një perspektive, strategjie dhe ideali të përbashkët. Njëra ndër kaptinat që flet në mënyrë të përgjithshme mbi këtë qëllim themelor është edhe kaptina Fatiha, kaptina e hyrjes, sepse hyrja në këtë libër të famshëm fillon me këtë

kaptinë, e që në radhitjen kuranore është e para, ani pse nuk është e zbritur e para. Në këtë kaptinë të shkurtër prej shtatë ajetesh janë përmbledhur: besimi në një Zot të vetëm, Krijues i përgjithshëm, i emërtuar e i cilësuar me emrat më të bukur, besimi në ringjallje, në jetën e pasosur në botën tjetër, në përgjegjësinë para Zotit, në Ditën e Gjykimit dhe në shpërblimin me të mira ose me ndëshkime për veprat e bëra në këtë jetë, besimi dhe bindja e patundshme se vetëm Zotit i takon adhurimi dhe se të gjitha të mirat duhen kërkuar vetëm prej Tij, besimi në ligjin e Zotit sipas të cilit të gjitha të mirat ua dhuroi atyre që ndoqën rrugën e drejtë dhe i ndëshkoi ata të cilët u larguan dhe humbën vetveten. Përveç të tjerash, kjo kaptinë është një lutje që Allahu i Lartësuar ua mëson lexuesve të librit të Tij.

EMËRTIMI I KËSAJ KAPTINE

Kjo kaptinë është emërtuar “El Fatiha” (Hapësja), ngase Kurani hapet me të ashtu si namazi, “Ummu’l-Kitab (Nëna e Librit),¹ “Es-Sebu’l-Methani (Shtata e përsëritur). Është quajtur gjithashtu “El-Hamdu”, për shkak të fjalëve të para në ajetin: “Elhamdulilahi” (E tërë lavdia i takon vetëm Allahut). Kjo sure është e quajtur edhe me emra të tjerë si: “Es-Salah” (Falja), “Esh-Shifa’u” (Shërimi), “Er-Rukjeh” (Lutja kuruese), “El-Vakije” (Mburoja), “El-Kafije” (e Mjaftueshmja), “Suretu’s-Salah” (Kaptina e namazit), “El-Kenz” (Thesari) etj..

*Muhamedi
a.s., është
fryma e vërtetë
e Kuranit, në të
cilën
realizohen të
gjitha kuptimet
e mundshme
kuranore dhe
urtësia
hyjnore.*



RËNDËSIA DHE VLERA E KËSAJ KAPTINE

Për rëndësinë dhe vlerën e lartë të kaptinës Fatiha, Buhariu shënon në Sahihun e tij, se Pejgamberi a.s. i kishte thënë Ebi Seid ibni Muallasë: “Do të të mësojë një sure, që është më e madhja e sureve të Kuranit: “*Elhamdu lil-lahi Rabbil alemin*”, kjo është Es-Seb’ul Methanij dhe Kurani madhështor, që më është dhënë mua!”² Po ashtu shënon Muslimi në Sahihun e tij, se transmetohet prej Ibën Abbasit të ketë thënë: “Kur Xhibrili ishte ulur me të Dërguarin e Zotit a.s., ai dëgjoji një zhurmë kërcitjeje mbi të. Ai ngriti kokën dhe tha: “Kjo është një portë që u hap sot dhe nuk është hapur kurrë më parë.” Dhe kur një melaqe zbriti përmes tij, ai tha: “Ky është një melek, i cili zbriti në tokë dhe që kurrë nuk ka zbritur më parë.” Ai erdhi te profeti a.s. dhe i tha: “Gëzohu për dy dritat që të janë dhënë ty, të cilat nuk i janë dhënë asnjë profeti: Fatiha el-Kitab” (Hapësja e Kuranit) dhe vargjet përfunduese të sures El Bekare. Nuk do të lexosh qoftë edhe një shkronjë të vetme prej tyre e të mos jepet shpërblim.”³ Po ashtu në lidhje me vlerën e kësaj kaptine, Imam Ahmedi shënon në Musned: “Ubej ibni Kabi e lexoi këtë sure pranë Pejgamberit a.s., e ai tha: “Për Atë, në Dorën e të cilit është shpirti im, sikur kjo sure nuk ka zbritur në Tëvrat, as në Inxhil, as në Zebur, e as në Kuran, kjo është Es Seb’ul Methanij dhe Kurani madhështor, i cili më është dhënë mua.”⁴

Sipas Alusit, kaptina Fatiha, edhe pse është e shkurtër, rëndësia e saj qëndron në faktin se në vete ngërthen katër tematikat themelore të fesë. E para, teuhidin (njësimin e Zotit), dëshmon për vërtetësinë e institucionit të profetësisë dhe Ditën e Gjykimit. E dyta, shkencën e ibadeteve, thekson bindjen se vetëm Zotit i takon adhurimi dhe se të gjitha të mirat duhen kërkuar vetëm prej Tij. E treta, shkencën e ahlakut, kërkimin për udhëzim dhe arritjen e kënaqësisë së Zotit. E katërta, shkencën e tregimeve kuranore, për të mirat që ua dhuroi atyre që ndoqën rrugën e drejtë dhe ndëshkimin për ata të cilët u larguan dhe humbën rrugën e drejtë.⁵

RËNDËSIA E KAPTINËS FATIHA NË NDËRTIMIN E PERSONALITETIT

Zoti i Madhërishtëm i dhuroi njeriut prirje dhe aftësi mendore përmes së cilave percepton, kupton, mediton dhe nxjerr konkluzione mbi të mirën dhe të keqen. Krahës kësaj, Ai, nëpërmjet pejgamberëve dërgoi shpallje, duke furnizuar njeriun me dije mbi qëllimin e jetës, vlerat dhe kualitetet

*Muhamedi
a.s., është
fryma e vërtetë
e Kuranit, në të
cilën
realizohen të
gjitha kuptimet
e mundshme
kuranore dhe
urtësia
hyjnore.*

etike, si dhe ua besoi detyrën që shpalljen hyjnore t’ua komunikojnë njerëzve, duke ua treguar rrugën e vërtetë. Kurani gjithashtu tërheq vëmendjen për domosdoshmërinë e studimit të natyrës njerëzore dhe karakteristikave të saj. Nisur nga ky fakt, qëllimi parësor i thirrjes është që shpirti dhe mendja e njeriut të jenë të përshtatshme për edukim në frymën kuranore, edukim ky që nënkupton zhvillimin e aftësive dhe vlerave të pastra të qenies njerëzore në përputhje me natyrën/fitren dhe integritetin e saj. Nga ky këndvështrim, kaptina Fatiha, zë një vend të rëndësishëm për sa i përket mbështetjes së individit në edukimin e tij shpirtëror, kuptimit të jetës së tij, si dhe përballjes me sfida gjatë jetës së tij.

Përmendja e Besmeles në Kuran është formë për të shprehur se çdo vepër e mirë fillon me përmendjen e Zotit të Plotfuqishëm, për hir të Tij, duke rikujtuar përherë mundësinë që Ai ia dha njeriut për të vepruar atë. Taberiu në këtë kontekst përmend se Zoti i Lartësuar e mësoi profetin e Tij, Muhamedin a.s. që të fillonte veprat e tij me përmendjen e emrave të Tij të bukur përpara çdo çështjeje të rëndësishme. Kështu që kur ndonjëri thotë: “Bismillahi er-Rrahmani er-Rrahim,” dhe fillon të këndoje një sure nënkupton se, po

këndoje me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit. Ngjashëm me thënien e dikujt “Bismillah”, para se të ulet apo të ngrihet, apo diçka tjetër, që mbart kuptimin e kësaj thënieje, e që është, ngrihem me emrin e Allahut, ulem me emrin e Tij.⁶ Kësisoj njeriu që fillon të lexojë Fatihan ose ndonjë pjesë të Kuranit duke filluar me këtë sintagmë formëson personalitetin e tij me përmendjen e Zotit, jeta e tij është në përputhje me këtë parim dhe çdo vepër e kryer bëhet për hir të Tij. Në Kuran thuhet: “*Thuaj: “Namazi im, kurbani im, jeta ime dhe vdekja ime janë thjesht për Allahun, Zotin e botëve.”*”⁷ Besmeleja kujton natyrën e vetë njeriut, e cila ka një vend të rëndësishëm në formimin e personalitetit të tij, ngase njeriu i cili bënë çdo vepër duke rikujtuar dhe përmendur Zotin, njëkohësisht i rikujton vetes qëllimin për të cilin është krijuar dhe strukturën/fitretin e tij.

Fillimi i kaptinës me frazën “E tërë lavdia i takon vetëm Allahut, Zotit të botëve”, dëshmon se falënderimin dhe lavdërimin në kuptimin më të lartë ia shprehim vetëm Zotit, i Cili na dhuron nga të mirat e Tij vazhdimisht, që është posedues i cilësive dhe veprave të mrekullueshme ndër të cilat edhe drejtësia dhe bamirësia e Tij absolute. E gjithë mirënjohja (falënderimi) i përket vetëm Zotit, veças prej të


gjithë atyre që adhurohen në vend të Tij, për begatitë e pallogaritshme që u ka dhënë robërve të Tij, për shëndetin të cilin ua siguron organeve të trupit, dhe për fuqinë e gjymtyrëve të trupit, gjëra këto që duhet të përdoren në zbatimin e urdhrave të Tij. Prandaj, për të gjitha këto, falënderimet dhe lavdërimet i përkasin vetëm Zotit të Lartësuar, në fillim dhe në mbarim.⁸ Shprehja “Allah” është emër i veçantë i Zotit dhe nëpërmjet këtij emri shprehet bindja dhe besimi, se vetëm Ai është i adhuruar, se vetëm Ai meriton të adhurohet, prandaj kur themi Allah, ne përveç besimit në Zotin Një, shprehim besimin se Atë e adhurojmë dhe e respektojmë. Ndërsa shprehja “Rabb” do të thotë: Zot, Krijues i gjithësisë, Udhëheqës, Rregullues, i Gjithëfuqishëm etj., Zot i atij që e beson, si edhe i atij që nuk e beson. Nisur nga këtu, ky ajet i mëson njeriut se si të fillojë një fjalim dhe çfarë lloj shprehjesh të përdorë në fillim të tij, ngase një individ që nuk di të falënderojë atë që është burimi i të gjitha të mirave dhe bukurive, i cili i dhuroi shumë begati, nuk mund të ketë një personalitet të mirë. Kjo sepse sikur që falënderimi dhe lavdërimi ndaj Allahut bëhet shkak për shtimin e mirësive, mos falënderimi dhe injorimi i rrugës së drejtë e bën njeriun meritë për dënimin e Tij.

*Muhamedi
a.s., është
fryma e vërtetë
e Kuranit, në të
cilën
realizohen të
gjitha kuptimet
e mundshme
kuranore dhe
urtësia
hyjnore.*

Fjala “alemin” është shumë e fjalës alem që do të thotë botë.⁹ Frazja “Zoti i botëve” nënkupton që Zoti i Madhërishëm është unik dhe absolut në aspektin e krijimit, administrimit dhe bamirësisë ndaj krijesave të Tij dhe është i vetmi që duhet të adhurohet. Ai është unik dhe absolut në panevojshmërinë e Tij ndaj të tjerëve, ndërkohë që të tjerët janë pafundësisht të varfër dhe nevojtarë për mëshirën e Tij në çdo këndvështrim. Individit që ndërton jetën e tij mbi këto parime formësohet si një personalitet ideal.

Në ndërtimin e personalitetit është jashtë-zakonisht e rëndësishme që përveç të tjerash, të kihet parasysh se Zoti është i Gjithëmëshirshëm dhe Mëshirëbërës i madh. Sepse ndërtimi i personalitetit mbi këtë parim, bënë që njeriu të jetë i mëshirshëm ndaj njerëzve dhe të gjitha krijesave që rrethojnë atë. Zoti, i cili është pronar i botëve, është i Gjithëmëshirshëm ndaj krijesave të Tij në këtë botë dhe Mëshirëbërës në botën e përjetme. Në fakt, mëshira në formën e saj të plotë përfshin vetëm të devotshmit dhe pasuesit e denjë të të dërguarave të Tij, kurse të tjerët do të shijojnë vetëm një pjesë të saj në këtë botë. Allahu është Er-Rrahim / Mëshirëbërës i madh veçanërisht ndaj besimtarëve.

Në ajetet e mësipërme të kësaj kapitule, pasi që vihet në pah falënderimi, fuqia dhe



madhështia e Zotit të botëve dhe mëshira e Tij, në ajetin e tretë duke tërhequr vëmendjen në ditën e llogarisë thuhet “Sunduesit në Ditën e Gjykimit”. Allahu është i vetmi udhëheqës në Ditën e Gjykimit, në Ditën e Kiametit, në ditën kur dhurohen shpërblimet dhe ekzekutohen ndëshkimet. Njeriu, duke e njohur faktin se zotërimi dhe mbikëqyrja e Krijuesit ndaj krijesave në këtë botë vazhdon me kërkim llogarie në botën tjetër, arrin një nivel më të lartë të njohurive mbi fuqinë Zotit dhe po ashtu arrin të vë nën kontroll jetën e tij. Si rrjedhojë, besimi në botën tjetër i ndihmon atij të ndërtojë një perspektivë njohëse të jetës në këtë botë, sepse me besimin dhe mendimin për botën tjetër, ai kupton se jeta e tij një ditë do të përfundojë, por se nuk do të zhbëhet e të humbasë. Duke pasur parasysh ringjalljen dhe llogaridhënien para Krijuesit, do të kuptojë rëndësinë e dërgimit të tij në këtë botë.

Fraza “Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë!” e përmendur në këtë kaptinë dëshmon se përderisa e tërë çështja në këtë dhe në jetën tjetër është vetëm në kompetencën e Allahut, atëherë çdo veprim e bëjmë në shenjë adhurimi ndaj Tij, dhe për çdo nevojë i drejtohem vetëm Atij. Po ashtu për çdo nevojë ose për çdo ndihmë ne duhet të kërkojmë vetëm prej Tij, sepse dora e mëshirës dhe e ndihmës së Tij gjithnjë është e shtrirë për ata të cilët i drejtohen sinqerisht. Kërkimi i ndihmës nga Allahu mund të ketë një efekt pozitiv në marrëdhëniet e individit me të tjerët. Fakti që një person ndjen gjithmonë afërsinë dhe ndihmën e Allahut në këndvështrimin e tij ndaj jetës dhe rrethit në të cilin gjendet, e shtyn atë të shfaqë një qëndrim optimist dhe pozitiv në raport me të tjerët. Struktura e fjalëve në këtë kaptinë veçohet me disa dobi dhe elokuenca, edhe pse pak janë ata që e përdorin përveç disa prej ekspertëve të gjuhës dhe elokuençës.

Meqë vetëm Atë e adhurojmë dhe vetëm prej Tij kërkojmë ndihmë, në ajetet 6 dhe 7 të kësaj kaptine vihet në theks rëndësia e duasë/lutjes drejtuar Atij. Njerëzit aplikojnë duanë si mbështetje më të madhe shpirtërore si në realizimin e dëshirave të tyre ashtu edhe në tejkalimin e vështirësive që hasin. Prandaj, dua e cila është një nga konceptet që ajeti dëshiron të ndërtojë në mendjen e të adresuarit, është një nga domosdoshmëritë e jetës. Ajo që e bën lutjen një dimension të domosdoshëm të veprimtarive shpirtërore të njeriut është

*Muhamedi
a.s., është
fryma e vërtetë
e Kuranit, në
të cilën
realizohen të
gjitha
kuptimet e
mundshme
kuranore dhe
urtësia
hyjnore.*

se ajo vjen si një reagim i natyrshëm. Po ashtu dua e cila është një nga gjërat që e bën njeriun të vlefshëm te Zoti i tij dhe i jep personalitet të butë. Të jesh në gjendje të lutesh do të thotë të jesh në gjendje të konceptosh, të njohësh dhe të jesh i vetëdijshëm për veten. Nisur nga këtu, në këto ajete shprehet dua e cila për ndihmë në të gjitha veprimet dhe adhurimet, në gjetjen e rrugës së fatbardhësisë, rrugën e atyre që ishin para nesh e të cilëve u dhuroi të gjitha të mirat, rrugën e pejgamberëve dhe njerëzve të mirë. Duanë për ndihmë që të mos i afrohem rrugës së gabuar, rrugës së atyre që me vetëdëshirë e merituan mallkimin dhe u larguan nga e vërteta. Ky është kuptimi i shprehjes “Ihdina” - udhëzoni, në këtë kaptinë. “Hidajeti” i shprehur në shumë vende në Kuran, ndonjëherë ka kuptimin e udhëzimit e të udhërrëfimit, e ndonjëherë udhëzim të bashku me ndihmë. Një lloj udhëzimi apo udhërrëfimi u është ofruar të gjithë njerëzve, por disa e pranuan dhe e gëzuan, e disa të tjerë nuk e pranuan atë, prandaj mbetën të humbur e të hutuar.

Kaptina Fatiha është një shembull tipik se si duhet të formësohet një personalitet i mirë, e me këtë edhe një shoqëri. Leximi i kaptinës Fatiha në çdo rekat dhe dua e përfshirë në këtë kaptinë ofron një ndjenjë lehtësimi të besimtari, ngase me këtë përjeton ndjenjën e të qenit në praninë e Krijuesit si një përjetim i lartë shpirtëror, sepse qëllimi i soditjes që bëhet në adhurim ose në përvojën fetare është krijimi i lidhjes me Zotin dhe përlulja ndaj madhërisë së Tij.

1 Taberi, Xhamiu'l-Bejan, v. I, 74.

2 Buhari, Tefsir, v.I.

3 Muslim, Salat, nr.38.

4 Ahmed b. Hanbel, Musned, v. V.

5 Alusi, Ruhul-Meani, v. I, 36.

6 Taberi, Xhamiu'l-Bejan, v. I, 11-112.

7 Enam, 6/162.

8 Ibën Kethir, Tefsiru'l-Kurani'l-Adhim, v. I, 19.

9 Me fjalën “alemin” botët ndonjëherë ka si qëllim të shprehë kuptimin e përgjithshëm, që përfshin këtë ekzistencë, jetën në varreza - Berzah, botën tjetër. Ndonjëherë shpreh kuptimet: bota shtazore, bota bimore, bota minerale. Përdoret edhe për botën trupore-fizike e botën shpirtërore.

Mrekullitë historike të Kuranit (2)

PUSHTIMI I MEKËS

Mimoza Sinani

Një natë në Medine, Pejgamberi a.s. pa në ëndërr se besimtarët do të hynin të sigurt në Xhaminë e Shenjtë dhe do të rrotulloheshin përreth Qabesë. Në suren El-Fet'h, Zoti i shpalli Pejgamberit se do ta ndihmonte dhe do ta përkrahte, se kjo ëndërr do të realizohej dhe se besimtarët do të hynin në Mekë: "Allahu ëndërrën e të Dërguarit të Vet e vërtetoi me realitet, se me vullnetin e Allahut do të hyni në Xhaminë e Shenjtë (në Qabe) të siguruar, t'i rruani flokët e kokave tuaja, t'i shkurtoni e nuk do të keni frikë! Pra Ai ka ditur atë që ju nuk e dinit, para kësaj ju dha një fitore të shpejtë (Hajberin)." (El-Fet'h, 27).

Por në kohën kur Pejgamberi ynë ua kumtoi këto lajme të gëzuara besimtarëve, situata nuk ishte aspak e përshtatshme. Këta besimtarë, që kishin migruar bashkë me të nga Meka në Medine, nuk kishin mundur të ktheheshin më në Mekë që atëherë. Përveç kësaj, paganët dukeshin të vendosur që të mos i lejonin besimtarët që të rifuteshin në Mekë.

Por e gjithë kjo ndryshoi brenda një kohe të shkurtër. Fillimisht u nënshkrua Traktati i Hudejbijes dhe më pas u mor Meka. Besimtarët hynë në Xhaminë e Shenjtë në siguri të plotë, ashtu sikurse ishte parashikuar në ajet. Kështu, Zoti tregoi se lajmet e gëzuara që i kishte kumtuar Pejgamberit ishin të vërteta. Ajetet të tjera, që japin lajmet e gëzuara të marrjes së Mekës, janë si vijon:

"Ne ty të dhamë një fitore të sigurt. Ashtu që Allahu të liroi ty prej mëkateve të mëparshme dhe prej atyre të mëvonshme dhe ashtu të plotëson mirësinë e Vet ndaj teje e të orienton ty

në rrugën e drejtë. Dhe që Allahu të ndihmon ty me një ndihmë të fortë." (El-Fet'h, 1-3).

FISI I ISRAELIT DO TË BËHET ARROGANT

"Ne u kumtuam në libër Beni Israilëve: "Ju do të bëni shkatërtime dy herë në tokë dhe do të tejkaloni duke bërë zullum të madh". Kur erdhi koha e premtimit të parë, Ne dërguam kundër jush njerëzit Tanë, që ishin të fuqishëm e të ashpër dhe ata hulumtuan përreth vendit (duke mos u frikësuar). E ai (ndëshkim) ishte vendim i prerë. Pastaj, Ne ua kthyem juve mbisundimin kundër atyre, ju përforcuam me pasuri e me djem dhe ju shtuam më së shumti." (El-Isra, 4-6).

Sikurse tregohet në këto ajete, Bijtë e Izraelit do të bëjnë dy shkatërtime në tokë.

I pari ishte kur ata vranë pejgamberin Gjon dhe bënë kurth për të vranë pejgamberin Jezus (paqja qoftë mbi të dy). Më pas, ata u syrgjynosën nga Jerusalemi prej romakëve në vitin 70 dhe u endën në të gjithë botën. Kur iu shpall ky ajet Pejgamberit a.s., çifutët ishin duke jetuar në vende të ndryshme dhe nuk kishin shtet të tyrin. Por në ajetet kuranore Zoti tregon se një ditë Bijtë e Izraelit do ta marrin përsëri fuqinë e tyre. Megjithatë, në atë kohë, dukej pothuajse e pamundur që kjo të ndodhte realisht.

Por, shumë shekuj më vonë, kjo ngjarje e shpallur nga Zoti në ajetet kuranore u bë e vërtetë.

Çifutët u kthyen në Palestinë dhe themeluan shtetin e Izraelit në vitin 1948. Më vonë,

Muhamedi a.s., është fryma e vërtetë e Kuranit, në të cilën realizohen të gjitha kuptimet e mundshme kuranore dhe urtësia hyjnore.

qëndrimet e disa qarqeve raciste që jetonin në Izrael e çuan Lindjen e Mesme drejt çrregullimit. Shteti i sotëm është shenjë e “shkatërrimit” të dytë të Bijve të Izraelit.

Megjithatë, është e rëndësishme të vihet në dukje se kjo sjellje e keqe sigurisht nuk vlen për të gjithë çifutët, mbasi shumë çifutë janë individë të ndërgjegjshëm dhe me gjykim të shëndoshë, që nuk pajtohen me një sjellje të tillë.

Qarqe të caktuara raciste dhe radikale kanë nevojë që të “kërkojnë falje” ashtu si rekomandohet nga Zoti ynë. Nëse ata e pasojnë këtë rrugë, atëherë është e qartë se, me vullnetin e Zotit, një ambient paqeje dhe vëllazërie mund të vendoset përsëri, mbasi në Kuran thuhet: *“Nuk është e barabartë e mira dhe e keqja. Andaj, (të keqen) ktheje në mënyrën më të mirë, se atëherë ai, me të cilin kishit njëfarë armiqësie, do të bëhet mik i afërt.”* (Fussilet, 34).

Një nga pikat më të rëndësishme në ajetet e sures El-Isra, në lidhje me Bijtë e Izraelit, është se ato shpallën se këto ngjarje do të ndodhnin në të ardhmen, ngjarje të cilat dukeshin të pamundura në atë kohë dhe për të cilat nuk ekzistonte as shenja më e vogël se do të realizoheshin ndonjëherë. Fakti se i gjithë ky informacion është bërë i ditur shekuj më parë është pa dyshim një nga mrekullitë e Kuranit.

EKSPLORIMI I HAPËSIRËS

Eksplorimi i hapësirës nga ana e njeriut u përshpejtua me satelitin sovjetik Sputnik, në 4 tetor të vitit 1957, lëshimin e suksesshëm të të cilit NASA e konsideroi si “Fillimin e Epokës së Hapësirës”. Njeriu i parë që doli nga atmosfera e tokës ishte kozmonauti sovjetik Juri Gagarin, që hyri në hapësirë në anijen kozmike Vostok në vitin 1961. Njerëzit shkelën në hënë, më 20 korrik të vitit 1969, me misionin amerikan Apollo 11. Në fakt, në Kuran është shpallur se zhvillime dhe arritje të tilla do të realizoheshin një ditë.

Dhe kjo është shpallur 14 shekuj më parë, në një kohë kur nuk ekzistonte asnjë anije kozmike e pajisur me teknologji të përparuar!

“O turmë e xhinëve dhe e njerëzve, nëse keni mundësi të dilni përtej kufijve të qiejve e të tokës, depërtoni pra, po nuk mundeni vetëm me ndonjë fuqi të fortë.” (Er-Rahman, 33).

Një shqyrtim i kujdesshëm tregon se ajeti thekson se njerëzimi do të jetë në gjendje që të futet në thellësitë e tokës dhe të qiellit, por vetëm me një fuqi të madhe. Sipas të gjitha gjasave, kjo fuqi e madhe është teknologjia e lartë e përdorur në shekullin XX. Në fakt, këto lajme të kumtuara nga Zoti në



Kuran ndodhën falë teknologjisë së përparuar të shekullit XX.

TRANSMETIMI I LAJMIT

“E ai i cili kishte dituri nga libri tha: “Unë ta sjell atë ty sa çel e mshel sytë!” E kur e pa atë (fron) të vendosur pranë tij, (Sulejmani) tha: “Kjo është dhuntia e Zotit tim që të më sprovtojë mua se a do ta falënderoj, apo mos do ta përbuz...” (En-Neml, 40).

“Ai i cili kishte dituri nga Libri” i tha pej-gamberit Sulejman (paqja qoftë mbi të) se mund t’ia sillte fronin e Mbretëreshës së Sebës tepër shpejt.

Këtu është treguar një fakt tjetër tërheqës: përcimi i imazheve me teknologjinë e përparuar të ditëve të sotme. Në një ajet tjetër, në lidhje me këtë çështje, thuhet: “Njëri prej xhinëve të vrazhdë (Ifriti) tha: “Unë do ta sjell atë ty para se të ngrihesh nga vendi yt, unë për të kam fuqi dhe jam i sigurt!” (En-Neml, 39)

Në ditët tona, informacioni i të gjitha llojeve mund të dërgohet kudo në botë brenda disa sekondash, falë internetit dhe përparimeve në teknologjinë kompjuterike. Për më tepër, kërkimet për transmetimin e lajmeve janë duke vazhduar.

Sipas një njoftimi të CNN-it, më 17 korrik të vitit 2002, një grup fizikanësh nga Universiteti Kombëtar Australian në Kanberra, zbërtheu një rreze laser dhe e “transmetoi” atë disa metra. Ping Koi Lam, kryesuesi i ekipit, njoftoi se transmetimi i lëndës në gjendjen e saj atomike mund të bëhet realitet në të ardhmen. Kjo është pikërisht ashtu siç është shpallur në ajetet kuranore...

KURANI ËSHTË SHPALLJE E ZOTIT

Kurani është fjalë e Zotit të Gjithëfuqishëm, Filluesit të gjithçkaje, që përfshin çdo gjë me dijen e Tij. Një prej dëshmive të panumërta të kësaj është se ajetet e tij përmbajnë fakte rreth çështjeve shkencore, të së kaluarës dhe të së ardhmes, që askush nuk mund t’i dinte. Dhe për më tepër e gjithë kjo është shpallur 14 shekuj më parë...

Çdo pjesë informacioni që përmban Kurani zbulon mrekullitë sekrete të këtij libri hyjnor. Në një ajet Zoti thotë: “...A nuk e përfillin ata (me vëmendje) Kuranin? Sikur të ishte prej dikujt tjetër, përveç prej Allahut, do të gjenin në të shumë kundërthënie.” (En-Nisa, 82).

Kuptohet se njerëzit duhet t’i përmbahen fort këtij Libri Hyjnor të shpallur nga Zoti dhe duhet ta marrin atë si udhërrëfyes të tyre në jetë. Në Kuran, Zoti na thotë si vijon: “Nuk është e logjikshme të mendohet se ky Kuran është i trilluar

Muhamedi
a.s., është
fryma e vërtetë
e Kuranit, në të
cilën
realizohen të
gjitha kuptimet
e mundshme
kuranore dhe
urtësia
hyjnore.

prej dikujt pos Allahut, por është vërtetues i asaj (shpalljes) që ishte më parë, dhe sqarues e komentues i librit. Nuk ka farë dyshimi se është (i zbritur) nga Zoti i botëve. Përkundër kësaj, ata (idhujtarët) thonë se atë e trilloi ai (Muhamedi). Ti thuaj: “Silleni pra ju një kaptinë të ngjashme me këtë, madje thirrni kë të doni në ndihmë, pos Allahut, po qe se jeni të drejtë në atë që thoni.” (Junus, 37-38).

“Dhe ky është libër, dobiprurës, Ne e zbritëm, përmbajuni këtij, ruajuni ashtu që të mëshiroheni.” (El-En’am, 155).

THIRRJE ARSYES

Në Kuran Zoti na porositi që të mendojmë mbi shenjat që na çojnë drejt besimit. Për këtë arsye, të menduarit rreth këtyre shenjave që gjenden në univers është një rregull i vazhdueshëm fetar për besimtarët.

Falë këtyre shenjave që të çojnë drejt besimit, besimtarët mund t’i kuptojnë më mirë emrat e Zotit dhe natyrën superiore të tyre. Si pasojë e mendimit të tyre të thellë, ata shohin natyrën e pafundme të diturisë dhe fuqisë së Zotit dhe frika e tyre ndaj Zotit rritet akoma më shumë. Ata shpenzojnë çdo moment të tyre në këtë botë me dëshirën dhe mallin për të arritur pëlqimin, mëshirën dhe

parajsën e Zotit.

Lumturia e vërtetë dhe paqja mund të arrihen duke iu nënshtruar urdhrave të Krijuesit dhe Furnizuesit të kësaj bote. Zoti i madhërishtëm në Kuranin famëlartë thotë: “Nuk ka dyshim se në rikujtimin e Allahut vërtet zemrat gjejnë prehje.” (Rad, 28).

Ata që i frikësohen ferrit dhe shpresojnë parajsën duhet të punojnë për të fituar mëshirën, miqësinë dhe dashurinë e Zotit tonë, duke e njohur Atë më mirë. Për këtë qëllim, ata duhet të fitojnë njohuri më të mëdha, duke menduar thellë mbi shenjat që të çojnë drejt besimit. Përveç kësaj, ata duhet t’ua shpjegojnë këto shenja të tjerëve, në mënyrë që edhe ata ta rrisin besimin e tyre. Kjo përgjegjësi është detyrë e të gjithë besimtarëve.

LITERATURA

- Werner Keller, *The Bible as History*, Bantam, 1983.
- Thomas H. Maugh II, *Ubar, Fabled Lost City, Found by LA Teams*, The Los Angeles Times, 1992.
- George Ostrogorsky, *History of the Byzantine State*, Nju Bransvik: Rutgers University Press, 1969.
- Percy Sykes, *History of Persia*, London, Macmillan & Co Ltd, 1963.
- Nicholas Clapp, *The Road to Ubar: Finding the Atlantis of the Sands*, Mariner Books, 2021.
- Mustafa Mlivo, *Kurani përpara shkencës dhe civilizimit*, Dituria Islame, Prishtinë, 2008.

Mëkati, shkak i çdo problemi

Dr. Bali Sadiku

Muhamedi a.s., është fryma e vërtetë e Kuranit, në të cilën realizohen të gjitha kuptimet e mundshme kuranore dhe urtësia hyjnore.

Lumturia në këtë botë dhe në botën tjetër larrihet me praktikimin e fesë së Allahut, me nënshtrim të plotë ndaj Tij. Kush pason udhëzimin e Tij, nuk do të humb kurrë, kurse ai që ua kthen shpinën fjalëve të Allahut, vetëm se ka fituar hidhërimin e Tij.

Përse u nxorën Ademi dhe Havaja prej Xhenetit? Cila është ajo gjë për shkak të së cilës u përjashtua Iblisi prej rahmetit të Allahut? Përse u fundos Faraoni dhe ushtria e tij në det? Përse u shkatërrua Populli i Adit, Themudit e i Lutit? Çfarë e ka bërë ymetin e Muhamedit a.s. sot të nënçmuar? Përgjigjen e gjejmë në fjalët e Allahut të Lartësuar: “Kush i përmbahet udhëzimit Tim ai nuk ka për të humbur (në Dynja), e as nuk ka për të dështuar (në jetën tjetër), e kush ia kthen shpinën udhëzimit Tim, do të ketë jetë të vështirë dhe në Ditën e Kiametit do ta ringjallim të verbër. Ai (që nuk besoi) do të thotë: “Zoti im, përse më ngrite të verbër, kur unë isha me sy?!” Ai (Allahu) thotë: “Ashtu si i harrove ti argumentet Tona që t’i ofruam, ashtu je i harruar sot!” (Ta Ha, 123-126).

Kush e beson Kuranin dhe e praktikon atë, nuk do të humb në këtë dynja e as që ka për t’u hidhëruar në botën tjetër, por ai që ia kthen shpinën Kuranit, duke mos besuar në të dhe duke mos praktikuar urdhrat e tij, ai si dënim do të jetojë një jetë të vështirë. Kështu shpërblehet çdo person i cili i ka bërë mëkat Allahut.

Nga Ibën Umeri përcillet se Pejgamberi a.s., ka thënë: “O ju muhaxhirë! Pesë gjëra, nëse provoheni me to, e lus Allahun që mos t’i arrini. Nuk përhapet amoraliteti te një popull

ashtu që të shfaqen njerëzit me një vepër të tillë, vetëm se kanë për t’u përhapur me të kolera dhe sëmundje të ndryshme, të cilat nuk ishin të njohura te popujt e mëhershëm; nuk ndodh që njerëzit të peshojnë mangët në matje dhe peshore, vetëm se kanë për t’u goditur me thatësi, varfëri dhe pushtetarë mizorë; nuk ndodh që njerëzit të ndalojnë zekatin e pasurisë së tyre, vetëm se Allahu do t’i sprovtojë me pakësim të shiut prej qiellit, e sikur të mos ishin kafshët, nuk do të binte shi fare; nuk ndodh të kundërshtohet besa (feja) e Allahut dhe Pejgamberit, vetëm se Allahu do t’ua sjellë ndonjë armik nga të tjerët e t’ua marrë atë që ishte në duart e tyre. E, nëse prijësit e besimtarëve nuk gjykojnë me librin e Allahut dhe të jenë të kujdesshëm në të, vetëm se Allahu do t’i sprovtojë me përçarje mes tyre.”¹

Në këtë hadith, Pejgamberi a.s. po na paralajmëron për rrezikun që kanë mëkatet tek individit dhe shoqëria.

Sot gjejmë vështirësi në furnizim, ngushtim në gjokse, nuk jem të kënaqur me atë që kemi, nuk ngopemi me pak, nuk kem qetësi shpirtërore, nuk kem harmoni familjare, e gjithë kjo vjen si pasojë e mëkateve.

Ibën Kajjimi, Allahu e mëshiroftë, ka thënë: “Le të dihet se Allahu e ka krijuar çdo gjë në formë dhe përmbajtje të përkryer. Krijimi i Allahut nuk ka asnjë të metë dhe asnjë aspekt negativ, por është gjithmonë i dobishëm për njeriun, kurse sëmundjet e ndryshme janë shfaqur më vonë, pasi krijesat që bëri Allahu u ‘ndotën’ disi prej përzierjes ose përlyerjes me substanca e kështu me radhë. Nëse krijimi i Allahut e ka të paprekur gjendjen e tij cilësare,



atëherë ai nuk përmban asnjë të metë ose efekt negativ.”

Ata që kanë njohuri të thella mbi botën dhe krijimin, e dinë që çdo lloj e keqeje e rreziku që gjendet në ajër, tokë, bimësi dhe sende të tjera është shfaqur pasi ato janë krijuar. Në të njëjtën mënyrë, kur njerëzit filluan të mos u binden profetëve të tyre, u shfaqën e u përhapën të gjitha llojet e të këqijave, si në aspektin e përgjithshëm (shoqërorë), edhe në atë individual, të cilat u shkaktojnë atyre dhembje, vuajtje, sëmundje, murtaja, uri, humbje të bereqetit të tokës dhe të prodhimeve të saj. Dalëngadalë, frutat dhe pemët e humbën vlerën dhe cilësinë e tyre.

Nëse ka ndonjë që nuk i kupton këto fakte, le të mjaftohet me ajetin vijues, që të kuptojë: “Të këqijat në tokë dhe në det janë shfaqur si pasojë e asaj që ka bërë njeriu me duart e tij.” (Rum, 44). Shiko çfarë ndodh në këtë botë dhe çfarë thotë ky ajet, e pastaj bëj përqasjen!

Për më tej, të gjithë e vënë re se si sëmundje të ndryshme prekin bimët, kafshët dhe frutat. Këto sëmundje sjellin vetëm lloje të tjera sëmundjesh. Sa më shumë gjynahe e të këqija të bëjnë njerëzit, aq më tepër sëmundje u zbrit Allahi te ushqimet e tyre, te frutat, ajri, burimet ujore, në trup dhe në pamjen e jashtme. Madje, kur sjellja e njeriut vuan nga ndonjë lloj sëmundjeje ose përcudnimi, ajo është në përputhje me gjynahet e zullumet që ka bërë trupi i tij.²

Sulejmani a.s. kishte dalë një ditë me Beni Israilët për të falur namazin e shiut, por gjatë rrugës, Sulejmani, kaloi pranë një lugine, ku pa një milingonë e cila kishte ngritur këmbët e saj duke e lutur Allahun dhe thoshte: “O Zot, ne jemi krijesa

*Muhamedi
a.s., është
fryma e vërtetë
e Kuranit, në të
cilën
realizohen të
gjitha kuptimet
e mundshme
kuranore dhe
urtësia
hyjnore.*

prej krijesave Tua e mos na shkatërro për shkak të mëkateve të bijve të Ademit!”

Allahu iu përgjigj duase së milingonës dhe zbriti shiun. Atëherë Sulejmani iu drejtua Beni Israilëve duke u thënë: “O bijtë e Israilit, kthehuni tek Allahu të penduar dhe kërkoni falje prej Tij. Pasha Allahun, me të vërtetë Ai ju shpëtoi me përgjigjen e Tij ndaj lutjes së milingonës.”³

Sa e sa njerëz jetojnë me dhuntitë dhe të mirat e Allahut dhe prapë i bëjnë mëkat Atij? I dëgjon duke thënë: “Unë jam i ri, kur të plakem, do të pendohem dhe do të kthehem tek Allahu.” Por dije se vdekja nuk njeht plak apo të rinj, ajo vjen befas, nuk mund të sigurohet askush prej saj as deri nesër.

Ibën Omeri, Allahu qoftë i kënaqur me të, ka thënë: “Një ditë i Dërguari i Allahut ma vendoi dorën mbi supë dhe më tha: “Jeto në dynja si të ishe i huaj a kalimtar rrugë.” Ndërkaq, Ibën Omeri, Allahu qoftë i kënaqur me të, tha: “Kur të ngrysesh, mos e prit mëngjesin, dhe kur të gdihesh, mos e prit mbrëmjen. Shfrytëzoje shëndetin para se të sëmuresh dhe shfrytëzoje jetën para se të të vijë vdekja.”⁴

Dijeni se vdekja është e vërtetë, andaj kujtojeni veten shpesh me këtë realitet. Allahu thotë: “Agonia e vdekjes do të sjellë të vërtetën (e jetës tjetër): ja, kjo është ajo së cilës përpiqeshe t'i ikje.” (Kaf, 19).

Kjo është ajo së cilës përpiqeshe t'i ikje, nëse të kapte ndonjë sëmundje, shkoje te mjeku duke u frikësuar prej vdekjes. Po tani nga do t'ia mbathësh?!

O ti i ri! O ti i moshuar! O ti prijës! O ti i pasur! O ti i varfër! Nuk ke nga t'ia mbathësh! Edhe nëse të gjithë mjekët vijnë pranë teje dhe mundohen me mjekime e terapi të ndryshme



që të të shpëtojnë, nuk kanë mundësi, ngase ata dëshirojnë diçka, kurse meleku i vdekjes dëshiron diçka tjetër. “Kudo që të gjendeni, do t’ju arrijë vdekja, madje qofshi edhe në kështjellat më të forta!” (En Nisa, 78).

Kthehuni tek Allahu të penduar! E nëse dëshiron t’i bëni mëkat Atij, atëherë lexoni fjalët e Ibrahim ibën Ed’hemit, Allahu e mëshiroftë, me të cilat iu drejtua një mëkatari, i cili kishte ardhur te ky duke i thënë: “O Ebu Is’hak! E kam ngarkuar veten me shumë e shumë mëkate. Çfarë më këshillon të veproj, që ta shpëtoj zemrën time?” Ibrahim i tha: “Nëse i pranon pesë gjëra dhe u përmbahesh atyre, nuk do të të bëjë dëm asnjë mëkat dhe as nuk do t’i shkatërrojë kënaqësitë tua.” “M’i trego ato gjëra!” – i tha. Ibrahim ibën Ed’hemi i tha: “Nëse dëshiron t’i bësh mëkat Allahut, atëherë mos ha prej riskut të Tij!” I tha: “E prej nga të ha kur çdo gjë që është në tokë është prej Tij?” Ibrahim ia ktheu: “Vallë, si mund t’i bësh mëkat Allahut, përderisa furnizohesh prej riskut të Tij?” “Më trego të dytën!” Ibrahim i tha: “Nëse dëshiron t’i bësh mëkat Allahut, atëherë mos bano në tokën e Tij!” I tha: “Kjo është edhe më e rëndë se e para. O Ibrahim, nëse lindja dhe perëndimi dhe çfarë ka në mes tyre është e Tij, atëherë ku të banoj?” I tha: “O ti njeri, a bën që të hash prej riskut të Allahut, të banosh në tokën e Tij dhe prapë t’i bësh mëkat?” Tha: “Jo!”

“Më trego të tretën, Allahu të mëshiroftë!” Ibrahim i tha: “Nëse dëshiron t’i bësh mëkat Allahut, edhe pse furnizohesh prej Tij dhe banon në tokën e Tij, shiko një vend të sigurt, në të cilin Allahu nuk të sheh dhe bëj mëkat atje.” I tha: “Si është e mundur kjo, o Ibrahim, kur Ai i di të fshehtat?” I tha: “A bën që të hash prej riskut të Tij e të banosh në tokën e Tij si dhe t’i bësh mëkat edhe pse Ai të sheh ty dhe mëkatën që ti vepron?” Tha: “Jo!” “Më trego të katërtën!” Ibrahim i tha: “Nëse të vjen meleku i vdekjes, thuaji: Vonoje marrjen e shpirtit tim derisa të pendohem dhe të kthehem tek Allahu

me një pendim të singertë dhe të punoj punë të mira për Allahun!” I tha: “Kjo nuk më pranohet!” Atëherë Ibrahim ia ktheu: “O ti njeri! Nëse nuk ke mundësi të largosh vdekjen prej vetvetes e të pendohesh dhe e di se nëse të vjen, nuk ka kush që e vonon, atëherë si kërkon shpëtim?” I tha: “Më trego të pestën!” I tha: “Nëse të vijnë engjëjt e zjarrit Ditën e Kiametit, që të të marrin ty për në zjarr, mos shko me ta!” I tha: “Nuk më lënë e nuk pranojnë nga unë asnjë arsye!” Ibrahim i tha: “Atëherë si kërkon shpëtim...?” I tha: “Mjaft, mjaft o Ibrahim! Kërkoj falje prej Allahut dhe kthehem tek Ai i penduar. Dhe vazhdoi me ibadete derisa vdekja i ndau.”⁵

Pendohuni ngase Allahu gëzohet për pendimin tuaj, gëzohet me kthimin tuaj tek Ai. Lexoni fjalët e Allahut kur thotë: “Thuaj: “O robërit e Mi, që i keni bërë keq vetes me gjynahe, mos e humbni shpresën në mëshirën e Allahut! Allahu, me siguri, i fal të gjitha gjynahet. Vërtet, Ai është Falësi i madh dhe Mëshirëplotë.” (Zumer, 53).

Literatura e konsultuar:

- *Kurani fisnik*- Përkthim i kuptimeve të tij me komentim në gjuhën shqipe, H. Sherif Ahmeti.
- *Sunen ibën Maxheh*; Muhamed ibën Jezid el Kazvinij, recensim: Muhamed Fuad Abdul Bakij, bot: Dar Ihja el Kutub el Arabijeh, Kajro, Egjipt, pa vit botimi.
- *El Muštedrek ala es Sahihajn*, bu Abdullah el Hakim, Muhamed ibën Abdullah en Nejsaburij, recensim: Komisioni për Hulumtime dhe Studime pranë shtëpisë botuese “Dar et Te’ Sil”, bot: Dar et Te’sil, Kajro, Egjipt, viti i botimit 2014.
- *Sunen ed Darkutnij*, Alij ibën Umer ed Darekutnij, recensim: Shuajb Arnauti me bashkëpunëtorë, bot: Muesesetu er Risaleh, Bjerut Liban, viti i botimit 2004.
- *El Bedr el Munir fi Tahririh el Ahadithi vel Athari el Vakiatu fi esh Sherh el Kebir*, Ibën el Mulekkin, Ebu Hafs, Umer ibën Alij ibën Ahmed esh Shafij el Misrij, recensim: Muštafa ebu el Gajt, Abdullah ibën Sulejman, dhe Jasir ibën Kemal, bot: Dar el Hixhrah, Rijad- Arabi Saudite, viti i botimit 2004.
- *El Xhami ’e el Musned es Sahih...*, Ebu Abdullah, Muhamed ibën Ismail el Buharij, recensim: Muhamed Zuhejr ibën Nasir en Nasir, bot: Dar Tauk en Nexhah, viti i botimit 1422 h.
- *Kitabu et Tev-vabin*, Ibën Kudameh el Makdesij, Ebu Muhamed, Abdullah ibën Ahmed ibën Muhamed, recensim: Halid Abdul-latif, bot: Dar el Kitab el Arabij, Bejrut-Liban, viti i botimit 2001.
- *Zadu el Mead fi Hejdi Hajri el Ibad*, Ibën Kajjim el Xhevziqeh, recensim: Shuajb dhe Abdul Kadir Arnauti, bot: Muesesetu er Risaleh, Bejrut-Liban, viti i botimit 2002.

1 Ibën Maxheh në *Es Sunen* (2/1332, nr: 4019), Hakimi në *El Muštedrek* (8/344, nr 8848) dhe thotë: Zinxhiri i hadithit është i saktë edhe pse Buhariu dhe Muslimin nuk e kanë shënuar në dy koleksionet e tyre.

2 „Zadu el Mead“ (4/332-333).

3 Transmeton Darekutniu në *Es Sunen* (2/421, nr: 1797), dhe Hakimi në *El Muštedrek* (2/273, nr: 1232) nga Ebu Hurejreh r.a., i cili thotë: E kam dëgjuar Pejgamberin a.s. duke thënë: “Një pejgamber prej pejgamberëve të Allahut kishte dalë bashkë me popullin e tij për t’u lutur që Allahu t’u lëshonte shi, papritmas panë një milingonë të shtrirë, këmbët i kishte kthyer kah qielli. Atëherë pejgamberi i tha popullit të vet: “Kthehuni, Allahu ua plotësoi kërkesën tuaj për shkak kësaj milingone.” Hakimi thotë: “Zinxhiri i hadithit është i saktë edhe pse Buhariu dhe Muslimin nuk e kanë shënuar në dy koleksionet e tyre.” Ndërsa tekstin e shënuar lart e ka përmendur Ibën el Mulekkin në *El Bedr el Munir* (5/157).

4 Transmeton Buhariu në *Sahihun* e tij (8/89, nr: 6416).

5 *Kitab et Tev-vabin* të Ibën Kudames (fq: 287-288).

Agnosticizmi, qasje mohuese apo injoruese?

Mr. Adnan Shala

Fjala agnosticizëm vjen nga fjala greke agnostos, që do të thotë “e panjohur” apo e kundërta e fjalës “gnosis”. Megjithatë, nuk është aq e lehtë të përkufizohet kjo fjalë si një term i filozofisë apo fesë, sepse kuptimi që i atribuohet agnosticizmit ndryshon nga filozofi në filozof dhe madje nga teologu në teolog. Sidomos përballë pyetjeve nëse agnostikët besojnë në Zot dhe cili është ndryshimi midis një agnostiku dhe një ateisti, shohim se termi agnosticizëm ka të paktën dy përdorime-kuptime.

Në popull njihet se agnostik është ai që nuk ka besim apo mosbesim në Zot. Megjithatë, në kuptimin e ngushtë, agnosticizmi është pikëpamja se arsyeja njerëzore është e paaftë të sigurojë baza të mjaftueshme racionale për

të justifikuar ose besimin se Zoti ekziston ose besimin se Zoti nuk ekziston.¹

Megjithëse Thomas Henry Huxley ishte i pari i cili e përdori agnosticizmin si term, mendimtarët agnostikë sigurisht që ekzistonin edhe para tij. Nëse e konsiderojmë agnosticizmin si skepticizëm ndaj besimeve fetare, atëherë atë mund ta hasim edhe në kohët e lashta. Në historinë e mendimit, qasjet agnostike i hasim te sofistët, të cilët e pranuan retorikën si artin e bindjes së adresuesit si bazë të edukimit filozofik, në vend që të arrinin njohuritë e provuara.

Protagora është një filozof që shpalos qartë qasjen bazë të agnosticizmit. Protagora argumentoi se njeriu është kriteri i gjithçkaje,

Në popull njihet se agnostik është ai që nuk ka besim apo mosbesim në Zot. Megjithatë, në kuptimin e ngushtë, agnosticizmi është pikëpamja se arsyeja njerëzore është e paaftë të sigurojë baza të mjaftueshme racionale për të justifikuar ose besimin se Zoti ekziston ose besimin se Zoti nuk ekziston.





dhe duke qenë se kjo pikëpamje bazohet në idenë kryesore se nuk ka realitet fiks të pavarur nga perceptimet apo besimet, ajo dërgon në përfundimin se nuk është e mundur të dihet e vërteta. Sipas Protagoras, kur kriter është subjekti, nuk ekziston një parim i realitetit fiks që përcakton njohuritë dhe besimet e njeriut, përkundrazi, perceptimi, ndjenjat dhe supozimet e njeriut përcaktojnë realitetin e botës së jashtme. Prandaj, e vërteta është e ndryshme për të gjithë dhe secila pikëpamje nuk është më e drejtë apo më e gabuar se tjetra.² Sipas sofistëve, e vërteta (me të edhe e vërteta absolute apo Zoti) si realitet i jashtëm nuk ekziston edhe nëse ekziston nuk mund të njihet. Nëse dikush arrin ta njoh atë të vërtetë apo realitet nuk mund të tregohet apo transmetohet. Kështu që nuk meriton të besohet apo mohohet diçka që realisht nuk mund të dihet. Ai tha për ekzistencën e Zotit: “Sa për perënditë, nuk gjeta asnjë mënyrë për të ditur nëse ekzistojnë apo jo. Si misteri i problemit, ashtu edhe shkurtësia e jetës njerëzore mund të numërohen ndër shumë gjëra që pengojnë marrjen e informacionit për këtë temë.”³

Mendimet agnostike nuk i hasim vetëm te mendimtarët antikë, mirëpo i hasim edhe më vonë si në mendimin islam po ashtu edhe në mendimin perëndimor. Është praktikë e mendimtarëve islam që të klasifikojnë sofistët në grupe dhe të përmendin tendencat agnostike të tyre. Dihet se Ibën Hazmi bëri një klasifikim të trefishtë pa i emërtuar ata, kurse Nasiruddin Tusi thotë se ai i ndan sofistët, të cilët i konsideron si shkollë filozofike, në tre grupe si laedrijje (agnostikë), inâdijje (septikë) dhe indijje (subjektivistë). Ndërsa i prezanton laedrijen si “ata që

dyshojnë dhe dyshojnë nëse dyshimin e tyre.” Dyshimi këtu shpreh një qëndrim agnostik dhe jo një skepticizëm të rreptë për pamundësinë e dijes.

Nëse kalojmë nga dimension i historik i agnosticizmit dhe e diskutojmë atë si një term, atëherë vërejmë dy forma të agnosticizmit: i dobët dhe i fortë. Forma e parë e agnosticizmit as nuk e pohon e as nuk e mohon ekzistimin e Zotit, pra sipas tyre është e panjohur për ta. Forma e dytë shton se nuk është e mundur të dihet, për këtë arsye askush nuk mund të pretendojë ekzistimin apo mos ekzistimin. Sipas grupit të dytë, teistët edhe ateistët realisht bëjnë pretendime irracionale.

Përveç kësaj, ka edhe nga ata që termin agnosticizëm e përdorin në një shtrirje më të gjerë dhe e ndajnë atë në lloje si teizmi agnostik, ateizmi agnostik, agnosticizmi indiferent, agnosticizmi pragmatik. Teizmi agnostik në këto klasifikime të fundit përdoret për njerëzit që besojnë në ekzistencën e Zotit, si Kierkegardi dhe Kanti, edhe pse ata pranojnë se ekzistenca e Zotit nuk mund të njihet dhe se njohuritë mbi këtë temë tejkalojnë aftësinë tonë për të ditur. Ka edhe nga ata që teizmin agnostik e quajnë agnosticizëm fetar.⁴

Ateizmi agnostik, nga ana tjetër, është qëndrimi i mendimtarëve, si Bertrand Russell, të cilët nuk e shohin të arsyeshme të besojnë në ekzistencën e Zotit, bazuar në parimin agnostik, i cili argumenton se nuk është racionale të besosh në ndonjë besim pa prova të mjaftueshme.⁵ Russell thotë se si filozof, duhet të them se nëse i drejtohem një audience të pastër filozofësh, e përshkruaj veten si agnostik, sepse nuk mendoj se ka argument të fortë për të vërtetuar se Zoti nuk ekziston.

Agnostikët vënë theksin te fakti që mendja dhe perceptimi njerëzor janë të kufizuara. Ata argumentojnë se për shkak të kufizimeve intelektuale, njerëzit nuk kanë mjetet e mjaftueshme për të arritur njohjen absolute të dijes.

Nga ana tjetër, nëse do të bëj përpjekje që njeriu në rrugë të ketë përshtypjen e duhur për mua, mendoj se duhet të them se jam ateist, sepse kur them se nuk mund të vërtetoj se Zoti nuk ekziston, po ashtu nuk mund të vërtetoj se perënditë e mitologjisë greke nuk ekzistojnë.⁶

Agnosticismi indiferent dhe agnosticizmi pragmatik në përgjithësi kuptohen si agnosticizëm i dobët. Në këto lloje të agnosticizmit, ekziston një gjendje e indiferencës së plotë ndaj besimit në Zot dhe në fe. Ky qëndrim quhet edhe “apatizëm” (indiferencë).

Sipas agnostikëve, teisti edhe ateisti nuk janë mjaftueshëm skeptikë. Sipas tyre i vetmi qëndrim racional mbi ekzistencën e Zotit është qëndrimi agnostik, i cili shmang gjykimin përfundimtar për këtë çështje.

Agnostikët vënë theksin te fakti që mendja dhe perceptimi njerëzor janë të kufizuara. Ata argumentojnë se për shkak të kufizimeve intelektuale, njerëzit nuk kanë mjetet e mjaftueshme për të arritur njohjen absolute të dijes. Kjo tërheq vëmendjen te nevoja për një dozë modestie ndaj pretendimeve të vërtetësisë absolute. Agnostikët thonë se provat metafizike dhe teologjike për ekzistencën e Zotit janë të vështira për t'u përcaktuar dhe vlerësuar në mënyrë të qartë dhe objektive. Sipas tyre duhet pasur një qasje kritike ndaj këtyre argumenteve, duke shprehur skepticizmin ndaj tyre dhe mungesën e provave konkrete dhe bindëse. Agnostikët theksojnë se shumë prej bindjeve të njerëzve lidhen ngushtë me kontekstin kulturor dhe shoqëror në të cilin ata jetojnë, ku faktorët kulturorë dhe edukimi ndikojnë në mënyrë të mëdha në mënyrën se si njerëzit i perceptojnë pyetjet metafizike dhe fetare. Thënë më ndryshe, argumentet pro teizmit apo kundër, janë argumente të cilat determinohen nga konteksti mbi të cilën ndërtohen. Ato mund të favorizohen nga botëkuptimet njerëzore dhe nuk janë universale.

Sipas agnostikëve, nuk ka dallim ndërmjet ateistit dhe teistit, për këtë arsye e vetmja rrugë racional për përgjigje ndaj dilemave metafizike është agnosticizmi dhe bëjnë një gjykim interesant ku sipas tyre:

1. Nuk ka asnjë bazë të fortë mbi të cilën të gjykohej se teizmi ose ateizmi është në thelb më i mundshëm se tjetri.

2. Nuk ka asnjë bazë të fortë mbi të cilën të gjykohej se provat e përgjithshme favorizojnë teizmin ose ateizmin mbi njëri-tjetrin.

Nga 1 dhe 2 rezultojnë se

3. Nuk ka asnjë bazë të qëndrueshme për të gjykuar se teizmi ose ateizmi është më i mundshëm se tjetri.

4. Nga ky rezultat se agnosticizmi është i vërtetë: as teizmi dhe as ateizmi nuk dihet se janë të vërtetë.

Nëse duhet ta ripotencojmë, atëherë agnosticizmi është pikëpamja se dija nëse ekziston apo jo Zoti është e

paarritshme, se ne nuk mund të justifikohemi që të besojmë se Zoti ekziston ose nuk ekziston. Sipas tyre ka dy qasje për të argumentuar këtë pikëpamje: së pari, mund të argumentohet se njohja e ekzistencës së Zotit është e paarritshme, sepse asnjëherë nuk jemi të sigurt për vërtetësinë e ndonjë argumenti i cili paraqitet për argumentimin se Zoti ekziston apo nuk ekziston. Së dyti, sipas agnostikëve, teistët shpesh janë kënaqur duke thënë se ne nuk jemi në gjendje ta kuptojmë Zotin, se qenia e tij i kapërcen përvojat tona të zakonshme dhe se konceptet tona të cilat rrjedhin nga përvoja të tilla, nuk mund të përdoren për ta përshkruar atë. Sipas tyre nëse është e vërtetë, atëherë kjo mund të mendohet se llogaritet në favor të agnosticizmit; nëse nuk mund ta kuptojmë Perëndinë, atëherë si mund të arsyetojmë sigurinë në lidhje me ekzistencën e tij?

Ndryshe nga ateizmi, agnosticizmi e lë derën hapur për lutje dhe veprime në dukje fetare. Sipas tyre, të jesh agnostik nuk do të thotë të mos jesh në gjendje të lutesh.⁷ Në thelb, thirrja e një Zotit të dyshimtë nuk është më e paarsyeshme sesa të kërkesësh ndihmë në rast urgjence pa e ditur nëse dikush është brenda zonës së dëgjimit.

Për fund, mund të thuhet se agnostikët nuk kanë ndonjë argument bindës për të vërtetuar bindjet e tyre, ata barrën e sjelljes se argumentit ua lënë palës tjetër debutuese dhe e pozicionojnë veten prapa mendimeve se çdo gjë që nuk mund të vërtetohet edhe pse ka të bëjë me çështje epistemologjike nuk është e nevojshme të besohet edhe në rrafshin ontologjik. Edhe pse për shumë kë kjo qasje është gabim kategorik. Këtu qëllimi kryesor është që nëpërmjet mënjanimit të mundësisë së njohjes së Zotit dhe qenieve të tjera metafizike, të iracionalizohet manifestimi i besimit. Më një fjalë, për agnostikët nuk është edhe ndonjë problem nëse njeriu beson apo jo, për ta problem është manifestimi në jetë i atij besimi. Sipas tyre njeriu edhe mund të përjetojë ndonjë gjendje jo normale dhe jo racionale, por të jetosh jetën dhe t'i detyrosh të tjerët të jetojnë sipas rregullave dhe parimeve që dalin nga ajo përvojë është edhe jo e logjikshme. Pra në thelb agnostikët e kanë problem fenë dhe jo besimin.

1 William L. Rowe, “Agnosticism” Routledge Encyclopedia of Philosophy, ed. by E. Craig, London, fq. 10

2 İLHAN KUTLUER, “LÂEDRİYYE”, TDV İslâm Ansiklopedisi, <https://islamansiklopedisi.org.tr/laedriyye> (14.08.2023).

3 Diogenes Laertius, *Lives of Eminent Philosophers*, English Translation and ed. by R. D. Hicks, London: W. Heinemann - New York: G. P. Putnam's Sons, 1925, vol. II, Book IX, fq. 465

4 Ferit Uslu, “Agnostisizm”, *Hitit Üniversitesi İlahiyat Fakültesi Dergisi*, 2012, fq. 11

5 Ferit Uslu, “Agnostisizm”, *Hitit Üniversitesi İlahiyat Fakültesi Dergisi*, 2012, fq. 12

6 Ferit Uslu, “Agnostisizm”, *Hitit Üniversitesi İlahiyat Fakültesi Dergisi*, 2012, fq. 12

7 İLHAN KUTLUER, “LÂEDRİYYE”, TDV İslâm Ansiklopedisi, <https://islamansiklopedisi.org.tr/laedriyye> (14.08.2023).

Doracakët më të njohur të fikhut hanefi

Hazir D. Selmani


Një gjë është e sigurt, sot veprimtaria autoriale shkencore islame në gjuhën arabe në krahasim me të kaluarën edhe për sasi edhe për cilësi duket në një gjendje të përgjumur.

HYRJE

Trashëgimia e letërsisë shkencore islame në gjuhën arabe është njëra ndër më të pasurat në botë. Me fjalën letërsi këtu nuk synohet proza e drama, por tërësia e veprave shkencore islame, që janë shkruar në gjuhën arabe deri më sot. Ajo zë fill që në shekullin e parë hixhri, prej ku për disa shekuj me radhë pati një përparim të dukshëm. Momenti kur ajo arriti pikën kulmore dhe filloi e mori tatëpjetën nuk është shumë i qartë. Rënia e Bagdadit në vitin 656 hixhri (1258 gregorian) nën kthetrat mongole ndoshta mund të merret si njëra prej këtyre pikave më të mundshme edhe pse pastaj veprimtaria shkencor islame në gjuhën arabe përsëri deri diku e mori veten në periudhën e memlukëve dhe pastaj atë të osmanëve. Mirëpo një gjë është e sigurt, sot veprimtaria autoriale shkencore islame në gjuhën arabe në krahasim me të kaluarën edhe për sasi edhe për cilësi duket në një gjendje të përgjumur.

Gjatë tërë kësaj periudhe 14 shekujsh, nga duart e dijetarëve islam lindën dhe u zhvilluan shkenca të mëdha, kryesisht islame si: gjuha arabe, tefsiri, hadithi, kelami, fikhu dhe tesavufi. Këto shkenca pastaj u degëzuan në degë të mëdha shkencore dhe për secilën prej tyre u shkruan vepra të ndryshme. Një numër i madh i këtyre veprave janë dorëshkrime që ruhen nëpër biblioteka dhe që akoma se kanë parë dritën e botimit modern. Për ta vërtetuar këtë mjafton t'u hidhet një shikim indekseve të dorëshkrimeve arabe nëpër biblioteka, qofshin ato në trojet tona ose evropiane. E çka të themi për fondin e këtyre dorëshkrimeve që ndodhen në Turqi, Lindje të Mesme, Lindje të

Largët e Indi. Sa për shembull vlen të theksohet se Fondacioni për Trashëgimi Islamike "El-Furkan" në Londër në botimin e tyre të veprës bibliografike "Keshfu'dh-Dhunun" të Katip Çelebiut (Haxhi Halifesë) kanë bërë edhe numërimin e librave të regjistruara nga Çelebiu në këtë enciklopedi. Libri i fundit që është regjistruar mban numrin 20696.¹ Në disa burime të tjera theksohet se Katip Çelebiu (Haxhi Halifeja) në "Keshfu'dh-Dhunun" ka regjistruar të dhëna bibliografike për librat e rreth 10 mijë autorëve myslimanë, që kanë shkruar në më shumë se 300 degë të shkencës.² Nga ana tjetër, bibliografi tjetër i madh Ismail pashë Bagdadi, në librin e tij bibliografik "Hedijetu'l-arifin" ka regjistruar të dhëna



bibliografike për rreth 50 mijë vepra.³ Shumica absolute e këtyre veprave janë në arabisht, aty-këtu ka edhe persisht dhe turqisht (osmanisht), mirëpo mjerisht shumë prej këtyre llogariten të humbura. Ky numër i madh veprash shkencore islame është marramendës edhe pse nuk është gjithëpërfshirës. Ai bëhet akoma më marramendës, atëherë kur kihet parasysh se prej tyre ka tituj që janë shumëvëllimësh. Për shembull, kryevepra e hanefive të vonshëm me titull “Raddu’l-Muhtar alé’l-Durri’l-Muhtar” e njohur më shumë si Hashija e Ibën Abidinit, në botimin e fundit të daru’s-selamit ka 24 vëllime. Shembull tjetër, Tarihu Dimeshk në botim ka 74 vëllime, etj.. Si këta shembuj ka me mijëra e mijëra tituj të veprave voluminoze të shkencave islame.

DEFINIMI DHE PËRKUFIZIMI I TERMEVE TË NEVOJSHËM

Numri i literaturës së dijetarëve hanefi është shumë i madh. Studiuesi prof. dr. Jusuf Mer’ashliu, në punimin e tij 4 vëllimesh mbi literaturën hanefite (fikh, usul, akide, histori, hadith, tefsir, etj.) ka regjistruar rreth 6225 tituj të veprash të rreth 1788 dijetarëve hanefi.⁴ Kuptohet edhe ky numërim nuk është gjithëpërfshirës.

Kush lexon a hulumton disa faqe për një mesele të vetme fikhore në një libër të zgjeruar të fikhut hanefi, ai vë re një shumëllojshmëri zhanresh të veprave fikhore të hanefive si p.sh. dhahiru’r-rivajeh, el-nevadîr, el-mutun (el-muhtesarat), el-shuruh, el-havashi, el-fetava, etj.. Secili lloj i këtyre veprave ka stil dhe metodologji të veçantë. Në këtë hulumtim krejtësisht do të flitet për një numër të caktuar të veprave të llojit el-mutun të fikhut të medhhebit hanefi, të cilin lloj veprash në shqip e kemi përkthyer si doracakë. Ndërsa, kalimthi me automatizëm do të theksohen edhe ca libra të llojit el-shuruh, e që janë komente dhe analiza shkencore të doracakëve në fjalë.

Termi “el-mutun” është fjalë arabe në trajtën e shumësit, njëjësi i së cilës është “el-metën”. Në original fjala metën në arabisht ka kuptimet: shpinë e fortë, kurriz, pjesa kryesore, pjesa e ngritur dhe e fortë e tokës, etj..⁵ Në shqip, leksikografët i japin këta kuptime: i fortë, i durueshëm, solid, ndërtoi mirë, ngriti mirë tendën, përforcoi, shpinë, tekst, shtrat, vijë, bord, sipërfaqe e tokës, etj..⁶ Këtu nuk flitet për termin el-metn të shkencës së hadithit, por për atë që më vonë do të njihet si lloj librash shkencor. Gjuhëtari i famshëm, El-Muhibij, për llojin e librave el-metn thotë: “El-Metën është libri bazë në të cilin shkruhen çështjet thelbësore. Karshi tij qëndron libri El-Sherh. Si term është fjalë e porsaformuar që nuk është

Numri i veprave të komentuara (el-mutun) të fikhut hanefi del është shumë i madh dhe është gati se e pamundur të përfshihen nga një përpjekje individuale.

transmetuar nga arabët, por është fjalë që ka ardhur nga tradita si përngjasim me anën e sipërme të shpinës...”⁷ Pra, pak më vonë fjala el-metën filloi të përdoret edhe për librat që ishin tekst bazë mbi të cilët shkruheshin komente dhe shpjegime. Me fjalë të tjera, libri që komentohet i ngjanë diçkasë së fortë e të ngritur mirë me përforcime, ose asaj shpinës së fuqishme ku komentuesi gjen mbështetjen e tij për të bërë komente. Sinonimet e tjera të këtij lloji librash janë: “el-Muhtesar” (shqip: konspekt, përmbledhje, vepër e shkurtër, etj.), “el-Muuxhiz” (shqip: konspekt, i shkurtër, i përmbledhur, i shprehur shkurtimisht, etj.), “el-mukaddimeh” (shqip: parathënie, fillim, libërth i vogël), etj..⁸ Gjersa jemi këtu vlen të theksohet edhe një detaj. Në arabisht libri i llojit el-metën jo çdo herë është edhe el-muhtesar (vepër e shkurtër), ngase çdo libër i komentuar llogaritet metën, madje edhe kur libri i komentuar është i madh. Prandaj themi se Sahihu i Buhariut është metën (edhe pse si libër është shumë i madh) dhe Fet’hu’l-Barij është sherh. Madje, nganjëherë metni në realitet është sherh i një metni më të hershëm.⁹ P.sh. vepra El-Hidajeh e Merginanit është metën kur shikohen komentet që janë shkruar për të, ndërsa libri si libër në realitet është sherh i një metni tjetër të po vetë Merginanit me titull El-Bidajeh.

MANUAL APO DORACAK?

Në qarqet shkencore islame të trojeve tona dhe atyre evropiane, këtij lloji të librave më shumë u thuhet si manuale. Në shqip, fjala manual definohet kështu: “Libër doracak që përmban në mënyrë të përmbledhur njohuritë themelore të një fushe të caktuar të shkencës, të teknikës ose të artit; tekst mësimor. Manual mësimor (shkencor, teknik). Manuali i filozofisë (i fizikës, i kimisë, i mjekësisë, i vizatimit).”¹⁰ Termi manual është fjalë e huaj, ndërsa në shqip si fjalë më e përafërt me termet e librave el-metn dhe el-muhtesar është fjala doracak. Termi doracak definohet kështu: “Tekst shkollor ose libër tjetër që përdoret gjerësisht si udhëzues mësimor e praktik.”¹¹

ÇKA SYNOHET ME DORACAKËT MË TË NJOHUR TË FIKHUT HANEFI?

Në bazë të definimeve dhe nga të dhënat e mësipërme, numri i veprave të komentuara (el-mutun) të fikhut hanefi del është shumë i madh dhe është gati se e pamundur të përfshihen nga një përpjekje individuale. Për këtë shkak, është e domosdoshme vënia e ca kritereve reduktuese, falë të cilëve kritere numri i librave zvogëlohet skajshëm dhe kështu arrihet qëllimi maksimal i titullit të hulumtimit. Kriteret në fjalë janë:

1. Doracaku të jetë fikh hanefi në gjuhën arabe,

2. Doracaku të jetë i shkruar pas periudhës së nxënësve të Ebu Hanifes. Ky kriter është vënë me qëllim që të mos përfshihen librat e dijetarëve të parë të medhhebit, pra ata të nxënësve të Ebu Hanifes dhe ata të brezit që njihen si nxënës të Ebu Hanifes. Kjo, ngase veprat e tyre kanë tjetër klasifikim dhe pozitë, e ndërsa hulumtimi ynë nuk synon këtë, porse mutunët dhe muhtesaratët që u shkruan prej pas Tahaviut e deri më sot.

3. Doracaku të jetë i njohur në mesin e studiuesve të fikhut hanefi, madje qoftë edhe fare pak.

4. Doracaku të paktën të jetë komentuar qoftë edhe vetëm një herë nga një dijetar i fikhut hanefi. Në dy kriteret e fundit ka ca përjashtime shumë të vogla, por shumë të nevojshme për 2-3 libra.

NDARJA E DORACAKËVE MË TË NJOHUR TË FIKHUT HANEFI

Doracakët më të njohur të fikhut hanefi fillimisht mund të ndahen në dy grupe kryesore, kjo shikuar nga aspekti i gjithëpërfshirshmërisë:

a) Doracakë të plotë. Fjala është për ata doracakë që ngërthejnë shumicën absolute të kapitujve të fikhut hanefi. Në këtë grup bëjnë pjesë doracakët si: *Muhtesari* i Tahaviut, *Muhtesari* i Kerhit, *Muhtesari* i Kuduriut, *El-Vafi* i Nesefiut, *Multeka'l-Ebhuri* i Halebiut, *Tenviru'l-Ebsari* i Tumurtashit, etj.

b). Doracakë të pjesshëm. Fjala është për ata doracakë që u shkruan për disa tema të caktuara të përditshmërisë së myslimanëve praktikantë. Këta doracakë ndryshe njihen edhe si *El-Mukadimeh*, ndërsa në trojet tona si *Ilmihal*. Në këtë grup bëjnë pjesë doracakët si: *Mukadimeja* e Ebu Lejthit, *Mukadimeja* e Gazneviut, *Mukadimeja* e Fenarit (Kejdanit), *Mukadimeja* e Mulla Husejnit, *Muaddilu's-Salati* i Birgiviut, *Munjetu'l-Musali* e Kashgariut, *Nuru'l-Idah*, etj.

Shikuar nga aspekti se sa të komentuar janë këta doracakë, ata mund t'i ndajmë në:

a). Doracakë të komentuar shumë, si p.sh. *Muhtesari* i Kuduriut, *Kenzu'd-Dekaik* i Nesefiut, *El-Hidaja* e Merginanit, *Durru'l-Muhtari* i Haskefiut, *Multeka'l-Ebhuri* i Halebiut, etj.

b). Doracakë të komentuar mesatarisht, si p.sh. *Muhtesari* i Kerhit, *Munjetu'l-Musali*, *Nuru'l-Idah*, etj.

c). Doracakë të komentuar rrallë herë, si p.sh. *El-Vafi* i Nesefiut, *Tuhfetu'l-Fukaha* e Semerkandit, etj.

Shikuar nga aspekti i burimit të materialit të doracakut mund të ndahen në:

a). Doracakë të bazuar kryesisht në një libër paraprak, si p.sh. vepra *El-Nukajeh* është version i shkurtuar i veprës *El-Vikajeh*.

b). Doracakë të bazuar në disa vepra paraprake, si p.sh. *Multeka'l-Ebhuri* bazohet në 6 vepra paraprake.

DORACAKËT E FIKHUT HANEFI NË GJUHËN SHQIPE

Tani për tani, në gjuhën shqipe nuk ka të përkthyer në mënyrë të plotë thuajse asnjë doracak të njohur të fikhut hanefi. Edhe pse një numër bukur i madh i këtyre doracakëve ishin libra më se të njohur në mesin e hoxhallarëve të vjetër shqiptarë dhe këtë e dëshmojnë kopjet dorëshkrimore të këtyre doracakëve që ndodhen nëpër bibliotekat e tyre private si dhe dorëshkrimet e ndodhura në Fakultetin e Studimeve Islame në Prishtinë dhe atë në Shkup.

Doracakët el-mutun (el-muhtesarët) realisht në të shumtën e rasteve janë libra të vegjël për nga vëllimi dhe shumë të ngjeshur për nga domethëniet si dhe parimisht u shkruan për njerëzit e fushës së fikhut si një lloj lehtësimi edhe nga aspekti material por edhe nga aspekti shkencor. Prandaj studimi i tyre për fëtvadhënie dhe vendime fetare detyrimisht duhet bërë në mënyrën klasike para fukahave kompetent me ixhazetname të mirëfilltë për fikh hanefi dhe për këtë nuk mjaftojnë leximet e tjera, qofshin ato lexime universitare e më lartë.

Për fund, një gjë duhet pasur parasysh se, doracakët që do të përfshihen në këtë hulumtim, e që parashihen rreth 30, nuk janë që gjithë të një kategorie për sa i përket fuqisë së asaj që ofrojnë si dhe përparësisë së tyre. Disa janë të kategorisë më të lartë dhe të tjerët jo. Qëllimi i hulumtimit aspak nuk është shkallëzimi i tyre sipas vlerës ose sipas rëndësisë, por është një njoftim i thjeshtë me këta doracakë që janë ndër më të njohurit e fikhut hanefi, pastaj njoftimi me autorët e tyre si dhe punimet dhe veprat që janë shkruar rreth tyre. Ndërsa, vlerësimi i tekstit të këtyre doracakëve është e drejtë ekskluzive e ekspertëve më të mëdhenj të fikhut hanefi, siç ka bërë Ibën Abidini në Hashijen e tij dhe shumë të tjerë para tij. -vijon-

1 Katip Çelebi, *Keshfu'dh-Dhunun an esamij el-kutubi ve'l-funun*. (Londër: Al-Furqan Foundation, 2021), vol. 6, fq. 654.

2 *TDV Islam Ansiklopedisi*, (Stamboll: Türkiye Diyanet Vakfı, 2022), vol. 25, fq. 322.

3 *TDV Islam Ansiklopedisi*, (Stamboll: Türkiye Diyanet Vakfı, 1994), vol. 4, fq. 448.

4 Jusuf Abdurrahman el-Mer'ashli, *Mesadiru'd-Dirasati'l-islamijeh el-fikhu'l-hanefiju furuan ve usulen*. (Bejrut: DKL, 2020), vol. 3, fq. 261.

5 Muhamed Ibën Mendhur, *Lisanu'l-Arab*. (Bejrut: Daru's-Sadir, 1993, botimi i tretë), vol. 13, fq. 398;

6 Sulejman Tomçini, *Fjalor arabisht-shqip*. (Tiranë: AIITC, 2009), fq. 891.

7 Muhamed el-Emin el-Muhibij, Kasdu's-Sebil fi ma fi'l-lugati'l-arabijeti mine'd-dehil. (Rijad: Mektebetu't-Teubeh, 1994), vol. 2, fq. 442.

8 Përkthimet janë marrë shkurtimisht nga fjalët përkatëse nga fjalori online i dr. Isa Memishit (<https://arabisht-shqip.com>), parë për herë të fundit më: 01/09/2023. Ndërsa sinonimet nga: Abdullah Shemrani, *el-Med'hal ila diraseti'l-muhtesarat*. (Rijad: Daru't-Tajbeh, 2008), fq. 25.

9 Po aty, fq. 35.

10 Grup autorësh, *Fjalor i gjuhës së sotme shqipe*. (Tiranë: Akademia e Shkencave e RPS, 1980), fq. 1057.

11 Po aty, fq. 358.

Përballja e ideologjive të reja me Islamin

Imer Topanica

Tingëllon qesharake përpjeka e disa besimtarëve myslimanë për t'u identifikuar me feminizmin. Në një anë, askush nuk mund ta mohojë faktin se kjo ideologji relativisht e re në vetvete, manifestoi mangësitë e sistemit të vlerave perëndimore, në momentin kur u lind. Se ky civilizim nuk i ka përvetësuar siç duhet liritë dhe të drejtat themelore, dëshmitar është edhe racizmi, mjaft i pranishëm edhe sot e kësaj dite në mjediset e të ashtuquajturave shoqëri të përparuara. Në anën tjetër, modeli i civilizimit islam mund të mos njihet, por ai i ka ofruar zgjidhjet e veta këtu e njëmijë e pesëqind vjet më përpara për këto, nëse mund t'i quajmë: sëmundje socio-kulturore.

SI FILLOI GJITHÇKA?

Vetëm ndryshimi i rrethanave socio-kulturore që i bëri të mundur Revolucioni Industrial i shekullit të nëntëmbëdhjetë, urbanizimi i mjedisëve të banimit, mundësia që edhe gratë të kontribuonin në ekonomi edhe jashtë njësisë familjare, çoi deri te hapi që këto të fundit t'i kërkonin liritë dhe të drejtat e tyre të barabarta me burrat.

Përfashtuar Botën Islame, në Perëndim, për shekuj me radhë të drejtat e grave, nuk vinin në shprehje as për t'u diskutuar. Sistemi patriarkal në vetvete, nuk i cilësonte ato si qenie të barabarta me burrat. Vetë fakti që të drejtat e njeriut të shpallura nëpërmjet Revolucionit Francez, për referencë kishin vetëm burrat, flet mjaft si shembull. Liria nga varësia e burrave, mundësi arsimimi dhe të

drejtat politike, erdhën si kërkesa tek me iluminizmin.

Fillimisht, kërkesat ishin mjaft praktike. Gratë donin ta zhbënin hendekun e madh që i ndante me burrat.

“Feministët do të vazhdonin të bënin pretendime më radikale, duke përfshirë ndër më të spikaturat prej tyre: abortin e legalizuar sipas kërkesës, dashurinë e lirë ose çlirimin seksual, barazinë e plotë me burrat dhe heqjen e diferencimit të roleve të gjinive. Feminizmi shpesh përkufizohet si një lëvizje që kërkon barazi të plotë të të drejtave me burrat, por është e rëndësishme të theksohet se barazia e të drejtave të kërkuara nga feministët shkon përtej barazisë sipas ligjit”, kujton Muhamed Legenhausen, profesor i filozofisë.¹

Duke qenë dëshmitare të pabarazive të thella, kauza e feministëve deri diku ishte e drejtë në krye të herës, por sot synimi është tjetërsuar në një lëvizje ideologjike të rrezikshme (për mendimin tonë si myslimanë), duke qenë se synon ndryshimin e roleve në mënyrë rrënjësore në shoqëri. Kjo kauzë te varietetet më ekstreme të feminizmit nënkupton zhbërjen totale të elementit të burrit në shoqëri dhe tjetërsimin e rolit të familjes.

Sipas amerikanit Legenhausen, feminizmi synon çrrënjosjen e çdo ndryshimi në rolet shoqërore bazuar në dallimet gjinore, dhe kjo është ajo që e dallon atë nga lëvizjet e tjera të grave.²

Vetë termi feminizëm vjen i vonë në histori, sipas Legenhausen, në fillim të shekullit të nëntëmbëdhjetë, socialisti Charles Fourier

Duke qenë dëshmitare të pabarazive të thella, kauza e feministëve deri diku ishte e drejtë në krye të herës, por sot synimi është tjetërsuar në një lëvizje ideologjike të rrezikshme (për mendimin tonë si myslimanë)

(1772-1837)³ ishte ndër të parët që e përmendi këtë nocion. Kornizat ia vuri feminizmi socialist, përkatësisht feminizmi marksist, por sot nga perspektiva historike e filozofike, dallojmë “derivate” të ndryshme të këtyre lëvizjeve për të drejtat e grave.

Por duhet thënë se lëvizjet e hershme të grave nëpërmjet së cilave kërkoheshin të drejtat e barabarta të shkollimit, të punësimit, të votës etj., kanë mbetur një mirazh historik. Sot feminizmi ekstrem kultivon diskurs të egër anti-patriarkat, ku burrat portretizohen si konstrukte sociale shtypëse, e që për rrjedhojë përfaqësojnë armikun ideologjik të feminizmit. Qëllimi, sipas këtij lloji është që frerët e sistemit t’i marrin në duar vetëm gratë.

ISLAMI DHE TË DREJTAT E GRUAS

Një reflektim i shpejt mbi historinë botërore, nxjerr në pah diferencat e mëdha ndërmjet kulturave që prodhuan dy civilizimet e mëdha. Ndryshe nga ai Perëndimor, Civilizimi Islam ia kishte njohur gruas rolin e saj në strukturën e familjes, ia kishte njohur të drejtën e arsimimit, të drejtën e punësimit, të drejtën e pronësisë dhe trashëgimisë, duke e bërë atë dijetare, kapitaliste e pse jo edhe politikane. Kësisoj ajo kishte edhe funksione publike, krahas burrit.

Në vetë gruan e profetit Muhamed a.s., Ajshen r.a. janë të mishëruara këto të drejta. Ajo sot njihet gjerësisht për dijen që e ka lënë si trashëgimi, pastaj edhe rolin e saj këshillues e udhëheqës në disa momente historike.

Filozofi amerikan Legenhausen kujton ndër të tjera një detaj interesant të historisë së lëvizjes për të drejtat e gratë në Perëndim, ndërsa vë në pah vlerën që gruaja kishte në Civilizimin Islam, karshi Civilizimit Perëndimor:

“Pasuesit e një tjetër socialisti të hershëm, Henri de Saint-Simon (1760-1825), futën parimin e androgjinisë, sipas të cilit në fillim të historisë ekzistonte një qenie e përzier mashkull dhe femër. Myslimanët do të zbavitën sapo të mësojnë se dishepujt e Saint-Simon shkuan në Turqi për të kërkuar shpëtimtaren femër pasi kishin humbur shpresën për të gjetur një grua vërtet të lirë në Evropë!”⁴

Myslimanët po ashtu e kanë për mburrje ta thonë se universiteti i parë në botë është themeluar nga një grua myslimane. Fatima al Fihri e lindur 800 vite pas erës së re, la trashëgimi një universitet dhe një bibliotekë të pasur.

Duke qenë se baza e drejtësisë të myslimanët buron nga libri i shenjtë Kurani, referencat për barazi gjinore në Islam, edhe sot e kësaj dite janë të pandryshueshme si koncepte. Kjo

Agjenda e grupeve LGBTIQ+ rrezikon të mos shtrihet në një mjedis konservator, ku Islami shihet si vlerë e patjetërsueshme.

fe abrahamike i trajton gruan dhe burrin si gjini të barabarta, por jo si të njëjta. Fjala vjen, në librin e shenjtë lavdërohen qëndrimet e Merjemes, nënës së profetit Isa a.s., dhe gruas së Faraonit, në rrethana shumë të vështira.

Është i pamohueshëm fakti se që Islami ai që shekuj më parë vuri një standard sipas së cilit i garantohen liritë grave. Kapitali të cilin ajo e trashëgon nga burri dhe bashkëshorti, ia mundëson asaj që të mos ndihet e shtypur në kuptimin ekonomik. Se çfarë efektesh ka dhënë ky standard në historinë e Civilizimit Islam, dëshmitarë i kemi mjaft emra grash të shquara si Fihiri që e përmendëm më sipër, pastaj Nafisa Bint el-Hassan, stërmbesa e profetit Muhamed a.s., Umm el-Darda el-So-ghra, Shuhdah el-Bagdadije etj..

NË LUFTË ME DEMOKRACINË

Demokracia si sistemi më i mirë i vlerave nga të gjitha sistemet e tjera, ua mundëson grupeve të fuqishme të interesit, të çojnë përpara agjendat e tyre, ndonjëherë edhe duke i shtypur të dobët. Myslimanët duhet të jenë të vetëdijshëm për këtë. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, fjala vjen, e thekson në mënyrë eksplicite, se:

“Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal.”⁵



Ky paragraf, jo rrallë herë shpërfillet, keqinterpretohet e keqpërdoret. Pikërisht ky kontekst i styrkeqjes së kuptimit të paragrafit kushtetues, ka prodhuar një klimë krizash e incidentesh kulturore.

Agjenda e grupeve LGBTIQ+ rrezikon të mos shtrihet në një mjedis konservator, ku Islami shihet si vlerë e patjetërsueshme. Në anën tjetër, propaganda me të cilën përkrahet agjenda e LGBTIQ+, është mjaft e fuqishme. Grupe të vogla, organizata joqeveritare të sponsorizuara fuqishëm, media, e deri te politika, janë vënë në shërbim të kësaj agjende. Edhe qeveria aktuale e udhëhequr nga një subjekt politik i cili ka pretendime të rreshtohet bindshëm krah së majtës ekstreme, i ka dhënë shenjat e para të jetësimit të kësaj agjende.

A KANË PËRGJEGJËSI MYSLIMANËT PËR KËTO INCIDENTE?

Myslimanët shqiptarë e kanë hetuar qysh herët rrezikun. Por parullat “Në mbrojtje të Islamit”, “Në mbrojtje të Kuranit”, “Në mbrojtje të Muhamedit a.s.”, ose “Në mbrojtje të hoxhallarëve”, tregojnë sa të papërgatitur kanë qenë karshi këtij zhvillimi socio-kulturor. E vërteta e dhimbshme është se sindromi i injorancës, nuk i shquan vetëm mysli-manët shqiptarë. Një vëzhgim empirik do të zbulonte se manifestimi i Islamit, në pjesën dërmuese të shoqërisë, rrudhet brenda katër mureve të xhamisë dhe shtëpive tona. Mungesa e pastërtisë në ambientet publike, korrupsioni i lartë, dashuria e munguar për librat etj., tregon që ne jemi larg të kuptuarit të Islamit. Siç do të konstatojnë Scheherazade S. Rehman dhe Hossein Askari në studimin e tyre: HOW ISLAMIC ARE ISLAMIC COUNTRIES?⁶, më islame janë vendet jo islame, se sa vendet që njihen si islamike.

“Ne kemi përshkruar ato që ne besojmë se janë mësimet thelbësore të Islamit, mbi bazën e të cilave ndërtohet shoqëria islame dhe një sistem ekonomik islam. Një vëzhgues i rastësishëm do të arrinte në përfundimin se miratimi dhe zbatimi i një sistemi të tillë, i cili i respekton të drejtat e njeriut, manifeston drejtësi sociale dhe ekonomike, nxit veprim dhe punë të palodhur, ofron mundësi të barabarta për të gjithë për t’u zhvilluar, shquhet për mungesë korrupsioni, menaxhon mbeturinat, shquhet për etikë në praktikën e biznesit, tregjet i funksionojnë mirë dhe ka një autoritet legjitim politik - duhet të rezultojë në lulëzim të ekonomive. Këto mësimë, jo praktika aktuale e ato që etiketohen si mysli-manë, duhet të jenë bazë për të gjykuar shoqërinë që pretendon të identifikohet si islamike. Rezultatet tona shumë paraprake tregojnë se vendet islame nuk

Një vëzhgim empirik do të zbulonte se manifestimi i Islamit, në pjesën dërmuese të shoqërisë, rrudhet brenda katër mureve të xhamisë dhe shtëpive tona.

janë aq islamike në praktikën e tyre siç mund të pritët; në vend të kësaj duket se vendet më të zhvilluara prirën të vendosen më lart në indeksin tonë paraprak të Islamit.”⁷

Megjithatë ishin të vetëdijshëm për rezultatet e bazuara nga variablat e llogaritjeve mbi parimet islame duke theksuar se nuk është e lehtë të nxirren përfundime, ata konstatojnë se megjithatë shumica e vendeve të vetë deklaruara dhe të etiketuara si islamike, nuk po i kryejnë punët e tyre në përputhje me mësimet islame, të paktën kur bëhet fjalë për çështjet politike, ekonomike, financiare, ligjore, sociale dhe qeverisëse.⁸

Në një mënyrë, ata e shtrojnë pyetje kaheër të munguara në mesin e mysli-manëve: nëse Islami është një sistem vlerash i garantuar nga Allahu, përse mysli-manët qëndrojnë prapa në çdo fushë? Dhe nëse qëndrojnë prapa, gjë që është e vërtetë, a do të thotë kjo që ata nuk e kanë kuptuar drejt mesazhin hyjnor? Sepse,

ky Islam, ky sistem i garantuar i vlerave nga vetë Allahu, nuk ka probleme, problemi janë vetë mysli-manët.

Flakja e shkencës, keqkuptimi i filozofisë, lënia mënjanë e artit etj., ka rezultuar me rrudhjen e horizontit të dijes për mysli-manët. Brezat e shekujve të vonë, kanë provuar gjithçka ta shpjegojnë nga këndvështrimi fetar, duke i përfshirë këtu edhe fenomenet shkencore. Prandaj rezultatet janë këto që janë.

ÇFARË U DUHET MYSLIMANËVE?

Më sipër i përmendëm disa prej parullave të cilat, qoftë edhe në formën e vërritjeve virtuale, bëhet të qarkullojnë edhe sot e kësaj dite te mysli-manët shqiptarë. Në esencë, ne nuk ftohemi ta mbrojmë Islamin, Kuranin, apo profetin e dashur, por që t’i kuptojmë e t’i jetësojmë mësimet që na kanë ardhur nëpërmjet tyre. Mbrojtja më e mirë e Islamit, vjen nga njohja dhe praktikimi i mësimëve hyjnorë. Ideologjitë bashkëkohore kësaj i frikësohen. Agjendat, sikundër kjo e LGBTIQ+, nuk do të mund të lëshonte kurrë rrënjë në një shoqëri që për vlera ka mësimet e Kuranit.

1 <https://www.al-islam.org/contemporary-topics-islamic-thought-muhammad-legenhausen/islam-vs-feminism?fbclid=IwAR0wO4eRUd4JEVKddhXjOZR-FiqIEzn1vyMSBXsUXMOWXmp6hZ-TrBdxytl>

2 Po aty.

3 Po aty.

4 Po aty.

5 KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS; Neni 24 (Barazia para ligjit).

6 <https://idr.uin-antasari.ac.id/177/1/how-islamic-islamic-countries.pdf>

7 Po aty.

8 Po aty.

OBSH-ja dhe KB-ja duan që të shfaqet haptas aspekti epshor te fëmijët e vegjël anembanë botës

“Shkollat duhet të aftësojnë fëmijët të kenë partner seksual – thonë Kombet e Bashkuara (KB) dhe Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH)”, është titulli i artikullit të Stop World Control, të cilët kanë prova se si OBSH-ja dhe KB-ja duan të normalizojnë aspektin epshor te fëmijët e vegjël në arsimin fillor anembanë botës, me qëllim të normalizimit të pedofilisë.

“Shkollat duhet të aftësojnë fëmijët të kenë partner seksual – thonë Kombet e Bashkuara (KB) dhe Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH)”, është titulli i artikullit të Stop World Control, të cilët kanë prova se si OBSH-ja dhe KB-ja duan të normalizojnë aspektin epshor te fëmijët e vegjël në arsimin fillor anembanë botës, me qëllim të normalizimit të pedofilisë.

“Fëmijët e vegjël janë qenie seksuale, të cilët duhet të kenë partner seksual dhe të fillojnë me seks sa më parë. Për këtë arsye, çerdhet dhe shkollat fillore duhet të mësojnë fëmijët, me qëllim të zhvillimit të epsheve dhe dëshirave seksuale, mësimi të masturbimit, ndërtimit të lidhjeve në mes gjinisë së njëjtë, shfrytëzimit të pornografisë nga interneti dhe mësimi të teknikave të ndryshme seksuale sikur...”

Citati i parafrazuar i lartcekur, është përmbledhja e udhëzimeve zyrtare, të cilët Organizata Botërore e Shëndetësisë dhe Kombet e Bashkuara u kanë dërguar zyrtarëve arsimor anembanë botës. Në ndërkohë, organizatat gjyqësore kanë publikuar deklaratat se duhet legalizuar seksin në mes fëmijëve të vegjël dhe të rriturve, gjersa mediat dhe partitë politike bëjnë thirrje për pranimin e pedofilisë si “orientimi normal seksual”.

Kombet e Bashkuara kanë publikuar dokumentin “Teknikat ndërkombëtare për edukim seksual”, i cili përmban 139 faqe me titull “International technical on sexuality education” në gjuhën angleze me logon e UNESCO – Education Sector dhe The Global

Education 2030 Agenda - Sustainable Development Goals.

Ky është udhëzimi zyrtar për shkollat fillore anembanë botës. Qëllimi i këtij dokumenti është përshkruar në faqen 16, me fjalët e tyre: “Qëllimi është sigurimi i dijes fëmijëve...për të zhvilluar lidhjet seksuale”. Në faqen 17, Kombet e Bashkuara, shpjegojnë se ky udhëzues është destinuar për fëmijë për ndërtimin e marrëdhënieve me partner dhe dashnor seksual. Me fjalët e tyre: “Këto shkathtësi mund t’u ndihmojnë fëmijëve dhe të rinjve në zhvillimin e lidhjeve të shëndosha me anëtarët e familjes, moshatarët, miqtë, partnerët dhe dashnorët seksual.”

Në faqen 71, bëhet nxitja e mësuesve që të udhëzojnë fëmijët e vegjël nga mosha 5 vjeçare për sjellje seksuale, ndërsa fëmijët 9 vjeçar për tërheqje seksuale dhe stimulim seksual.

Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) më tutje ka zhvilluar planin me të cilën i siguron që fëmijët e vegjël të kenë partner seksual. Dokumenti i tyre: “Standardet për edukim seksual në Evropë”, i cili përmban 68 faqe me titull: “Standards for Sexuality Education in Europe” në gjuhën angleze me logon e WHO-Europe dhe BZgA-Federal Centre for Health Education, përveç të tjerash përmban edhe disa udhëzime për çerdhet shkollore dhe shkollat fillore.

Video incizimi është pjesë e këtij programi shkollor evropian, i cili bashkëpunon me Organizatën Botërore Shëndetësore dhe Kombet e Bashkuara në zbatimin e programit të tyre në shkollat anembanë vendit. Ky është

shembull nga bota reale i zbatimit të këtyre udhëzimeve në rastin konkret në Holandë. Video incizimi tregon se si mësuesit nxisin fëmijët të fillojnë me masturbim. Ky video incizim u është shpërndarë mijëra shkollave në Holandë në kuadër të programit të OBSH-së për “*edukim seksual gjithëpërfshirës*”, qëllimi i të cilit është që fëmijët të nisin me marrëdhënie seksuale sa më herët që është e mundur.

Editues i këtij video incizimi është Fondacioni Rutgers, i cili vepron në 27 shtete në botë, dhe është partner i përafërt i OBSH-së dhe KB-së, ndërsa e financojnë Bill Gates dhe Planned Parenthood. Gjuha e cila flitet në video incizim është gjuha holandeze, por të keni parasysh se ky është shembull nga jeta reale e zbatimit të programit të Organizatës Botërore të Shëndetësisë dhe Kombeve të

Agjenda e Kombeve të Bashkuara 2030 është plan për transformimin e secilit aspekt të ekzistencës njerëzore në Tokë gjer në vitin 2030.

Bashkuara, dhe kjo së shpejti do të vjen në shkollë në çdo shtet të botës.

Logoja në dokumentin e Kombeve të Bashkuara “*Teknikat ndërkombëtare për edukim seksual*” tregon se kjo është pjesë e qëllimit të zhvillimit të Kombeve të Bashkuara, sipas Agjendës 2030.

Agjenda e Kombeve të Bashkuara 2030 është plan për transformimin e secilit aspekt të ekzistencës njerëzore në Tokë gjer në vitin 2030. Me fjalët e tyre: “*Kemi miratuar vendimin historik në mënyrë të kuptueshëm, me shtrirje të gjerë edhe mbi njerëzit, duke vendosur një grup qëllimesh universale dhe transformuese. Jemi të përkushtuar pandërprerë të punojmë në zbatimin e kësaj Agjende 2030. Duke hipur në këtë udhëtim kolektiv, japim fjalën se askush nuk do të jetë lënë jashtë kësaj. Këto janë qëllimet universale të cilat përfshijnë tërë botën, shtetet e zhvilluara dhe shtetet në zhvillim.*”

Deklaratat zyrtare të Kombeve të Bashkuara janë të qarta, duan që krejt bota të ndryshojë. Sigurimi që fëmijët e vegjël të kenë marrëdhënie seksuale, t’i mësojnë si të masturbojnë dhe të shfrytëzojnë pornografinë online është pjesë e këtij programi. Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, administrata e Joe Bidenit ka publikuar deklaratat në të cilët konfirmon planet për zbatimin e kësaj agjende në tërë ShBA-të sa më shpejtë të jetë e mundur, ndërsa më së largu gjer në vitin 2030.

Ju lutemi të kuptoni seriozitetin e kësaj situate: “*Teknikat ndërkombëtare teknike për edukim seksual*” të Kombeve të Bashkuara është pjesë e qëllimeve të zhvillimit të qëndrueshëm të Agjendës 2030 të Kombeve të Bashkuara. Administrata e Bidenit premton se do të përshpejtojë zbatimin e kësaj ashtu që Agjenda të jetë e realizuar gjer më 2030. E njëjtë vlen për cilindo komb tjetër të botës, i cili mbështet Agjendën 2030 të Kombeve të Bashkuara.

Në këtë raport më të përafërt, do të shohim se si kjo agjendë zbatohet, për shembull në Holandë. Holanda është në qendër të kësaj agjende botërore të seksualizimit të fëmijëve të vegjël. Ky shtet është seli e botuesit botëror të këtij “*arsimi gjithëpërfshirës seksual*”. Anëtarja e stafit të Fondacionit Rutgers, Ineke van der Vlugt, ka qenë bashkëpunëto e programit të OBSH-së “Standardet për arsimin seksual në Evropë”, duke treguar se sa ky fondacion bashkëpunon me OBSH-në. Dhe sikurse është thënë më parë, fondacionin Rutgers e financojnë Bill Gates, Planned Parenthood dhe Kombet e Bashkuara, si dhe vepron në 27 shtete.





Në pranverë 2023, Rutgersi në Holandë ka filluar kurikulën kombëtare me emërtimin “*Ethet pranverore*”. Pllakati shkollor është vendosur në shkollat fillore anembanë shtetit. Është përkthyer në gjuhën angleze dhe janë shtuar pjesët e theksuar që të zbulohet porosia e këtij pllakati shkollor. Dy djem mbahen për dore dhe thonë: “*Po, të dytë, atë e dëshirojmë*”. Dy vajza të reja gjejnë “*vendin e sigurtë*” për seks. Plani dhe programi arsimor “*Ethet e së premtes*” në mënyrë agresive e shtyn përpara temën e homoseksualitetit mbi fëmijët e pafajshëm dhe të pambrojtur. Aty janë edhe ilustrimet e këtij programi për shkollat fillore.

Është një gjë kur personi njoftohet me identitet seksual, por është krejt ndryshe kur konfuzioni seksual promovohet në shkolla në mënyrë që fëmijët të indoktrinohen drejt stilit homoseksual të jetës. Por, OBSH-ja dhe KB-ja në mënyrë të drejtpërdrejtë promovojnë shtyrjen e fëmijëve të vegjël drejt homoseksualitetit.

Në faqen 40 të “*Standardet për edukim seksual*”, shkollave ju preferohet që fëmijët 4 vjeçar t’i mësojnë për “*lidhjet me të njëjtën gjini*”. Ndërsa në faqen 44, edukatorëve ju urdhërohet që fëmijët 9 vjeçar të mësojnë për “*miqësinë dhe dashurinë ndaj personave të së njëjtës gjini*”. Në shembullin praktik të fondacionit Rutgers shohim se nuk bëhet fjalë për informimin e fëmijëve, por për inkurajimin e tyre aktiv që të nisin rrugës drejt homoseksualitetit sa më parë që është e mundur.

Është një gjë kur personi njoftohet me identitet seksual, por është krejt ndryshe kur konfuzioni seksual promovohet në shkolla në mënyrë që fëmijët të indoktrinohen drejt stilit homoseksual të jetës.

Të kesh turp, është ndjenjë natyrore të cilën e kanë të gjithë fëmijët normal, i cili i mbron nga abuzimi dhe lëndimet nga përvoja seksuale e papërshtatshme dhe e parakohshme. Seksualiteti është me siguri pjesa më e ndjeshme dhe më e prekshme e njerëzimit tonë, e cila mund t’i traumatizojë në mënyrë të përhershëm në rast se i qasemi në mënyrë të gabuar. Turpi është mekanizmi i rëndësishëm për sigurinë tonë. Këto programe shkollore kanë për qëllim të largojnë

këtë barrierë natyrore, ashtu që fëmijët e vegjël nuk do të dëgjojnë instinktin e vet natyror, i cili ju flet që të mbrojnë trupin e tyre. Kjo i bën jashtëzakonisht të pambrojtur dhe kafshatë e lehtë për grabitqarë seksual.

Kjo situatë është shumë më serioze nga ajo që mund të imagjinojmë. Do të cekim fjalët e një sinjalizuesi të elitës botërore: “*Ata duan që çdokush të mund të ketë seks me çdo kënd. Duhet të ngrihemi dhe fuqishëm t’i mbrojmë fëmijët e tërë botës.*”

Stop World Control kërkon që këtë raport të shpërndajmë në tërë botën: “*Është me rëndësi që ky raport të arrijë te sa më shumë njerëz. Ju lutemi, shpërndajeni kudo, duke shfrytëzuar të gjitha mënyrat e shpërndarjes. Mund të kopjoni këtë letër dhe t’i dërgoni gazetave lokale, shkollave, zbatuesve të ligjit, kishave, spitaleve, politikanëve, etj.*”

Përktheu nga gjuha kroate: Faik Miftari
Burimi: provjeri.hr/expose-news.com/
stopworldcontrol.com

Jeta dhe veprimtaria e një malësori e përjetësuar në mes dy kopertinave


(PROF. PLEURAT KRASNIQI, AVDYL HYSË GJONBALAJ TRIBUN I PLAVË-GUCISË, MONOGRAFI, PRISHTINË, 2023)

Dr. Nuridin Ahmeti

Librave të botuar për ngjarje e personalitete të rajoneve të Plavës dhe Gucisë, i është shtuar edhe një titull: “Avdyl Hysë Gjonbalaj, tribun i Plavë- Gucisë”, të autorit Pleurat Krasniqi.

“Ka shumë pjesë të historisë së Shqipërisë që nuk njihen. Dhe ajo që mungon, mbase mund të plotësohet nga historia gojore”¹- kështu do të shprehej njëri nga studiuesit e njohur të albanologjisë, Robert Elsie, në një intervistë, dhënë për njërin nga televizionet e Tiranës. Në kuadër të shumë ngjarjeve e personaliteteve të historisë shqiptare që kemi pak informacione të shkruara, por që janë plotësuar nga kujtesa popullore, është edhe figura e Avdyl Hysë Gjonbalajt, tani e përjetësuar edhe në mes të dy kopertinave të monografisë së lartcekur.

Padrejtësive të vendimeve të Kongresi të Berlinit, të vitit 1878, ku territoret e konsiderueshme të trojeve shqiptare mbetën nën pushtimin e fqinjëve, popullata do t’i përgjigjej me revoltë e mjete luftarake. Në mesin e tokave shqiptare që u ndan nga trugu janë edhe territoret e Plavës dhe Gucisë. Në rrethanat e tendosura politike të kohës për shqiptarët, të cilët ishin organizuar në kuadër të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit të vitit 1878, e në mesin e tyre edhe popullata shqiptare, që tanimë kishte mbetur padrejtësisht në Mbretërinë e Malit të Zi, lindi më 1880 në Vuthaj, Avdyl Hysë Gjonbalaj. Kur rrethanave specifike, politike e kombëtare më të cilat lindi Avdyli i Gjonbalajve, i shtohen



edhe traditat atdhetare e familjare me të cilat u rrit dhe u edukua kryepersonazhi i kësaj monografie, padyshim se ky binom prodhon njerëz të vetëdijshëm e të ndërgjegjshëm për vendin e tyre, i tillë siç ishte i biri i Hysë Gjonbalajve, Avdyli. Shkollimin fillestar e mori në mejtep nga i afërmi i tij, mulla Hysen Gjonbalaj, i njohur në ato anë si Hoxhë Vuthi, një atdhetar i përkushtuar, dhe njëri nga iniciatorët për hapjen e shkollës së parë shqipe në Vuthaj, anëtar i Komitetit Mbrojtja Kombëtare e Kosovës, i cili do të ketë ndikim në personalitetin e tij.

Padrejtësive të vendimeve të Kongresi të Berlinit, të vitit 1878, ku territoret e konsiderueshme të trojeve shqiptare mbetën nën pushtimin e fqinjëve, popullata do t’i përgjigjej me revoltë e mjete luftarake. Në mesin e tokave shqiptare që u ndan nga trugu janë edhe territoret e Plavës dhe Gucisë.

Siç e shënon edhe autori i librit, pothuajse në të gjitha rrethanat politike e shoqërore në të cilat kaluan shqiptarët e asaj ane, Avdyli Hysë Gjonbalaj është prezent duke i shërbyer popullit ku ishte lindur dhe rritur. Oda e tij, u bë vatër ku njerëzit mblidheshin e trajtonin halle shoqërore e politike, me të cilat përballeshin popullata e asaj ane. I gatshëm t'u përgjigjej vendasve e bashkëkombësve të tij për zgjidhjen e brengave që nuk ishin të pakta, e sidomos me pjesëmarrjen e tij në pajtimin e gjaqeve e shuarjen e ngatërresave, ku siç shprehet autori në këtë monografi, në këtë raste Avdyli i Gjonbalajve ia delte mbarë. Padyshim, se angazhimet e birit të Gjonbalajve të Vuthajve, në të mirë të bashkëkombësve të tij nuk ishin edhe pa rreziqe, sepse lëvizjet e tij evidentoheshin nga organet e kohës, me ç'rast u detyrua të kalojë në Shqipëri për strehim të përkohshëm, por arrestohet në Kolgecaj të Bajram Currit më 1945, dhe sipas marrëveshjes që kishte Shqipëria e asaj kohe me ish-Jugosllavinë që të gjithë ata që e kalonin kufirin ilegalisht, qoftë ata nga Shqipëria në Jugosllavi dhe anasjelltas, duhet që organet përkatëse ta bëjnë dorëzimin në vendin nga kanë ardhur. Rrjedhimisht sipas një marrëveshje të tillë, Avdyli duhej të dorëzohej nga organet shqiptare dhe pas disa ditëve të dorëzimit, Avdyli dënohet me pesë vjet burg në Jugosllavi.

I survejuar nga organet e kohës, Avdyli si shumë bashkëvendës të tij të kësaj ane, detyrohet të largohet nga vendlindja, ku kishte zhvilluar veprimtarinë e tij prej shumë kohe dhe të emigrojë në Amerikë, më 1973, aty ku më herët kishte shkuar nipi e tij, Fero Kadri Avdyli dhe në vitin 1979 ndërroi jetë në Nju Jork. Lajmi për vdekjen e Avdylit ishte botuar edhe në gazetën e njohur të shqiptarëve të Amerikës "Dielli". Për qëndrimin e tij gjashtëvjeçar në Amerikë, flasin shumë

bashkëveprimtarë të tij në Amerikë, kurse ndër ta shquhet edhe veprimtari i madh i çështjes kombëtare, Idriz Lamaj.

Autori i monografisë, *Avdyli Hysë Gjonbalaj, tribun i Plavës - Gucisë*, ka arritur që të mbledhë materiale, kujtime, literaturë dhe t'i sistemojë në mes dy kopertinave, duke na dhuruar një monografi me interes për një veprimtar të përkushtuar të asaj ane.

Bibliotekat tona janë pasuruar edhe me një titull të ri që bën fjalë për Plavën dhe Gucinë, e për njërin nga figurat kontribut dhënëse në dimensionin atdhetar, Avdyli Hysë Gjonbalaj.

Aspekti etnografik, social e kulturor i trajtuar në këtë monografi, përgatitja teknike, shtypi etj., sigurisht se e bën këtë libër edhe me interesant për lexuesin.

Mozaikut të librave të botuara për shqiptarët e kësaj ane, po i shtohet edhe një vepër, e cila do të ndihmojë në qartësimin e kontributit atdhetar të shqiptarëve të këtyre viseve.

Në qoftë se do t'i referohemi thënies së profesor Rexhep Qosjes se "për Vuthajt mund të rrëfihen ngjarje e mund të bëhen e duhet të bëhen vepra", ky libër është njëra nga veprat e shkruara për njërin nga bijtë e kësaj ane, sigurisht se për pasardhësit e Avdyli Hysë Gjonbalajt do të rrëfihen ende ngjarje e do të shkruhen, e duhet të shkruhen edhe libra të tjera.

1 "Vakum në historinë e Shqipërisë, Robert Elsie, "Të mbushet nga historia e folur", <https://top-channel.tv/2016/03/29/vakuum-ne-historine-e-shqiperise-robert-elsie-te-mbushet-nga-historia-e-folur/> (hulumtuar më 25.8.2023).



Guri i sadakasë, fenomen dinjitoz islam i bamirësisë

Mr. Sc. Bahri Curri

Sadakaja si vlerë dhe vepër e çmuar ka S rëndësi të madhe për jetën sociale të shoqërisë dhe për subvencionimin ekonomik. Po ashtu është një mekanizëm efikas për luftimin e varfërisë dhe përmbushjen e nevojave të njerëzve, të çfarëdo kategorie qofshin.

Islami e ka rregulluar mrekullueshëm statusin ekonomik të njeriut, sa që edhe shumicën e detyrave fetare, të mos themi të gjitha, i ka sistemuar në atë mënyrë që disa obligime fetare, por edhe kefaretet (shpëgimin që duhet bërë për gabimet e bëra), i ka ndërlidhur me pagesën e tyre ndaj shtresave të varfra e të njerëzve në nevojë, si zekati, sadekatul-fitri, kurbani, kefareti i agjërimit, kefareti i betimit, etj..

Sadakaja është një vepër madhështore, ngase ajo konfirmon besimin e njeriut, dëshmon për praninë e imanit në zemër. Është një vepër që sjell dobi në dynja e në ahiret. Sadakaja është një vepër e jashtëzakonshme që sjell qetësi e gëzim për atë që e jep (për dhënësin), por edhe sjell lehtësim e përmbushje për atë që ka nevojë (për marrësin).

Sadakaja për nga obligueshmëria është dy llojesh: 1. Obligative, si zekati e sadekatul-fitri; dhe, 2. Vullnetare. Ndërsa për nga natyra materiale, gjithashtu ndahet në dy lloje: 1. Me para; 2. Pa para.

Njerëzit, sa herë që përmendet sadakaja, gjithmonë menjëherë përdoren për sadakanë me para, për ndihmën financiare, mirëpo ka edhe sadaka pa para dhe që nuk kushton, madje ka shumë mënyra të ndryshme në këtë. Të kësaj natyre janë: duaja, buzëqeshja, këshillimi, mësimi dhe përhapja e diturisë, ndihmesa ndaj të tjerëve, ndarja e kohës për të tjerët, të edukuarit, falja, të folurit me respekt e butësi, të lumturojmë të tjerët, të bëhemi pjesë e gëzimit të të tjerëve, të udhëzuarit, durimi, mosbërja keq, vizitat, etj..

Ne këtu do të flasim për kategorinë e sadakasë me para, duke u fokusuar në një aspekt të saj, ruajtja e dinjitetit të njeriut. Qëllimi i sadakasë nuk është vetëm përmbushja e

Sadakaja është një vepër madhështore, ngase ajo konfirmon besimin e njeriut, dëshmon për praninë e imanit në zemër.

nevojave materiale të njerëzve, por njëkohësisht edhe mbrojtja e krenarisë së njeriut, ruajtja e dinjitetit, dhe mospërrulja e personalitetit të tij. Edhe në këtë rast, kihet parasysh aspekti emocional i njeriut, qetësia shpirtërore e tij, dhe aq me rëndësi është që ai të mos ndjehet inferior në shoqëri për shkak të gjendjes së tij materiale.

Pjesëtarët e ymetit islam e kanë kuptuar mirë këtë mesazh, dhe në historinë islame kemi plot shembuj që të bëjnë të ndjehesh mirë dhe krenar pse jemi pjesëtarë të kësaj feje madhështore. Kemi rastin e Umer bin Abdulazizit, ku me udhëheqjen e drejtë të tij, në kohën e sundimit të tij, nuk ka mundur njeriu të gjejë ndonjë nevojtar, apo ndonjë të varfër, për t'ia paguar (dhënë) zekatin, apo sadakanë. Kjo për shkak të shpërndarjes së drejtë e të duhur të pasurisë së shtetit në popull, por edhe për shkak të vetëdijes së lartë të popullatës myslimane për pagesën e detyrimeve fetare si zekati e sadakaja

dhe kontributet e tjera, e aq më tepër përmbushja e nevojave të njerëzve të të gjitha shtresave.

Kemi edhe rastin e Ali bin Hasen, i cili sa ishte gjallë i ndihmonte 100 familje nevojtare, pa e ditur askush që ai është personi që ndihmon, as familjet që ndihmoheshin, por as edhe të tjerët. Ai madje vetë personalisht ua shpërndante ndihmat nëpër shtëpi gjatë natës duke ua lënë te dera pa u vërejtur fare. Edhe pse ai kishte mundësi që t'i angazhonte me këtë çështje shërbëtorët e tij, ngase ishte pushtetar, mirëpo ai këtë e bënte vetë personalisht, dhe nuk donte ta dinin njerëzit se ai po ndihmon, për dy arsye. E para, këtë gjë e bënte sinqerisht vetëm për Allahun (fisebilillah). Dhe e dyta, donte që ta ruante dinjitetin e njerëzve të varfër, që ata përpos që të përmbushnin nevojat e tyre me këto ndihma, njëkohësisht të mos ndjeheshin keq për gjendjen e tyre materiale, por edhe të mos ngushtohen kur të takohen me të, apo kur të dalin para tij, e në veçanti të mos ulet statusi i tyre para njerëzve. Tërë këtë, njerëzit e kuptuan vetëm tek pas vdekjes së tij. Dhe atë në dy aspekte: E para, personi që ia pastroi xhenazën e tij, i pa plagët (shenjat) e litarit të bëra në trupin e tij gjatë bartjes dhe shpërndarjes së ndihmave. Dhe e dyta, atyre 100 familjeve

që nga ajo ditë, kur ai vdiq, nuk iu shkonin më ndihma, dhe e kuptuan se ky ishte ai furnizuesi i tyre.

Një praktikë e tillë, ka vazhduar përgjatë tërë historisë islame te myslimanët, të cilët gjenin mënyra e forma të përshtatshme për ta realizuar këtë qëllim shumë fisnik.

E ajo që më shtyri të shkruaja këtë shkrim, ishte mu kjo ndjenjë e lartë dhe fisnike, për një dukuri të përhapur gjatë kohës së Perandorisë Osmane, një fenomen dinjitoz islam i bamirësisë. Bëhet fjalë për fenomenin *Guri i Sadakasë* (*Sadaka Taşı*-Sadaka Tashë), që njihet edhe si *Guri i Bamirësisë*, *Guri i Lëmoshës*.

Në shoqërinë myslimane, gjatë kohës së Perandorisë Osmane, *Guri i Sadakasë* ishte një institucion bamirësie që ishte shumë i veçantë dhe i bukur.

Nuk mund të them që nuk ishte i përhapur edhe më herët, por ajo që është e sigurt se në kohën osmane ishte një fenomen shumë i përhapur. Ishte krijuar një model interesant, edhe për të ndihmuar njerëzit, e edhe për të mos u ofenduar ata që ndihmoheshin. E që është më interesantja, të mos njiheshin asnjëra palë, as ata që ndihmonin, e as ata që ndihmoheshin.

Guri i Sadakasë ishte një nga dinamikat shoqërore të osmanëve. Ishte një ndihmë e menduar mirë dhe në mënyrë aq delikate sa nuk do të njihej as dora që jep, e as dora që merr. Mendohet se kjo rrjedh nga shekulli XVI, nga koha e sulltanit Sulejman Kanuni, dhe ky sistem i *Gurit të Sadakasë* i vendosur nëpër pika të caktuara nëpër qytete gjatë periudhës osmane siguron që bashkëpunimi i urdhëruar nga Islami për të eliminuar pabarazitë e të të ardhurave midis njerëzve të kryhej sa më mirë dhe më efikas.

Sadakaja është më së miri të jepet fshehurazi, megjithatë, ndonjëherë mund të jetë i dobishëm njoftimi për ata që japin bamirësi, bëjnë vepra të mira dhe informojnë publikun. Kështu, njerëzit inkurajohen që të ndihmojnë të varfrit. Allahu i Madhëruar në Kuran thotë: “Nëse lëmoshat i jepni haptazi, ajo është mirë, por nëse ato ua jepni të varfërve fshehurazi, ajo është edhe më e mirë për ju.” (El Bekare, 271).

Në komentim të këtij ajeti, dijetarët arritën në përfundimin se zekati duhet dhënë haptazi, ndërsa sadakaja dhe veprat e tjera bamirëse duhen bërë fshehurazi.

Njerëzit linin lëmoshën e tyre në *Gurët e Sadakasë* që gjendeshin në xhami, apo gjetiu, dhe pastaj nevojtarët merrnin aq sa iu duhej atyre pa e parë atë që jepte. Gjithashtu kjo tregon për nivelin e lartë të vetëdijes së anëtarëve të shoqërisë, të cilët ishin në një gjendje të lartë e të vërtetshme për sa i përket moralit dhe ndjenjës së përgjegjësisë, saqë edhe ata që kishin nevojë nuk abuzonin me këtë liri. Merrnin vetëm aq sa iu duhej pa keqpërdorur mundësinë, gjithmonë duke pasur parasysh frikën e Allahut e jo frikën e njerëzve.

Myftiu i Konakut në zonën e Izmirit, Zeki Aksoy, thotë: “Feja islame i vendos njerëzit në qendër, dhe për këtë arsye është një fe që sjell bashkëpunimin, solidaritetin dhe dashurinë në krye për të eliminuar dhe minimizuar dallimet mes njerëzve.”

Duke theksuar se bashkëpunimi është urdhëruar në Kuran dhe se Pejgamberi Muhamed a.s. në shumë hadithe rekomandon ndihmën, dhënien e lëmoshës, shqetësimin për problemet e njerëzve dhe huazimin e parave. Aksoy thotë: “Padyshim që ka dallime mes njerëzve për sa i përket të të ardhurave, për nga pozicioni i tyre. Do të ketë të pasur dhe të varfër. Dhënia e lëmoshës bëhet që të varfrit të mos mbeten të shtypur, të vetmuar dhe të harruar në këtë shoqëri, dhe që të pasurit të mos e shohin veten arrogantë në pasurinë e tyre, i afron ata me njëri-tjetrin dhe krijon lidhjen e dashurisë mes tyre. Shembulli më i mirë i kësaj janë *Gurët e Sadakasë*, të cilët u bënë traditë në Perandorinë Osmane.”

Po ashtu thotë: “Kur të pasurit duan që të ndihmojnë, zgjedhin kohën e natës, në errësirë i lënë paratë në *Gurin e Sadakasë*. Ndërsa të varfrit marrin nga ai *Guri i Sadakasë* vetëm aq sa kanë nevojë. Me fjalë të tjera, i pasuri ynë është një person i kuptueshëm dhe mendon për gjendjen e tjetrit; është joarrogant, jokrenar, jomburraveç. Ai nuk dëshiron që të lëndohet (të ndjehet jo mirë) i varfëri duke ia dhënë paratë (zekatin e sadakanë) në dorë e duke e shikuar në sy. Ai është plotësisht modest dhe e ndihmon pa asnjë reklamë apo publikim. I varfëri ynë gjithashtu nuk është egoist, dhe kur vjen thotë: “Sa kam nevojë? 1 cent, ai merr 1 cent. Ai mendon edhe për tjetrin duke thënë se ka edhe më të varfër se ai.”

SI FUNKSIONONTE GURI I SADAKASË?

Në Perandorinë Osmane, njerëzit e varfër që nuk mund t’iu tregonin të tjerëve për problemet e tyre, vinin te *Guri i Sadakasë* në orët e vona të natës kur kishin nevojë për të. Pasi merrnin prej këtij *Guri* paratë që iu nevojiteshin atyre, ndërsa paratë tjera i linin aty duke menduar edhe për të tjerët që kanë nevojë sikurse ata, dhe njëkohësisht duke u lutur me zemër për ata që kanë dhënë këtë bamirësi.

Të varfrit dhe nevojtarët kujdeseshin që të merrnin vetëm atë që iu nevojitej atyre dhe sasinë e nevojshme nga ajo që ishte grumbulluar në *Gur*, dhe të tjerat t’ua linin të tjerëve. Kjo bindje, ky altruizëm, ky mendim delikat, meriton çdo lloj vlerësimi. Njerëzit në atë kohë, e zgjidhën në mënyrën më të mirë ndihmën e njëri-tjetrit përmes *Gurit të Sadakasë*, duke treguar fisnikëri, virtyt dhe ndjeshmëri.

Ata pasqyruan dhembshuri dhe dashuri në shërbimet e tyre, treguan dashamirësinë e bamirësisë me masat më ideale, treguan kujdesin, mirësjelljen dhe përpjekjen maksimale për të mbrojtur dinjitetin e të varfërve, të vejave dhe jetimëve. Është një stil shembullor i sjelljes në të cilin ndjeshmëria, dhembshuria dhe dashuria realizohen në mënyrë ideale. Këto janë parimet jetike që duhen kujtuar dhe fituar për të vlerësuar dinjitetin e njerëzimit.

Gurët e Sadakasë ishin në madhësi të ndryshme, ata zakonisht ishin në formë cilindrash, ose në drejtkëndëshe në formë prizmi, ku këta gurë cilindrikë apo katrorë, ishin të ngulitur vertikalisht në tokë, dhe ishin 60cm, 90cm, 140cm, e deri në 2 metra të lartë. Majat e tyre ishin drejtkëndëshe ose të rrumbullakëta sipas gurit, dhe diku 10-15cm brendësia e

tyre ishte e zbrazët, aty ku vendosej sadakaja. Por kishte edhe të atillë që ishin të vendosura në formë zgavrash në mure. Ndërsa koha e preferuar, si për të lënë bamirësit sadakanë aty, ashtu edhe si për të marrë nevojtarët sadakanë, ishte nata, në orët e vona të mbrëmjes dhe pas jaciesë, e ndonjëherë edhe para sabahut.

Këta *Gurë* vendoseshin në vende të ndryshme që ishin të frekuentuara, si te xhamia, te tregu, te spitali, në sheshe nëpër qytete e qyteza, etj.. Me rëndësi vendosej në një vend të veçantë dhe të përshtatshëm ku nuk mund të vërehej as dhënësi e as marrësi. Pra ishte krijuar një model i tillë për të mos u lënduar e ofenduar njerëzit e varfër e të mos ndjeheshin në siklet, po ashtu edhe dhënësi të rrijë larg hipokrizisë e ekspozimit.

Gjurmë të këtyre *Gurëve* ka nëpër të gjitha territoret ku kanë sunduar osmanët, si në Turqi, Bullgari, Bonjë e Hercegovinë, Maqedoni, Kosovë, Tunizi, Algjeri, etj.. Vetëm në Stamboll përmendet që kishte mbi 160 *Gurë të Sadakasë*.

Këta *Gurë* kanë frymëzuar edhe organizatat humanitare, ku një organizatë e tillë edhe është quajtur “*Sadaka Taşı*” – (*Guri i Sadakasë*), e cila u themelua në Yskydar, në Stamboll në vitin 2010, e cila ka ndihmuar edhe banorët në trojet shqiptare me rastin e fatkeqësive të ndryshme.

Meqenëse shumë pak prej këtyre *Gurëve* kanë mbijetuar deri në ditët e sotme, nuk është e mundur që të jepen shifra të sakta për numrin e tyre. Nuk është bërë asnjë hulumtim serioz për këto monumente të virtutit (përveç disa punimeve spontane dhe të pjesshme), të cilat monumente gradualisht janë lënë pas dore për shkak të ndryshimit të kushteve, të harruara me kalimin e kohës dhe të lënë në dorë të fatit të tyre.

Nga gjendja aktuale e këtyre *Gurëve* mund të vërehet se disa prej tyre janë harruar mënjane, dhe disa prej tyre janë bërë të papërdorshme për shkak të ndryshimit të kushteve botërore dhe jetës social-kulturore. Ata kanë mbetur vetëm në kujtimet e lodhura të të moshuarve që mezi i mbajnë mend. Shumica prej tyre kanë humbur, ose janë shtyrë mënjane, ose janë kthyer përmbys gjatë aktiviteteve të gabuara komunale, shpronësimeve, punimeve të rrugës, sheshit dhe trotuarit, ose janë shkatërruar plotësisht.

Do të ishte mirë të mbrohen të paktën *Gurët* ekzistues të këtyre monumenteve të virtutshme, vlera dhe detyra e të cilëve nuk mund të kuptohen, sepse sot nuk përdoren, siç janë përdorur më herët, dhe nuk dihet e as nuk kuptohet përdorimi i tyre. Të paktën, kudo që gjenden këta *Gurë*, ta bëjnë praktike njoftimin për ta duke treguar emrin dhe pozicionin e tyre me një etiketë.

Këta *Gurë*, secili prej të cilëve është monument i singjeritetit të myslimanëve, duhet që të konsiderohen edhe si *Gurë*



specifikë dhe emblematik në historinë e kulturës dhe qytetërimit. Sidomos kur po jetojmë në një kohë ku po garohet mes njerëzve që të tregojnë aftësitë e tyre të rrëmbimit, vjedhjes, mashtrimit dhe korrupsionit. Në një kohë ku kompanitë vjedhin dhe mashtrojnë, dhe atë madje në emër të shërbimit, ku arkat e shtetit zhvaten padrejtësisht... Andaj edhe është e vështirë, e madje për shumë kënd edhe e pakapshme që të kuptohet funksioni i një guri të tillë si *Guri i Sadakasë*.

Këta *Gurë* të njohur si një traditë e zakonshme në periudhën osmane, megjithëse sot kanë humbur plotësisht funksionin e tyre, janë simbole të rëndësishme që shpalosin pasurinë e kulturës islame-osmane me ata pak shembuj që kanë mbijetuar në xhamitë historike.

Megjithatë misioni i *Gurit të Sadakasë* nuk ka mbaruar. Sot ai kryen një detyrë të re. E djeshmja ishte mishërimi i mëshirës, dhembshurisë dhe delikatesës, ndërsa sot është një *Gur* themeli për të kuptuar të kaluarën dhe të tashmen, si dhe shoqëria ta kuptojë rrezikun e ekspozimit të sotëm në “sferën publike”.

Secili duhet që ta kuptojë se bamirësia buron nga zemra, nuk ka nevojë për ekspozim dhe reklamë. Aq më tepër, ajo që është edhe më e rëndësishme, se nevojitari (i varfëri) nuk duhet të vritet moralisht pse po merr ndihmë. Andaj shpresojmë që kuptimi dhe misioni i këtyre *Gurëve të Sadakasë* të reflektojë përsëri në ditët tona në forma dhe mundësi të reja, ku do të vendosen lidhje të reja mes të varfërve dhe të të pasurve, dhe të krijohet një atmosferë e re dhe e dinjitetshme, ku edhe dora që jep, por edhe dora që merr, do të jenë të lumtura.

Burime:

- “*Sadaka taşı*”, (parë për herë të fundit më 17.08.2023), <https://www.yenisafak.com/ramazan/sadaka-tasi-2474030>
- “*Unutulan Gelenek Sadaka Taşı*”, (parë për herë të fundit më 17.08.2023), <https://evrenseldegerler.org.tr/unutulan-gelenek-sadaka-tasi/>
- “*Sadaka vermenin edepi yolu: Sadaka Taşları*”, (parë për herë të fundit më 17.08.2023), <https://hayallem.com/editorun-sectiklari/sadaka-vermenin-edepi-yolu-sadaka-taslari/>
- “*Sadaka Taşı Nedir?*”, (parë për herë të fundit më 17.08.2023), <https://www.islamveihsan.com/sadaka-tasi-nedir.html>
- “*Osmanlı'nın unutulan inceliği: “sadaka taşları”*”, (parë për herë të fundit më 17.08.2023), <https://www.yenisafak.com/kultur-sanat/osmanlinin-unutulan-inceligi-sadaka-taslari-545779>
- “*Sadaka taşı*”, (parë për herë të fundit më 17.08.2023), <https://tr.m.wikipedia.org/wiki/Sadaka>.

DEKLARATA E MYFTIUT TËRNAVA PËR ESKALIMIN E SITUATËS NË VERI TË KOSOVËS



Vrasja e policit të Kosovës, Afrim Bunjaku, dhe plagosja e një polici tjetër në krye të detyrës në Veriun e Kosovës janë akte terroriste të përgatitura e të realizuara nga sfiduesit e vendit e shtetit tonë, nga grupet kriminale serbe, që prej kohësh veprojnë në Veri të vendit, e të cilat mbështeten direkt nga Serbia.

Sulmi i sotëm është atakim ndaj vendit tonë, Kosovës, dhe ndaj rendit kushtetues. Në emër të Bashkësisë Islame të Kosovës, institucioneve të saj dhe në emrin tim shpreh ngushëllimet

më të thella për familjen Bunjaku, biri i së cilës sot ra në krye të detyrës, ndërsa policit të plagosur, Alban Rashitit, i dëshirojmë shërim sa më të shpejtë.

Në këto momente sfiduese për rendin, ligjin e shtetësinë e vendit tonë, kërkohet nga ne unitet veprues në tejkalimin e kësaj situatë. Jemi në mbështetje të institucioneve e organeve zbatuese të ligjit në vend.

Myftiu i Kosovës,

Naim ef. Tërnavë

Prishtinë, më 24 shtator 2023

MYFTIU TËRNAVA MORI PJESË NË VARRIMIN E POLICIT AFRIM BUNJAKU

Më 25 shtator 2023, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, mori pjesë në varrimin e policit Afrim Bunjaku, i cili u vra dje në Veri të Kosovës nga grupet terroriste serbe. Në këtë ceremoni morën pjesë edhe krerët më të lartë shtetërorë, presidentja Vjosa Osmani, kryetari i Kuvendit Glauk Konjufca, kryeministri Albin Kurti, ambasadorë, deputetë, ministra, si dhe shumë qytetarë të tjerë.

Në fjalën e tij, Myftiu Tërnavë, vlerësoi lart punën dhe angazhimin e Policisë dhe të Ushtrisë sonë për ruajtjen e rendit në vend. Ai tha se të vdesësh për atdhe është grada më e lartë që Zoti ia ka dhënë robit të tij. kusht, që prapë të vdesin në mbrojtje të vatinit.

Gjatë kësaj ceremonie Myftiu Tërnavë i priu edhe faljes së namazit të xhenazes, me lutjet që Zoti ta ketë marrë në mëshirën e Tij, ndërsa familjarëve t'u japë sabër që ta përballojnë me lehtësi këtë ndarje.

Ndërkaq, më 27 shtator 2023, Myftiu Tërnavë, i shoqëruar nga bashkëpunëtorët e tij, vizitoi për ngushëllime familjen e dëshmorit.

Myftiu Tërnavë tha se polici i vrarë tashmë nuk i takon vetëm familjes Bunjaku, por ai është një hero dhe një dëshmor i gjithë vendit tonë. Ai luti Zotin që shpirtin e Afrimit ta ketë

Myftiu Tërnavë përmendi ajetin kuranor ku Zoti lavdëron ata që vdesin duke mbrojtur atdheun e tyre, duke thënë se ata mbesin të gjallë, por ne nuk e kuptojmë gjallërinë e tyre,

ata do të jenë në vende të larta në Xhenet, dhe sikur po të pyeteshin nëse duan të kthehen përsëri në këtë botë, ata do të pranonin me të vetmin



mëshiruar dhe ta ketë shpërblyer me Xhenet, ndërsa familjarëve t'u japë forcë e gajret që ta përballojnë sa më lehtë këtë ndarje.

MYFTIU TËRNAVA PA NGA AFËR PUNIMET NË NDËRTIMIN E XHAMISË QENDRORE NË PRISHTINË

Më 2 shtator 2023, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, pa nga afër punimet në ndërtimin e Xhamisë Qendrore në Prishtinë. Ai u njoh për së afërmi me ecurinë e punimeve nga përgjegjësit, për çka u shpreh i kënaqur me ecurinë e tyre. Gjatë kësaj dite, pra më 2 shtator, është betonuar edhe një pjesë e pllakës së tretë të xhamisë.



MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM AMBASADORIN E REPUBLIKËS SË TURQISË NË KOSOVË, Z. TUNC ANGILI

Më 4 shtator 2023, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, priti në takim ambasadorin turk z. Tunc Angili, i cili shoqërohej nga këshilltari për Çështje Fetare pranë kësaj ambasade, z. Bunyamin Albayrak.

Myftiu Tërnavë i njohu ata me punët dhe sfidat e institucionit të Bashkësisë

Islame të Kosovës, si dhe për bashkëpunimin e mirë që ka BIK-u me institucionet dhe organizatat qeveritare turke, me Dijanetin, Drejtorinë e Vakëfeve, TIKA-n, Qendrën Kulturore “Yunus Emre” etj.

Myftiu Tërnavë theksoi se falë këtij bashkëpunimi janë realizuar një sërë

projektesh në fushën e arsimit, kulturës e trashëgimisë fetare islame në vend, për çka ai u shpreh tejet falënderues ndaj shtetit turk.

Nga ana e tij, ambasadori Angili falënderoi Myftiun Tërnavë për mikpritjen dhe për bashkëpunimin e shkëlqyer që kanë pasur me institucionet dhe organizatat qeveritare të Turqisë, dhe theksoi se ky bashkëpunim me ndihmën e Zotit do të vazhdojë edhe në të ardhmen.

Myftiu Tërnavë bashkë me ambasadorin Angili, morën pjesë në ceremoninë e fillimit të vitit të ri shkollor në Medresenë “Alauddin” në Prishtinë, me ç’rast falë donacionit të Fondacionit të Dijanetit turk u ndanë çanta dhe mjetet shkollore për të gjithë nxënësit e Medresesë “Alauddin” në Prishtinë, në Prizren e Gjiilan.



MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM AMBASADORIN E RI TË SUEDISË NË KOSOVË, Z. JONAS WESTERLUND

Më 7 shtator 2023, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, priti në takim ambasadorin e ri të Suedisë në Kosovë, z. Jonas Westerlund.

Myftiu Tërnavë fillimisht i uroi ambasadorit mirëseardhje në institucionin e Bashkësisë Islame të Kosovës, si dhe e uroi atë për marrjen e detyrës

së re, duke i dëshiruar punë të mbarë dhe të suksesshme. Ai më pas e njohu atë me historikun, organizimin, funksionimin dhe sfidat e institucionit të Bashkësisë Islame të Kosovës, duke vënë në pah kështu kontributin e këtij institucioni në të gjitha fazat në të cilat ka kaluar vendi ynë. Ai tha se BIK-u mbetet i përkushtuar për një mirëqenie

për të gjithë qytetarët pa dallim. “Bashkësia Islame e Kosovës ka qenë dhe do të mbetet e përkushtuar për një mirëqenie të mirë për të gjithë pa dallim. Toleranca ndërfetare në vend mbetet synim yni, për çka ne kemi bërë gjithnjë më të mirën e mundshme për ta ruajtur dhe për ta kultivuar atë” – tha ndër të tjera Myftiu Tërnavë.



Nga ana e tij, ambasadori z.Westerlund, falënderoi Myftiun Tërnavë për mikpritjen, si dhe vlerësoi lart punën dhe angazhimin e Myftiut Tërnavë por edhe të Bashkësisë Islame të Kosovës që në vend të mbretërojnë paqja dhe harmonia ndërmjet gjithë qytetarëve pa dallime. Ai tha se Qeveria e Suedisë dhe populli i saj, dënojnë ashpër djegien e Kuranit, duke e cilësuar atë si një akt të shëmtuar, i cili kontribuon në prishjen e rendit dhe harmonisë ndërfetare.

MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM Z. RAMUSH HARADINAJ DHE Z. BEHGJET PACOLLI



Më 14 shtator 2023, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i shoqëruar nga bashkëpunëtorët e tij, priti në takim kryetarin e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës,

z. Ramush Haradinaj dhe kryetarin e Aleancës Kosova e Re, z. Behgjet Pacolli.

Myftiu Tërnavë u uroi mirëseardhje mysafirëve në institucionin e Bashkësisë

Islame të Kosovës, duke shprehur kështu mirënjohje dhe falënderime për interesimin e kryetarëve për shëndetin e tij. Ai tha se tanimë falë Zotit gëzon shëndet të plotë, dhe se ai dhe institucioni që ai drejton janë të gatshëm që edhe më tej të vazhdojnë punën dhe kontributin e tyre për një mirëqenie për të gjithë pa dallim.

Nga ana e tyre, kryetarët Haradinaj dhe Pacolli, falënderuan Myftiun Tërnavë dhe bashkëpunëtorët për pritjen, duke u shprehur kështu të lumtur për shëndetin e Myftiut.

Gjatë këtij takimi u diskutuan edhe një sërë temash të ndryshme të rëndësishme për vendin tonë.

REDAKSIA E REVISTËS “DITURIA ISLAME” MBAJTI MBLEDHJEN E SAJ TË RREGULLT

Më 20 shtator 2023, redaksia e revistës “Dituria Islame” mbajti mbledhjen e saj të rregullt, të cilën e kryesoi kryeredaktori i saj, Driton ef. Arifi.

Në këtë mbledhje mori pjesë edhe kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i cili falënderoi të gjithë anëtarët e redaksisë për kontributin që janë duke dhënë në ngritjen dhe avancimin e kësaj reviste. Ai me këtë rast ndau edhe një mirënjohje për ish-sekretarin e redaksisë, dr. Rexhep ef. Suma, i cili më herët ka qenë edhe kryeredaktor i kësaj reviste për tri mandate.



Gjatë kësaj mbledhje u diskutuan edhe dy numrat e fundit të revistës, 393 dhe 394, si dhe u diskutua për

aktualitetin dhe paraqitjen e tij në revistë.

DIPLOMOJNË 17 HAFËZË TË RINJ NË MEDRESENË E MADHE TË GJAKOVËS

Më 25 shtator 2023, në Institutin e Hifzit në Medresenë e Madhe të Gjakovës u mbajt ceremonia e diplomimit të 17 hafëzëve të rinj, të cilët kanë arritur që me sukses të mësojnë përmendsh tërë Kuranin fisnik. Në këtë ceremoni përveç shumë të pranishmëve mori pjesë edhe kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, reisi i Bashkësisë Fetare Islame të Maqedonisë së Veriut, hafëz Shaqir ef. Fetahi, si dhe mysafiri special nga Turqia, Osman Nuri Topbash.



Në fjalën e tij përshëndetëse, Myftiu i Kosovës, Naim ef. Tërnavë, vlerësoi lart punën dhe angazhimin që po bën Instituti i Hifzit në Gjakovë për nxjerrjen e hafëzëve të rinj, duke thënë se kjo ditë është tejet një ditë e lumtur, jo vetëm për hafëzët dhe familjet e tyre, por edhe për ne dhe gjithë vendin tonë.

Reisi i BFI-së së RMV-së, Shaqir ef. Fetahi, tha se ndjehet tejet i lumtur që po merr pjesë në një ceremoni të tillë ku po diplomojnë 17 hafëz të rinj. Ai përgëzoi Institutin e Hifzit për punën e bërë, ndërsa hafëzëve iu dëshiroi shëndet dhe suksese në jetë.

Ligjëratorin kryesorë në këtë ceremoni e mbajti Osman Nuri Topbash, i cili

foli rreth vlerës dhe rëndësisë që ka mësimi përmendsh i Kuranit, duke përmendur kështu traditën e mësimin të Kuranit që nga Pejgamberi a.s. e deri te gjeneratat tona brez pas brezi.

Para kësaj ceremonie Myftiu Tërnavë zhvilloi një takim me Osman Nuri Topbashin dhe me reisin Shaqir ef. Fetahin.

MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM NJË DELEGACION NGA FONDACIONI “ZAJED BIN SULTAN AL NAHJAN”



Më 26 shtator 2023, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, priti në takim një delegacion nga Fondacioni “Zajed bin Sultan al Nahjan” të Abu Dabit, i cili përbëhej nga z. Said al Humejri, z. Haled al Kabi, z. Saleh al Muesemi dhe z. Eid al Amiri, të cilët shoqëroheshin nga përfaqësuesi i Ambasadës së Emirateve të Bashkuara Arabe, z. Ibrahim Fadllalla.

Myftiu Tërnavë fillimisht u uroi mirëseardhje mysafirëve në institucionin e Bashkësisë Islame të Kosovës, e më pas i njohu ata me veprimtarinë e BIK-ut, sidomos në ngritjen infrastrukture të saj, për të cilën i falënderoi edhe përfaqësuesit e Fondacionit për kontributin e tyre të dhënë përgjatë viteve. Ai tha se si institucion jemi të gatshëm që të vazhdojmë bashkëpunimin e mirë që kemi pasur deri më tani.

Nga ana e tij, përfaqësuesi z. Said al Humejri, falënderoi Myftiun Tërnavë për pritjen, duke shprehur kështu gatishmërinë e Fondacionit për të vazhduar bashkëpunimin e mirë me institucionin e BIK-ut.

Fondacioni “Zajed bin Sultan al Nahjan” ka ndërtuar objektin e Fakultetit të Studimeve Islame në Prishtinë, xhaminë “Zajed” në Vushtrri, Spitalin e Vushtrrisë.

U MBAJT MEVLUD NË XHAMINË E ÇARSHISË

Më 26 shtator 2023, në Xhaminë e Çarshisë në Prishtinë, filloi të shënohet Muaji i Mevludit – ditëlindjes së Muhamedit a.s.. Ky manifestim filloi me këndim të Kuranit, ilahive, kasideve dhe ligjëratë kushtuar jetës së Pejgamberit a.s.. Ligjëratën kushtuar lindjes dhe jetës së Pejgamberit a.s. e mbajti kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë.

“Ne si besimtarë myslimanë e kujtojmë çdo ditë Pejgamberin a.s., por në veçanti sonte, e kujtojmë dhe mësojmë për jetën, veprën, misionin dhe porositë e Muhamedit a.s.. Në këtë muaj të Mevludit, në çdo tubim që kemi duhet t’i përmendim mësimet e Pejgamberit tonë, ne duhet të shënojmë



më këtë muaj me lexim të Kuranit, me namaz dhe vepra të tjera të mira”, ka thënë ndër të tjera Myftiu Tërnavë gjatë ligjëratës së tij.

Ky program u veçua edhe me lexim të bukur të Kuranit, ndërsa me aktivitete të tilla do të shënohet i gjithë ky muaj në të cilin do të rikujtohet misioni dhe porositë e Muhamedit a.s..

HAPET BIBLIOTEKA E XHAMISË NË JANJEVË ME LIBRAT E MULLA IRFAN EF. BIKLIQIT

Më 30 shtator 2023, në ambientet e xhamisë në Janjevë edhe zyrtarisht u bë hapja e bibliotekës me librat e Mulla Irfan ef. Bikliqit, të cilat iu dorëzuan xhamisë.

Kjo bibliotekë, e ish-imamit të kësaj xhamie u hap pikërisht në 7-vjetorin e tij të kalimit në Ahiret, duke kujtuar dhe njëkohësisht çmuar lart kontributin e tij në çështjet fetare dhe kombëtare.

Kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, në fjalën e tij çmoi lart kontributin dhe angazhimin fetar e kombëtar të Mulla Irfan Bikliqit. Ai tha se përpjekjet dhe sakrificat e tilla për atdhe kanë bërë që Kosovë ta gëzojë lirinë.

Muamer Bikliqi, djali i imamit tha se sot ndjehet jashtëzakonisht krenar ashtu siç është ndërjet gjithë jetën me punën dhe angazhimin e babait të tij.

Për figurën e tij, folën miqtë e imamit si dhe udhëheqës institucional. Ata e vlerësuan si njeri të përkushtuar ndaj dijes dhe në veçanti kontributdhënës i madh në çështjet fetare dhe atdhetare.

Mulla Irfan Mujedin Bikliqi i lindur më 1938 në Janjevë, ndoqi mësimet në



medresenë e mesme “Alauddin”, për të vijuar më pas si imam në xhaminë e Janjevës, ku edhe mori ftesën për shërbim ushtarak. Për një kohë të gjatë u ndjek nga regjimi Jugosllavë për ta dënuar më pas me 3 vjet e gjysmë burgim. Në angazhimin e tij 40-vjeçar

si imam, ai punoi edhe si kryetar i Këshillit të Bashkësisë Islame në Lipjan, si dhe kryeimam, ku edhe u përball me presione të shumta nga pushteti i aso kohe. Gjatë kësaj kohe ai u mor edhe me pajtimin e gjaqeve deri në vitin 2016 kur u nda nga kjo jetë.

DREJTORI SIMNICA PRITI NË TAKIM ANËTARIN E KRYESISË SË XHAMISË “DRITA”

Më 11 shtator 2023, drejtori për Diasporë në Kryesinë e Bashkësisë Islame të Kosovës, Ekrem ef. Simnica, priti në takim anëtarin e Kryesisë së xhamisë “Drita” në Vantaa të Finlandës, z. Fatmir Përquku. Drejtori Simnica e falënderoi atë dhe gjithë bashkatdhetarët tanë që gjenden në diasporë për kontributin e tyre që kanë dhënë dhe që janë duke dhënë për vendin në përgjithësi, por edhe për Bashkësinë Islame në veçanti. Ai tha se bashkëpunimi i mirë që ka mbretëruar deri më tani do të vazhdojë edhe në të ardhmen.

Nga ana e tij, z. Përquku e njohu drejtorin Simnica me rrjedhat e themelimit të xhamisë, si dhe për aktivitetet



që zhvillojnë atje, duke potencuar kështu gatishmërinë që të vazhdohet bashkëpunimi i mirë me BIK-un.

Xhamia “Drita” u themelua në mars të vitit 2023 dhe aktualisht imam është Sami ef. Raçi.

PËRFUNDOI SERIA E TRAJNIME ME MUALIMET E BIK-UT



Gjatë muajit shtator, Departamenti i Gruas pranë Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës ka përmbyllur trajnimet e organizuara për avancimin e punës praktike të mualimeve në mësim-besim dhe përmbushjen e nevojave të tyre në këtë fushë.

Në takimin përmbyllës të ndarjes së certifikatave, trajneri Bashkim Mehani tha se gjatë serisë së trajnimeve të mbajtura, ka dalë në pah domosdoshmëria e hartimit të një kurrikule për edukimin e fëmijëve në mësim-besim, që duhet të jetë e gjithanshme dhe gjithpërfshirëse për territorin e Kosovës.

Andaj takimi përmbyllës me mualimet u fokusua në dy pika: u diskutua baza dhe mënyra e hartimit të kurrikulës apo planprogramit, si dhe u ndanë certifikatat për mualimet që kanë ndjekur këto trajnime.

Udhëheqësja e Departamentit të Gruas, Vaxhide Bunjaku tha se këto trajnime ishin shumë të nevojshme dhe efektive për avancimin e punës.

Edhe mualimet shprehën kënaqësinë që ishin pjesë e këtyre trajnimeve, pasi sipas tyre përfituan shumë njohuri e metoda praktike për zhvillimin e mësimi. Ato kërkuar që këto aktivitete

të jenë të vazhdueshme edhe në të ardhmen.

Takimi përmbyllës me mualimet u organizua në pesë komuna: Prishtinë, Prizren, Gjakovë, Mitrovicë dhe Gjilan. Rikujtojmë se gjatë këtij trajnimi janë zhvilluar katër module:

Vizioni për mësim-besim, Roli dhe detyrat e mualimes, qasja individuale në edukim dhe hapja ndaj shoqërisë. Pjesmarrëse të këtyre trajnimeve ishin rreth 150 mualime të angazhuara nga BIK-u, por edhe të atyre që zhvillojnë aktivitete në baza vullnetare.



“Nga radhët e pa numëruara të atyre që patën mundësinë t’i vizitonin këto vende, disa mbajtën shënime dhe ndanë përvojat e tyre me të tjerët. Në ditarët e tyre përshkruanin udhëtimin dhe peripecitë e pazakonta gjatë rrugës për në qytetet e shenjta dhe gjatë qëndrimit të tyre në to. Të tjerë shkruanin poezi për përvojat apo mbresat e tyre nga ato vende.

Jam i vetëdijshëm që ka shumë shënime për këtë temë. Fatmirësisht, ka diçka të ruajtur në arkivat dhe bibliotekat tona edhe nga autorët shqiptarë. Ata kanë lënë gjurmët e tyre që nga shekulli XV. Po ashtu kam pasur rastin t’i lexoj shumë autorë, që nga mesjeta e këtej, dhe kam parë se çdo njeri e përjeton këtë rrugëtim në mënyrën e vet”. (autori)

DITURIA ISLAME • Nr. 395 TETOR 2023